



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Ministarstvo Obrazovanja i Nauke - Ministry of Education & Science

KATALOGU I PROGRAMEVE TË APROVUARA PËR ZHVILLIM PROFESIONAL TË MËSIMDHËNËSVE DHE UDHËHEQËSVE TË ARSIMIT

EDICIONI I KATËRT

Prishtinë, 2020



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT

DHE SHKENCËS

**MINISTRY OF
EDUCATION**

& SCIENCE

**MINISTARSTVO ZA
OBRAZOVANJE**

I NAUKE

**KATALOGU I PROGRAMEVE
TË APROVUARA PËR ZHVILLIM PROFESIONAL TË
MËSIMDHËNËSVE DHE UDHËHEQËSVE TË ARSIMIT
EDICIONI I KATËRT**

Prishtinë, 2020

Botues:

Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH)

Përgatitur nga:

Luan Sahitaj

Osman Beka

Dizajni:

Katalogu i programeve të akredituara/të njohura nga MASH-i për zhvillim profesional të mësimitdhënësve dhe udhëheqësve të arsimit është në dispozicion për shkarkim në uebfaqe të MASH-it: <http://www.mash-gov.net>

© Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH)

Tabela e përmbajtjes

HYRJE.....	6
PONDER (“Shkrimi dhe leximi kritik medial”)	7
PODIUM “Metodologjia për avokim social”	10
UPSHIFT (“Ndërmarrësi me ndikim social”)	15
Trajnim për Koordinatorë të Cilësisë në nivel të shkollës	21
SITOS Përdorues.....	25
WBTplus	26
School Update.....	28
Titulli i Programit: Identifikimi i nxënësve me vështërsi në të nxënë.....	30
Qasja dhe mësimdhënia e diferencuar për fëmijet me nevoja të veçanta	31
Arsimi Gjithëpërfshirës: Vizioni dhe konceptet e arsimit gjithëpërfshirës, puna e përbashkët dhe mjediset që ndihmojnë të nxënët e individualizuar	33
Bashkëpunimi me prindër dhe komunitet	37
Hartimi i Planit Individual të Arsimit – PIA	38
Parandalimi i dhunës në shkollë	41
Parandalimi i përdormimit të gjuhës urrejtëse të nxënësve në mediet social’	42
Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie.....	45
Edukimi medial dhe roli i tij në zhvillimin shoqëror dhe demokratik.....	47
Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social.....	49
Mësimdhënia e gjuhës dhe letërsisë shqipe për ciklin fillor dhe të mesëm	51
Planifikimi dhe Udhëheqja Strategjike në Arsimin Parauniversitar.....	52
Gjithëpërfshirja në punën me fëmijët në klasat parafillore dhe parashkollore	54
Puna e kujdestarit të klasës – Kujdestari i mirë.....	56
Qasja metodologjike në mesimdhënie e gjuhës angleze përmes hulumtimit në veprim	61
Trajtimi i stereotipeve dhe diskriminimit, kultivimi i pranimi dhe gjithëpërfshirjes.	62
Edukimi Financiar	64
Trajnimi i mësimdhënësve të shkollave të mesme profesionale për punë me të rritur	66
Aktivitet Profesional – Roli dhe funksioni i tyre në shkollat e Kosovës.....	71
Edukimi për të drejtat e fëmijëve “Të drejtat tona”	76
Përgatitja e Edukatorëve Parafillor për Përkrahjen dhe Zhvillimin e Potencialit të Fëmijëve përmes Lojës dhe Kreativitetit”	77

Metodologjitë e Reja në Mësimdhënie.....	80
Kujdestari i klases dhe disiplinat	81
Identifikimi, parandalimi dhe trajtimi i llojeve të dhunës në shkollë	83
Vlerësimi përmbledhës dhe hartimi i testeve për klasat 1-9	85
Administrim, Menaxhim dhe Udhëheqje në Arsim.....	87
Aktivitetet e parapara në shkollë në përmbushjen e objektivave të ndërlidhura me orientimin në karrierë	90
Busulla.COM - 5 hapat e orientimit në karrierë	92
Identifikimi i nevojave për trajnime dhe azhurnimi i standardeve të profesionit përmes TNA/SKNA.....	94
Krijimi dhe menaxhimi i bankës së pyetjeve.....	95
Krijimi dhe publikimi i testeve	97
Ndërlidhja e shkollave me tregun e punës.....	98
Orientimi në karrierë – Njohuri të përgjithshme	100
Roli i Busulla.COM në përmbushjen e objektivave për orientimin në karrierë të parapara në Kornizën Kurrikulare dhe Kurrikulat Bërthamë	102
Sistemi i monitorimit dhe evaluimit - Sigurimi i cilësisë në shkollë.....	103
Vlerësimi i potencialit dhe interpretimi i rezultateve të testeve të vetë-njohjes ..	105
Bazat e bashkëpunimit online	107
Bazat e kompjuterit.....	109
Bazat e të dhënave.....	111
Kalkulimi i tabelave	113
Komunikimi elektronik.....	115
Përpunimi i teksteve.....	117
Prezantimet.....	119
Programi për projekte	121
Siguria në TI.....	123
Orët plotësuese të gjuhës për fëmijët e riatdhesuar	124
Shkolla takon biznesin	127
Disiplina Pozitive në Mësimdhënien e Përditshme (DPMP)	128
Indeksi për Gjithëpërfshirje.....	131
Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione parashkollore dhe shkolla fillore në Kosovë - Modul trajnimi për edukatorë, mësimdhënës dhe personelin tjetër të përfshirë në arsim.....	135
Kujdesi dhe zhvillimi gjatë fëmijërisë së hershme	138

Vlerësimi i nxënësve bazuar në dëshmi.....	143
“Ngritja e Kapaciteteve në Udhëheqje Arsimore”	145
“Mbrojtja e shëndetit mendor të fëmijëve përmes programeve psiko-pedagogjike në vendet e prekura nga varfëria”	149
“Ndihmë fëmijëve me vështirësi specifike në mësim dhe fëmijëve me nevoja të veçanta”	151
Aplikimi i programeve online në sigurimin e cilësisë në mësimdhënie.....	153
Edukimi për të drejtat e fëmijëve “Të drejtat tona”	155
Mbrojtja e fëmijëve në internet	157
Mësimdhënia inovative me përdorimin e mjeteve dixhitale	159
Gjithëpërfshirja dhe individualizimi i mësimit për nxënës me nevoja të veçanta arsimore (PIA).....	160
Udhëzues për zbatim të kurrikules	162
Mësimdhënia me teknologji informative	164
“Origami – Mësojmë dhe krijojmë”	166
“Kurrikula e ciklit fillor me qasje kompetencash”	168
Identifikimi dhe përkrahja e nxënësve me inteligjencë të jashtëzakonshme, me dhunti e talente.....	171
Identifikimi dhe përkrahja e nxënësve me inteligjencë të jashtëzakonshme, me dhunti e talente	174
Mësimdhënia cilësore në edukim dhe arsimim gjithëpërfshirës	178
Ndërmjetësimi mes bashkëmoshatarëve	180
Standardet e fasilitimit të të nxënit.....	182
Zhvillimi dhe edukimi praktik- fëmijë të suksesshëm.....	184
Edukimi Inkluziv/ Gjithëpërfshirës	187
“Shkolla gjithëpërfshirëse që mbështet arsimimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe të riatdhesuarit”	189
“Bazat e Micro:bit-it - Kodimi”	193
“Shkathtësitë Bazë dhe Zhvillimi i Lidërshtipit”	194
“Mendimi Kritik, Zgjidhja e Problemeve dhe Bazat e Micro:bitit”	195
“Mendimi Kritik, Zgjidhja e Problemeve dhe Bazat e Micro:bit-it” për trajnerë ..	196

HYRJJE

Ministria e Arsimit, Shkencës (MASH), në përputhje me UA 06/2017 për kriteret dhe procedurat e aprovimit të programeve për zhvillim profesional të mësimeve dhe punonjësve arsimor, ka aprovuar ofertuesit dhe programet për zhvillimin profesional të mësimeve. Bazuar në të dhënat në dispozicion të MASH-it, përkatësisht Divizionit për Zhvillimin profesional të mësimeve, është përgatitur botimi i katër i Katalogut të programeve trajnuese. Në këtë Katalog janë përfshirë ofertuesit dhe programet e aprovuara që për vitin 2020.

Katalogu ofron një përshkrim të përgjithshëm të ofertuesve të programeve trajnuese duke përfshirë kontaktin dhe adresën e tyre. Ndërsa programet trajnuese të secilit ofertues janë përshkruar në mënyrë më specifike, sipas formularit të caktuar nga MASH dhe të plotësuar nga ofertuesit e programit si dhe përpunuar nga MASH. Për disa programe të cilat janë të përfshira në Katalog, adresa apo kontakti mund të mos jetë në shfrytëzim. Mirëpo shfrytëzuesit e këtij Katalogu inkurajohen të gjurmojnë ofertuesit në mënyra të ndryshme për të siguruar shërbimet dhe programet e dëshiruara.

Përshkrimi i programeve përmban: tipin e programit, ofertuesin, kohëzgjatjen, përfituesit, rezultatet e pritura, përmbajtjen, metodologjinë dhe procesin e certifikimit. Të gjitha këto informacione janë të rëndësishme sepse me rastin e licencimit, rilicencimit apo avancimit në karrierë, mësimeve duhet të ofrojnë dëshmi për përfundimin me sukses të programeve themelore dhe atyre plotësuese për zhvillim profesional.

Kërkesat dhe kriteret përfundimin me sukses të trajnimeve në programe bazike apo plotësuese janë përcaktuar me UA 05/2017 për Sistemin e licencimit dhe zhvillimin në karrierë të mësimeve.

Përmbajtja e programeve të trajnimit do të ndihmojë mësimeve të identifikojnë programet, vijueshmëria e të cilave do të ndihmojë ata/o të avancohen gjatë karrierës dhe të arrijnë Standardet e mësimeve të përcaktuara me Kornizën strategjike për zhvillimin e mësimeve në Kosovë 2017.

Rjedhimisht, përfundimi me sukses i programeve themelore dhe plotësuese do të ndikoj në rritjen e nivelit të performancës së mësimeve.

Këto programe janë aktualisht në dispozicion të mësimeve dhe punonjësve arsimor në Kosovë dhe mund të vijohen në marrëveshje me ofertuesit e tyre. Katalogu shërben si udhëzues dhe informator për MASH-in dhe palët tjera përfituese për të mbështetur zhvillimin profesional gjatë karrierës së mësimeve.

Prandaj, azhurnimi i këtij katalogu duhet bërë në vazhdimësi dhe në përputhje me nevojat dhe kërkesat e mësimeve për programe të cilat rrisin cilësinë e mësimeve dhe mësimeve.

Titulli i Programit	PONDER ("Shkrimi dhe leximi kritik medial")
Titulli i organizatës	Fondi i Kombeve të Bashkuara për fëmijë UNICEF
Tipi i programit:	Plotësues
Ofertuesi i programit:	UNICEF
Adresa:	Rr.Behije Dashi,nr 7 10000 Prishtinë
E-mail:	drexha@unicef.org
Telefoni:	00383 249 230/231/232 045 322973
Numrat dhe data e aprovimit:	Nr. 61/2020 Datë: 22.05.2020 (program i aprovuar për dy vite)
Kohëzgjatja e programit (orë)	Në total 30 orë
Përfituesit:	Mësimdhënësit e shkollave të mesme të larta (komunat Gjakovë, Gjilan, Lipjan dhe Dragash)
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	25 - 30 pjesëmarrës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Përmes këtij programi, deri në fund të prillit 2022 synohet që: - Së paku 140 mësimdhënësit të shkollave të mesme të larta (prej tyre 60% femra) të jenë trajnuar për ofrimin e aktiviteteve dhe arritjen e rezultateve të nxënësve për kompetenca tek nxënësit e shkollave të mesme të larta me theks në shkathtësi të shekullit 21 për jetë dhe punë; - Të gjithë nxënësit (djem dhe vajza) e shkollave të përzgjedhura të mesme të larta të kenë fituar njohuri dhe shkathtësi për jetë dhe punë, me theks të veçantë në zhvillimin e kompetencave të menduarit kritik dhe shkrim leximit kritik medial.
Përmbajtja:	Përmes trajnimit dyditor për programin PONDER ("Shkrimi dhe leximi kritik medial"), mësimdhënësit do të jenë më të përgatitur që të: përdorin metodologji dhe përmbajtje për të zhvilluar tek nxënësit kompetencën e të menduarit kritik, duke gjetur, analizuar, vlerësuar, gjykuar dëshmi mbi bazën e argumenteve të nxjerra nga materiale të ndryshme si tekste, fotografi,

	inçizimeve audio-vizuele etj. për shkrim dhe lexim kritik medial si dhe për t'iu shmangur stereotipeve dhe plagjiaturës; • zhvillojnë tek nxënësit njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet për mediet në kontekstin e dallimit të formave dhe llojeve, të marrëdhënieve ndërmjet mediave dhe audiencës, të kuptimit të diversitetit dhe kompleksitetit të burimeve të tyre. • zhvillojnë tek nxënësit njohuritë dhe shkathtësitë për të analizuar dhe interpretuar fotografitë, si mund të shfrytëzohen ato në media, si mund të përdoren për të paraqitur vlerat, normat dhe ndryshimet sociale; • zhvillojnë tek nxënësit shkathtësi që të kuptojnë rolin e audiencës në produktet mediale, në interpretimin, shpërndarjen e informacionit e porosive mediale dhe rëndësinë e gjithëpërfshirjes dhe diversitetit në medie.
Metodat e realizimit të programit	- Programi i trajnimit të mësimeve dhe përbëhet nga katër module, të cilat realizohen përgjatë 2 ditëve të trajnimit. Modulet përmbajnë detyra dhe këshilla praktike të zbatimit të ndërlidhura me fusha të caktuara të kurrikulës. Katër (4) modulet e trajnimit, të cilat përfshijnë: 1. Moduli 1: “Shfrytëzimi i të menduarit kritik për shkrim-lexim medial” ku pritët nga mësimeve të jenë të përgatitur për të përdorur teknika dhe metodologji për të zhvilluar tek nxënësit kompetencën e të menduarit kritik, duke gjetur, analizuar, vlerësuar, gjykuar dëshmi mbi bazën e argumenteve të nxjerra nga materiale të ndryshme si tekste, fotografi, inçizimeve audio-vizuele, etj për shkrim lexim medial si dhe për t'ju shmangur plagjiaturës; 2. Moduli 2: “Diversiteti në medie, pozicionimi dhe përvoja” ku pritët nga mësimeve të jenë të përgatitur për të zhvilluar tek nxënësit njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet për mediet në kontekstin e dallimit të formave dhe llojeve, të marrëdhënieve ndërmjet mediave dhe audiencës, të kuptimit të diversitetit dhe kompleksitetit të burimeve të tyre. 3. Moduli 3: “Leximi i fotografive” ku pritët nga mësimeve të jenë të përgatitur për të zhvilluar tek nxënësit njohuritë dhe shkathtësitë për të analizuar dhe interpretuar fotografitë, si mund të

shfrytëzohen ato në media, si mund të përdoren për të paraqitur vlerat, normat dhe ndryshimet sociale;

4. **Moduli 4: “Fuqizimi përmes shkrim-leximit medial”** ku pritët nga mësimdhënësit të jenë të përgatitur për të zhvilluar tek nxënësit shkathtësi që të kuptojnë rolin e audiencës në produktet mediale, në interpretimin, shpërndarjen e informacionit e porosive mediale dhe rëndësinë e gjithëpërfshirjes dhe diversitetit në medie.

Trajnimi është me prioritet për mësimdhënësit e katër fushave kurrikulare:

1. **Gjuhët dhe komunikimi**
2. **Shkencat e natyrës**
3. **Shoqëria dhe mjedisi**
4. **Jeta dhe puna**

- Trajnim dyditor do të përkrahët me **punëtori përcjellëse dyditore** me qëllim të planifikimit të realizimit të moduleve në nivel të fushave kurrikulare përmes temave të përzgjedhura për fushë dhe lëndë dhe
- Punëtori përcjellëse njëditore me qëllim të prezantimit të dokumenteteve e planeve të hartuara dhe të zbatuara të moduleve të programit për PONDER (“Shkrim dhe lexim kritik medial”) nga mësimdhënësit të fushave/ lëndëve të caktuara të kurrikulës në nivel shkolle, komune, dhe me mësimdhënësit nga komunat dhe shkollat e përzgjedhura për të shkëmbyer përvojat e zbatimit në nivel të temave mësimore brenda fushës së caktuar kurrikulare;

Vlerësimi i mësimdhënëseve për certifikim do të bëhet në bazë të dosjes/portofolios e cila duhet të përmbajë si vijon:

1. Dëshmi për përfundim e sukses të trajnimit dyditor ku do t’i ofrohet mësimdhënësit fillimisht certifikata për pjesëmarrje;
2. Dëshmi për pjesëmarrje në punëtori dyditore për planifikim të realizimit të temave mësimore dhe moduleve të programit në kuadër të fushës/lëndës përkatëse;
3. Dëshmi për prezantim të zbatimit të moduleve përmes temave të caktuara të lëndës për shkallë dhe lëndë (planet e orëve mësimore, dëshmi përmes fotove ose videove të realizuara në klasë

	me nxënësit për aktivitete të temave dhe moduleve të caktuara)
	4. Punimet e nxënësve si rezultat i aktiviteteve të realizuara;
	5. Artikuj medial të shkruar nga nxënësit/të botuar në ndonjë medium/ revistë shkollore për tema aktuale.
Certifikimi	Mësimdhënësi duhet dëshmuar: - Pjesëmarrje aktive në programin dyditor të trajnimit (12 orë); 25% - Zhvillim të planeve mësimore rreth temave të caktuara mësimore të fushës/lëndës përkatëse duke përdorur modulet e programit (12 orë); 25% - Prezantim të realizimit të moduleve në klasë dhe punës së nxënësve (6 orë); 15% - Rezultat të kalimit të testit me së paku 80% të pikave; 35% - Certifikata ka vlerën e 30 orëve të trajnimit.
Trajner	Zyrtarët e planprogrameve për 4 fushat kurrikulare të lartë-cekura dhe trajnerët e PEN, IF dhe KEC
Data e aplikimit për njohje	8 maj 2020

Titulli i Programit	PODIUM “Metodologjia për avokim social”
Titulli i organizatës	Fondi i Kombeve të Bashkuara për fëmijë UNICEF
Tipi i programit:	Plotësues
Ofertuesi i programit:	UNICEF
Adresa:	Rr.Behije Dashi,nr 7 10000 Prishtinë
E-mail:	drexha@unicef.org
Telefoni:	00383 249 230/231/232 045 322973
Numrat dhe data e aprovimit:	Nr. 61/2020Datë: 22.05.2020 (program i aprovuar për dy vite)
Kohëzgjatja e programit(orë)	Në total 30 orë
Përfituesit:	Mësimdhënësit e shkollave të mesme të larta (komunat Gjakovë, Gjilan, Lipjan dhe Dragash)
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	25 – 30 pjesëmarrës

Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Përmes këtij programi, deri në fund të prillit 2022 synohet që: • Së paku 140 mësimdhënës të shkollave të mesme të larta (prej tyre 60% femra) të jenë trajnuar për ofrimin e aktiviteteve dhe arritjen e rezultateve të të nxënës për kompetenca tek nxënësit e shkollave të mesme të larta me theks në shkathtësi të shekullit 21 për jetë dhe punë ku: • Të gjithë nxënësit (djem dhe vajza) e shkollave të përzgjedhura të kenë fituar njohuri dhe shkathtësi për jetë dhe punë, me theks të veçantë në zhvillimin e kompetencave për qytetari demokratike të përgjegjshme, pjesëmarrje aktive të nxënësve, shkathtësitë për udhëheqje demokratike, qeverisje të mirë, transparencë dhe llogaridhënie, arsyetim logjik, shkathtësi për zgjidhjen e problemeve, kreativitet, shkathtësi hulumtimi, aftësi për të marrë vendime; aftësi avokimi dhe organizim të fushatave avokuese, punë ekipore dhe aftësi ndërpersonale, përshtatje ndaj mjediseve dinamike, rrjetëzim dhe menaxhim të proceseve organizative e avokuese.
Përmbajtja:	Përmes trajnimit dyditor për programin PODIUM “Metodologjia për avokim social”, mësimdhënësit do të jenë më të përgatitur që të: • përdorin metodologji dhe përmbajtje për zhvillim të shkathtësive të nxënësve që të përdorin teknikën (di), (dua të di), (mësova) për të identifikuar dhe klasifikuar problemet në komunitet dhe si të veprojnë si agentë të ndryshimeve; • ofrojnë njohuri për metodat dhe instrumentet e hulumtimit për të krijuar një mjedis ku aftësohen nxënësit për të hartuar pyetësorë dhe si të bëjnë hulumtime për të identifikuar problemet; • ofrojnë këshilla dhe përkrahin nxënësit për të nxitur aftësitë e tyre të identifikojnë akterët relevant që janë kompetent për shqyrtimin e problemit të identifikuar; • mentorojnë dhe ofrojnë këshilla për të zhvilluar shkathtësitë e nxënësve që të vlerësojnë nevojat e komunitetit, t'i sintetizojnë dhe t'i shfrytëzojnë informatat që rrjedhin nga vlerësimi.

- aplikojnë metodologji për aftësimin e nxënësve që të analizojnë thelbin e problemeve kryesore duke identifikuar shkaqet/arsyet ku duhet të intervenojnë;
- aplikojnë metodologji për të ndihmuar nxënësit të zhvillojnë Kornizën e Kërkesës sipas teknikës SMART (Specifike, e Matshme, e Qasshme, Reale dhe Kohëzgjatjen);
- përdorin strategji për të nxitur shkathtësitë e nxënësve rreth vlerësimit dhe rishikimit të akterëve, raporteve në mes tyre dhe për problemin e ridefinuar;
- ofrojnë këshilla për të aftësuar nxënësit që të identifikojnë dhe të zbatojnë disa nga teknikat e avokimit (lobimi me vendimmarrës, avokimi me media sociale, fushatë me veprime të drejtpërdrejta) për vetëdijësim dhe lobim rreth problemit të identifikuar nga nxënësit;
- udhëzojnë dhe ndihmojnë nxënësit të konceptojnë dhe modelojnë detajisht fushatën, duke përcaktuar fazat e avokimit në mënyrë kronologjike dhe përfshirë taktikat e avokimit;
- ofrojnë udhëzime rreth shfytëzimit të burimeve efikase për të aftësuar nxënësit që të planifikojnë buxhetin për fushatën duke identifikuar materialet, paisjet, burimet njerëzore dhe kostot operacionale;
- ofrojnë udhëzime dhe shembuj për të përgatitur nxënësit të planifikojnë një fushatë duke specifikuar aktivitetet dhe afate kohore;
- demonstrojnë përdorimin e teknikave të ndryshme të prezantimit për të zhvilluar aftësitë prezantuese të nxënësve rreth fushatës së avokimit para një paneli vlerësues.

Metodat e realizimit të programit

- Programi i trajnimit të mësimeve dhe trajnerëve/mentorëve përbëhet nga 12 module, të cilat realizohen **përgjatë 2 ditëve të trajnimit**. Modulet përmbajnë detyra dhe këshilla praktike të zbatimit të ndërlidhura me fusha të caktuara të kurrikulës.

Në Modulet e trajnimit përfshihen:

Moduli 1: **“Të menduarit për avokim në komunitet”** të demonstrojnë njohuri dhe metodologji për zhvillim të shkathtësive të nxënësve që të përdorin teknikën e KWL chart (K-know (di), W-want to know (dua të di), L-Learn (mësua) për të identifikuar dhe klasifikuar problemet në

komunitet dhe si të veprojnë si agjentë të ndryshimeve.

Moduli 2: **“Si të përpilojmë një pyetësor për identifikimin e problemeve të komunitetit?”** demonstroi njohuri për metodat dhe instrumentet e hulumtimit për të krijuar një mjedis, ku aftësohen nxënësit për të hartuar pyetësorë me pyetje të mbyllura dhe si të bëjnë hulumtime për të identifikuar problemet.

Moduli 3: **“Hartëzimi i akterëve relevant”** ofron këshilla dhe përkrah nxënësit për të nxitur aftësitë e tyre të identifikojnë akterët relevant që janë kompetent për shqyrtimin e problemit të identifikuar.

Moduli 4: **“Identifikimi/Analiza e nevojave të komunitetit”** mentoron dhe ofron këshilla për të zhvilluar njohuritë e nxënësve, që të vlerësojnë nevojat e komunitetit, t'i sintetizojnë dhe t'i shfrytëzojnë informatat që rrjedhin nga vlerësimi.

Moduli 5: **“Caktimi i prioriteteve/nevojave të komuniteti”** aplikon metodologji për aftësimin e nxënësve që të analizojnë thelbin e problemeve kryesore duke identifikuar shkaqet/arsyet ku duhet të intervenojnë.

Moduli 6: **“Hartimi i kornizës për avokim”** përzgjedh metodologji për të aftësuar nxënësit aftësohet të zhvillojnë Kornizën e Kërkesës sipas teknikës SMART (Specifike, e Matshme, e Qasshme, Reale dhe Kohëzgjatjen).

Moduli 7: **“Rishikimi i hartëzimit të akterëve relevant”** përdor strategji për të nxitur shkathtësitë e nxënësve rreth vlerësimit dhe rishikimit të akterëve, raporteve në mes tyre dhe për problemin e ridefinuar të cilin e kanë identifikuar pas ushtrimit me 3 PSE.

Moduli 8: **“Taktikat e avokimit”** ofron këshilla për të aftësuar nxënësit që të identifikojnë dhe të zbatojnë disa nga teknikat e avokimit (lobimi me vendimmarrës, avokimi me media sociale, fushatë me veprime të drejtpërdrejta) për vetëdijësim dhe lobim rreth problemit të identifikuar nga grupi.

Moduli 9: **“Konceptimi dhe modelimi i fushatës”** udhëzon dhe ndihmon nxënësit të konceptojnë dhe modelojnë detajisht fushatën, duke përcaktuar fazat e avokimit në

mënyrë kronologjike dhe përfshirë taktikat e avokimit.

Modulit 10: **“Buxheti/Menaxhimi i buxhetit”** ofron udhëzime rreth shfytëzimit të burimeve efikase për të aftësuar nxënësit që të planifikojnë buxhetin për fushatën duke identifikuar materialet, paisjet, burimet njerëzore dhe kostot operacionale.

Moduli 11: **“Avokimi për ndryshim”** ofron udhëzime dhe shembuj për të përgatitur nxënësit të planifikojnë një fushatë duke specifikuar aktivitetet dhe afate kohore.

Moduli 12: **“Përgatitja për prezantimin e fushatës”** demonstroi njohuri dhe përdor teknika të ndryshme të prezantimit për të zhvilluar aftësitë prezantuese të fushatës së avokimit para një paneli vlerësues.

Trajnimi do të jetë me prioritet për mësimdhënësit e katër fushave kurrikulare:

5. Gjuhët dhe komunikimi

6. Shkencat e natyrës

7. Shoqëria dhe mjedisi

8. Jeta dhe puna

- Trajnimi dyditor do të përkrahët me **punëtorin përcjellës dy-ditore** me qëllim të planifikimit të realizimit të moduleve në nivel të fushave kurrikulare përmes temave të përzgjedhura për fushë dhe lëndë dhe
 - Punëtori përcjellës 1 - 2 ditore me qëllim të prezantimit të dokumenteve e planeve të hartuara dhe të zbatuara të moduleve të programit **PODIUM “Metodologjia për avokim social”** nga mësimdhënësi të fushave/ lëndëve të caktuara të kurrikulës.
 - **Vlerësimi i mësimdhënësve për certifikim** do të bëhet në bazë të dosjes/portofolios e cila duhet të përmbajë si vijon:
6. Dëshmi për përfundim e sukses të trajnimit 2 ditor, ku do t’i ofrohet mësimdhënësit fillimisht certifikata për pjesëmarrje;
 7. Dëshmi për pjesëmarrje në punëtorin dy-ditore për planifikim të realizimit të temave mësimore dhe moduleve të programit në kuadër të fushës/lëndës përkatëse;
 8. Dëshmi për prezantim të zbatimit të moduleve përmes temave të caktuara të lëndës për shkallë dhe lëndë (planet e orëve mësimore, dëshmi përmes

	fotove ose videove të realizuara në klasë me nxënësit për aktivitete të temave dhe moduleve të caktuara) 9. Punimet e nxënësve si rezultat i aktiviteteve të realizuara; 10. Artikuj apo ndërmarrje të ndryshme avokuese përmes mediave të ndryshme të realizuara nga nxënësit me ndihmën e shkollës/për tema aktuale të identifikuar nga vet nxënësit. 11. Rezultatet e arritura nga avokimi i realizuar nga nxënësit dhe shkolla.
Certifikimi	Mësimdhënësi duhet dëshmuar: - Pjesëmarrje aktive në programin dy ditë të trajnimit (12 orë); 25% - Zhvillim të planeve mësimore rreth temave të caktuara mësimore të fushës/lëndës përkatëse duke përdorur modulet e programit (12 orë); 25% - Prezantim të realizimit të moduleve në klasë dhe punës së nxënësve (6 orë); 15% - Rezultat të kalimit të testit me së paku 80% të pikave; 35% - Certifikata ka vlerën e 30 orëve të trajnimit.
Trajner	Zyrtarët e planprogrameve për 4 fushat kurrikulare të lartëcekura dhe trajnerët e PEN, IF dhe KEC
Data e aplikimit për njohje	8 maj 2020

Titulli i Programit	UPSHIFT (“Ndërmarrësi me ndikim social”)
Titulli i organizatës	Fondi i Kombeve të Bashkuara për fëmijë UNICEF
Tipi i programit:	Plotësues
Ofertuesi i programit:	Rrjeti i edukatorëve bashkëmoshatarë (PEN) Ipko Foundation (IF) Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)
Adresa:	Rr.Behije Dashi,nr 7 10000 Prishtinë
E-mail:	drexha@unicef.org
Telefoni:	PEN:+383 38 223942 IF: +383 49 196 655 KEC: +383 38 244 257, 258 203
Numrat dhe data e aprovimit:	Nr. 61/2020 Datë: 22.05.2020 (program i aprovuar për dy vite)
Kohëzgjatja e programit(orë)	Në total 30 orë
Përfituesit:	Mësimdhënësit e shkollave të mesme të larta

	(komunat Gjakovë, Gjiilan, Lipjan dhe Dragash)
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	25 – 30 pjesëmarrës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Përmes këtij programi, deri në fund të prillit 2022 synohet që: • Së paku 140 mësimdhënës të shkollave të mesme të larta (prej tyre 60% femra) të jenë trajnuar për ofrimin e aktiviteteve dhe arrijtjen e rezultateve të të nxënësve për kompetenca tek nxënësit e shkollave të mesme të larta me theks në shkathtësi të shekullit 21 për jetë dhe punë ku: • Të gjithë nxënësit (djem dhe vajza) e shkollave të përzgjedhura mesme të larta të kenë fituar njohuri dhe shkathtësi për jetë dhe punë, me theks të veçantë në zhvillimin e kompetencave për qytetari demokratike të përgjegjshme, pjesëmarrje aktive të nxënësve, shkathtësi për udhëheqje demokratike, qeverisje të mirë, transparencë dhe llogaridhënie, arsyetim logjik, shkathtësi për hulumtim dhe zgjidhje të qëndrueshme të problemeve, kreativitet, aftësi për të marrë vendime; aftësi riformulimi të zgjidhjeve të problemeve, punë ekipore dhe aftësi ndërpersonale e prezantuese; përshtatje ndaj mjediseve dinamike, rrjetëzim dhe menaxhim të proceseve organizative.
Përmbajtja:	Përmes trajnimit dyditor për programin UPSHIFT “Ndërmarrësi me ndikim social”, mësimdhënësit do të jenë më të përgatitur që: - Të aftësojnë nxënësit që t’i identifikojnë problemet në shkollë ose komunitet, të bashkëpunojnë me hisedarët dhe të përgatisin e të zhvillojnë intervista për zgjidhje të qëndrueshme; të demonstrojnë njohuri dhe përdorin metodologji që të aftësohen nxënësit të identifikojnë dhe të definojnë gjenezën e problemit përmes teknikave “Trungu i problemit” dhe “5 Pse” - të demonstrojnë njohuri dhe përdorin metoda që të aftësohen nxënësit rreth identifikimit e akterëve relevante, që kanë ndikim ose që ndikohen nga

- zgjidhja e problemit;
- të ofrojnë këshilla dhe përkrahin nxënësit për të nxitur aftësitë e tyre të identifikojnë nevojat e personave/akterëve relvantë fiktivë ose real dhe karakteristikat e tyre gjatë procesit të zhvillimit të zgjidhjeve;
 - të mentorojnë dhe ofrojnë këshilla për të zhvilluar aftësitë e nxënësve që të paraqesin në mënyrë vizuale dhe kreative problemin dhe përfshirjen e hisedarëve;
 - të ofrojnë këshilla dhe ndihmojnë aftësimin e nxënësve që të gjejnë zgjidhje, riformulojnë zgjidhjen e problemit duke rishikuar gjetjet e dala nga analizat e mëhershme duke u bazuar në pyetjen: “Si mundemi të?” dhe duke përdorur “Trungun e problemit” dhe “Shabllonin personal”;
 - të aplikojnë metodologji për aftësimin e nxënësve që të analizojnë dhe riformulojnë qëndrimin rreth ndikimit të zgjidhjes së thelbit të problemit kryesor duke nxjerrë ide relevante për të zgjidh problemin dhe përzgjedhin vetëm njërin nga ato;
 - të ofrojnë metoda për të aftësuar nxënësit, që të konceptojnë apo modelojnë aktivitete për të zgjidhur problemin;
 - të përdorin metoda për të sqaruar kuptimin e prototipit, nxit shkathtësitë e nxënësve për reflektim dhe kuptim të prototipit, identifikimin e tyre dhe krijim të prototipave.
 - të ofrojnë këshilla për të aftësuar nxënësit që të analizojnë efektshmërinë e idesë për zgjidhje të problemit të grupeve të synuara, direkte dhe indirekte.
 - të udhëzojnë dhe ndihmojnë nxënësit të përdorin metoda për të krijuar prototipe, të prezantojnë prototipet, të marrin informata kthyes nga persona të ndryshëm rreth idesë së prototipit të caktuar të zgjidhjes së problemit, krijimit të skicës dhe modelimit të prototipit;
 - të ofrojnë udhëzime rreth përgatitjes së listës së resurseve/burimeve njerëzore, materiale, profesionale, logjistike e financiare të nevojshme për

	të realizuar produktin apo shërbimin; - të ofrojnë udhëzime dhe shembuj për të përgatitur nxënësit të planifikojnë buxhetin me resurset e identifikuar për të realizuar projektin e prototipit duke marrë në konsideratë edhe akterët relevantë; - të demonstrojnë njohuri duke udhëzuar nxënësit të simulojnë prezantimin e idesë së krijimit të prototipit duke u bazuar në paraqitjen e problemit dhe zgjidhjen e tij brenda një kohe të caktuar; - të përdorin teknika të ndryshme për të zhvilluar aftësitë prezantuese para një paneli vlerësues, grupi të nxënësve dhe mësimeve dhe apo akterëve tjerë brenda dhe jashtë shkollës.
Metodat e realizimit të programit	- Programi i trajnimit të mësimeve dhe trajnerëve/mentorë përbëhet nga 4 faza me module, të cilat realizohen përgjatë 2 ditëve të trajnimit. Modulet përmbajnë detyra dhe këshilla praktike të zbatimit të ndërlidhura me fusha të caktuara të kurrikulës. Ato përfshijnë: Fazën përgatitore: Të aftësojnë nxënësit që të identifikojnë problemet në shkollë ose komunitet, të bashkëpunojnë me hisedarët dhe të përgatisin e të zhvillojnë intervista për zgjidhje të qëndrueshme; Fazën 1: Analiza dhe kuptimi i problemit Moduli 1: “Trungu i problemit dhe 5 Pse” të demonstrojnë njohuri dhe përdorin metodologjie të aftësohen nxënësit të identifikojnë dhe të definojnë gjenezën e problemit përmes teknikave “Trungu i problemit” dhe “5 Pse” Moduli 2: “Grupi i synuar dhe akterët relevantë” të demonstrojnë njohuri dhe përdorin metoda që të aftësohen nxënësit rreth identifikimit e akterëve relevantë, që kanë ndikim ose që ndikohen nga zgjidhja e problemit; Moduli 3: “Personat” ofrojnë këshilla dhe përkrahin nxënësit për të nxitur aftësitë e tyre të identifikojnë nevojat e personave/akterëve relvantë fiktivë ose real dhe karakteristikat e tyre gjatë procesit të zhvillimit të zgjidhjeve; Moduli 4: “Sfida e dizajnit” mentorojnë dhe ofrojnë këshilla për të zhvilluar aftësitë e nxënësve që të paraqesin në mënyrë vizuale dhe kreative problemin dhe përfshirjen e hisedarëve;

Faza 2: Dizajnimi

Moduli 1: **“Sfida e dizajnit”** ofrojnë këshilla dhe ndihmojnë aftësimin e nxënësve që të gjejnë zgjidhje, riformulojnë zgjidhjen e problemit duke rishikuar gjetjet e dala nga analizat e mëhershme duke u bazuar në pyetjen: “Si mundemi të?” dhe duke përdorur “Trungun e problemit” dhe “Shabllonin personal”;

Moduli 2: **“Shtjellimi i ideve”** aplikojnë metodologji për aftësimin e nxënësve që të analizojnë dhe riformulojnë qëndrimin rreth ndikimit të zgjidhjes së thelbit të problemit kryesor duke nxjerrë ide relevante për të zgjidh problemin dhe përzgjedhin vetëm njërin nga ato;

Moduli 3: **“Konceptimi/modelimi”** ofrojnë metoda për të aftësuar nxënësit që të konceptojnë apo modelojnë aktivitetet për të zgjidhur problemin.

Faza 3: Krijo dhe testo

Moduli 1: **“Prototipet I: Çfarë të krijohet si prototip”** përdorin metoda për të sqaruar kuptimin e prototipit, nxit shkathtësitë e nxënësve për reflektim dhe kuptim të prototipit, identifikimin e tyre dhe krijim të prototipave.

Moduli 2: **“Tregimet e përdoruesve”** ofrojnë këshilla për të aftësuar nxënësit që të analizojnë efektshmërinë e idesë për zgjidhje të problemit të grupeve të synuara, direkte dhe indirekte.

Moduli 3: **“Prototipet II: Metodat dhe krijimi”** udhëzojnë dhe ndihmojnë nxënësit të përdorin metoda për të krijuar prototipe, të prezantojnë prototipet, të marrin informata kthyes nga persona të ndryshëm rreth idesë së prototipit të caktuar të zgjidhjes së problemit, krijimit të skicës dhe modelimit të prototipit.

Faza 4: “Bëje reale”

Moduli 1: **“Mundësitë dhe inputet (resurset)”** ofrojnë udhëzime rreth përgatitjes së listës së resurseve/burimeve njerëzore, materiale, profesionale, logjistike e financiare të nevojshme për të realizuar produktin apo shërbimin.

Moduli 2: **“Qëndrueshmëria dhe të ardhurat”** ofrojnë udhëzime dhe shembuj për të përgatitur nxënësit të planifikojnë buxhetin me resurset e identifikuar për të realizuar projektin e prototipit duke marrë në konsideratë edhe akterët relevantë.

Moduli 3: **“Përgatitja e prezantimit”** demonstrojnë njohuri

duke udhëzuar nxënësit të simulojnë prezantimin e idesë së krijimit të prototipit duke u bazuar në paraqitjen e problemit dhe zgjidhjen e tij brenda një kohe të caktuar. Përdorin teknika të ndryshme për të zhvilluar aftësitë prezantuese para një paneli vlerësues, grupi të nxënësve dhe mësime të ndryshme apo akterëve tjerë brenda dhe jashtë shkollës.

Trajnimi do të jetë me prioritet për mësime të ndryshme të katër fushave kurrikulare:

1. **Gjuhët dhe komunikimi**
2. **Shkencat e natyrës**
3. **Shoqëria dhe mjedisi**
4. **Jeta dhe puna**

- Trajnim dy ditë do të përkrahët me **punëtorin përcjellës dy ditore** me qëllim të planifikimit të realizimit të moduleve në nivel të fushave kurrikulare përmes temave të përzgjedhura për fushë dhe lëndë dhe
- Punëtori përcjellës 1 - 2 ditore me qëllim të prezantimit të dokumenteve të planeve të hartuara dhe të zbatuara të moduleve të programit **"Metodologjia për avokim social"** nga mësime të ndryshme të fushave/ lëndëve të caktuara të kurrikulës.

Vlerësimi i mësime të ndryshme për certifikim do të bëhet në bazë të dosjes/portofolios e cila duhet të përmbajë si vijon:

1. Dëshmi për përfundim të suksesshëm të trajnimit 2 ditë ku do t'i ofrohet mësime të ndryshme fillimisht certifikata për pjesëmarrje;
2. Dëshmi për pjesëmarrje në punëtorin dyditore për planifikim të realizimit të temave mësimore dhe moduleve të programit në kuadër të fushës/lëndës përkatëse;
3. Dëshmi për prezantim të zbatimit të moduleve përmes temave të caktuara të lëndës për shkallë dhe lëndë (planet e orëve mësimore, dëshmi përmes fotove ose videove të realizuara në klasë me nxënësit për aktivitetet të temave dhe moduleve të caktuara)
4. Punimet e nxënësve si rezultat i aktiviteteve të realizuara;
5. Artikuj apo ndërmarrje të ndryshme avokuese përmes mediave të ndryshme të realizuara nga nxënësit me ndihmën e shkollës për tema aktuale të identifikuar nga vetë nxënësit.
6. Rezultatet e arritura nga ofrimi i zgjidhjeve të

	qëndrueshme të zhvilluara/realizuara nga nxënësit dhe shkolla.
Certifikimi	Mësimdhënësi duhet dëshmuar: - Pjesëmarrje aktive në programin dyditor të trajnimit (12 orë); 25% - Zhvillim të planeve mësimore rreth temave të caktuara mësimore të fushës/lëndës përkatëse duke përdorur modulet e programit (12 orë); 25% - Prezantim të realizimit të moduleve në klasë dhe punës së nxënësve (6 orë); 15% - Rezultat të kalimit të testit më së paku 80% të pikave; 35% - Certifikata ka vlerën e 30 orëve të trajnimit.
Trajner	Zyrtarët e planprogrameve për 4 fushat kurrikulare të lart cekura dhe trajnerët e PEN, IF dhe KEC
Data e aplikimit për njohje	8 maj 2020

Titulli i Programit	Trajnim për Koordinatorë të Cilësisë në nivel të shkollës
Titulli i organizatës	O e AD GmbH (ish KulturKontakt Austria)
Tipi i programit:	- Program trajnues themelor për Koordinatorë të cilësisë në nivel shkolle - Program trajnues plotësues për mësimdhënë
Ofertuesi i programit:	OeAD GmbH (ish KulturKontakt Austria)
Adresa:	Ebendorferstrasse 7, 1010 Vienna, Austria
E-mail:	monika.mott@oead.at obuleshkaj@gmail.com
Telefoni:	+431534080 +383 44673777
Numrat dhe data e aprovimit:	Nr.: 63/2020 Data: 22.05.2020 (program i aprovuar për një vit)
Kohëzgjatja e programit(orë)	Programi zhvillohet në 6 ditë trajnimi dhe punë e pavarur individuale e pjesëmarrësve, me gjithsej 42 orë të cilat janë të organizuara përmes 36 orëve të trajnimit të drejtpërdrejtë dhe 6 orë angazhim për detyra, reflektim dhe punë praktike.
Përfituesit:	Pjesëmarrës dhe përfitues kryesorë nga ky program trajnimi

	janë Koordinatorët e cilësisë në nivel shkolle. Pjesëmarrës të tjerë që mund të përfshihen në këtë program të trajnimit janë: mësimdhënësit e angazhuar në ekipet për vetëvlerësim të performancës së shkollës, drejtorët e shkollave si dhe Koordinatorët e cilësisë në DKA.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	20 deri 25 pjesëmarrës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Pjesëmarrësit do të diskutojnë, njihen dhe të zhvillojnë shkathtësitë praktike lidhur me rolin, detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të cilësisë në nivel shkolle, si: ▪ planifikimin, organizimin dhe monitorimin e procesit të menaxhimit të cilësisë në shkollë, në koordinim me drejtorin e shkollës; ▪ mbështetjen e drejtorit të shkollës në procesin e dizajnit të planit zhvillimor të shkollës dhe planin e veprimit; ▪ informimin e drejtorit të shkollës dhe të mësimdhënësve lidhur me temat që janë relevante për menaxhimin e cilësisë në shkollë; ▪ koordinimin e projekteve dhe proceseve me drejtorin e shkollës për të implementuar masa të zhvillimit të cilësisë në bashkëpunim me stafin e shkollës; ▪ koordinimin e planifikimit, organizimit dhe zbatimit të vetë-vlerësimit të progresit të shkollës në fushat e cilësisë; ▪ analizimin dhe interpretimin e rezultateve të vetë-vlerësimit; ▪ raportimin për procesin e menaxhimit të cilësisë dhe rezultatet e tij tek drejtori i shkollës dhe stafi tjetër i shkollës.
Përmbajtja:	Programi i trajnimit të koordinatorëve të cilësisë në shkollë përbëhet nga tri module, secili modul ka 2 ditë trajnime të drejtpërdrejta, gjithsej 6 ditë trajnimi, duke përfshirë detyra, aktivitete dhe këshilla praktike për temat e përfshira në secilin modul. Krahas ditëve të trajnimit, programi ka edhe 6 orë punë e pavarur individuale e pjesëmarrësve. Programi i trajnimit është i organizuar në modulet në vijim: ▪ Moduli 1: Bazat për sigurimin e cilësisë në shkollë ▪ Moduli 2: Menaxhimi i proceseve për sigurimin e cilësisë në shkollë ▪ Moduli 3: Menaxhimi i përmirësimit të vazhdueshëm Moduli 1 është i dizajnuar t'i udhëzojë koordinatorët e cilësisë për ta kuptuar bazat për sigurimin e cilësisë në shkollë. Temat kryesore që shtjellohen në këtë modul janë:

	▪ Të kuptuarit e koncepteve cilësi dhe sistem për sigurimin e cilësisë; ▪ Sistemi i menaxhimit të cilësisë; ▪ Parimet e menaxhimit të cilësisë; ▪ Roli i koordinatorit të cilësisë në nivel shkolle në sigurimin e cilësisë në shkollë; ▪ Deklarata e misionit dhe vizionit të shkollës; ▪ Planifikimi zhvillimor - analiza e gjendjes, përcaktimi i objektivave, masave, aktivitetet e planit të veprimit; ▪ Dokumentimi i punës; ▪ Struktura organizative e shkollës/ institucionit arsimor dhe përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësisë të stafit menaxhues të sigurimit të cilësisë në nivel shkolle, etj. Moduli 2 përqendrohet në rolin e koordinatorëve të cilësisë për të mbështetur drejtorët e shkollave dhe ekipet shkollore në menaxhimin e proceseve për sigurimin e cilësisë në shkollë. Qëllimi i modulit është të zhvillojë kapacitetet e koordinatorëve të cilësisë për të koordinuar proceset për sigurimin e cilësisë në shkollë. Temat kryesore që shtjellohen në këtë modul janë: ▪ Menaxhimi i procesit (faktorët ndikues të një procesi, identifikimi i procesit, fazat e menaxhimit të procesit); ▪ Menaxhimi i proceseve kryesore (procesi mësimor, sigurimi i cilësisë; udhëheqja e shkollës, zbatimit të kurrikulës në nivel shkolle; këshillimi i nxënësve; vlerësimi i arritjeve të nxënësve; përmirësimi i vazhdueshëm; etj.); ▪ Menaxhimi i proceseve ndihmëse (Përmirësimi i infrastrukturës, Zhvillimi i administratës, etj.); ▪ Menaxhimi i burimeve (menaxhimi i personelit - planifikimi dhe motivimi i personelit, menaxhimi i infrastrukturës, si dhomat/klasat, pajisjet etj.). Moduli 3 ka për qëllim t'i udhëzojë koordinatorët e cilësisë për përmirësimin e vazhdueshëm. Ai përqendrohet në elementet kyçe të ciklit për sigurim të cilësisë, me në fokus të veçantë në vetëvlerësimin e shkollës si mekanizëm i brendshëm për përmirësim të vazhdueshëm. Temat kryesore që shtjellohen në këtë modul janë: ▪ Definimi i përmirësimit të vazhdueshëm ▪ Cikli i cilësisë për zhvillimin e shkollës; ▪ Sistemi i vlerësimit të performancës së shkollës - vlerësimi i brendshëm/vetëvlerësimi dhe vlerësimi i jashtëm;
--	--

	▪ Hapat kryesorë të Vetë-vlerësimit të performancës së shkollës; ▪ Procesi i përmirësimit të vazhdueshëm; ▪ Shqyrtimi i efektivitetit të sistemit të menaxhimit të cilësisë.
Metodat e realizimit të programit	Modulet e programit trajnues sigurojnë informacione bazike sigurimin e cilësisë, menaxhimin e proceseve për sigurim të cilësisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shkollës, ndërlidhjen e tyre me kërkesat dhe nevojat e koordinatorëve të cilësisë dhe mundësitë për zbatim të efektshëm të detyrave për menaxhimin e cilësisë në shkollë. Koha në mes të mbajtjes së moduleve duhet të jetë së paku dy javë. Metodologjia e trajnimit mbështetet në metodologjitë, parimet dhe kërkesat, që lidhen me sigurimin duke patur parasysh përfshirjen aktive të koordinatorëve të cilësisë. Sesionet e trajnimit për secilin modul, janë kombinuar me prezantime, shpjegime të ilustruara me shembuj praktik, punë në grupe, ndërveprim, demonstrim dhe aktivitete atraktive, duke realizuar edhe detyra konkrete në kuadër të programit të trajnimit. Elementi kryesor i metodologjisë së punës së pjesëmarrësve në këtë program të trajnimit, është lidhja e teorisë e kuadrit ligjor me punën praktike të koordinatorëve të cilësisë. Trajnerët e programit janë përgatitur që të përdorin forma dhe metoda të trajnimit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë e vijuesve, por edhe shkathtësitë dhe qëndrimet e tyre për proceset, që lidhen me sigurimin e cilësisë në shkollë. Pjesë e metodologjisë për ofrimin e programit të trajnimit, janë: prezantime në PowerPoint në secilin modul, ligjërata, punë grupore, prezantime, diskutime, këshillim/trajnim kolegial, reflektim të nxënies, lehtësim/fasilitim, detyra praktike për përgatitje dhe realizim në vendin e punës.
Certifikimi	Certifikimi i pjesëmarrësve bazohet në: ▪ Pjesëmarrjen aktive në trajnim; ▪ Vlerësimit të nivelit të zbatimit të moduleve në punën e koordinatorëve të cilësisë përmes detyrave të prezantuara nga koordinatorët e cilësisë; ▪ Dëshmi kryesore për punën e koordinatorëve të cilësisë (pjesëmarrësve në trajnim) do të jetë portfolio e trajnimit me detyrat praktike që dalin nga secili modul dhe detyrat dëshmitë e realizimit të tyre, të cilën duhet ta përgatisë çdo pjesëmarrës në program, <i>si kusht për certifikim.</i>
Trajner	13
Data	08.05.2020

Titulli i Programit	SITOS Përdorues
Titulli i organizatës	Bit Kosova sh.a
Tipi i programit:	Program trajnues plotësues
Ofertuesi i programit:	Bit Kosova sh.a
Adresa:	rr. "Xheladin Hana"
E-mail:	diellza.shllaku@bit-kosova.com
Telefoni:	038-221-202
Numrat dhe data e aprovimit:	Nr. 60/20 Datë: 18.02.2020 (program i aprovuar për një vit)
Kohëzgjatja e programit(orë)	2 ditë / 16 orë
Përfituesit:	• Mësimdhënësit e të gjitha lëndëve mësimore • Punonjësit e administratës së shkollës • Menaxhmenti (drejtori) e shkollës
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	20 kandidatë
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Çdo përdorues i cili e përfundon me sukses këtë trajnim duhet të jetë në gjendje t'i kryej këto aktivitete/detyra: • Të krijojë njësinë mësimore në formë elektronike • Të bëjë importimin e përmbajtjeve elektronike në portalin e mësimi online • Të krijojë aktivitete (forum, blog, link, detyrë, dokument, pyetësor) • Të krijojë teste, kuize apo pyetësor për vlerësim • Të përcjellë progresin e nxënësve dhe • Të marrë raporte për punën dhe të arriturat e nxënësve • Të komunikojë me kolegët, nxënësit dhe menaxhmentin e shkollës
Përmbajtja:	Përmbajtja e programit SITOS: • Roli i përdoruesit në faqen fillestare ○ Desktopi im ○ Përmbajtjet mësimore ○ Katalogu ○ Mësimdhënësi ○ Profili im • Funkcionet e tutorit

	○ Krijimi/importimi/ndryshimi i përmbajtjeve ○ Krijimi i aktiviteteve ○ Krijimi i testeve ○ Aktivizimi i përmbajtjeve mësimore ○ Krijimi i shtegut të mësimi
Metodat e realizimit të programit	Metodologjia për realizimin e suksesshëm të programit përfshin: ○ Shembuj praktik përmes detyrave gjatë trajnimit ○ Mësimdhënësi në qendër ○ Aftësitë e trajnerit ○ Disponueshmëria e kandidatëve ○ Kombinim i materialeve tekst dhe video
Certifikimi	Certifikimi bëhet pasi që përdoruesi të përfundojë me sukses detyrën e dhënë pas trajnimit.
Trajner	10 trajnerë
Data	

Titulli i Programit	WBTplus
Titulli i organizatës	Bit Kosova sh.a
Tipi i programit:	Program trajnues plotësues
Ofertuesi i programit:	Bit Kosova sh.a
Adresa:	rr. "Xheladin Hana"
E-mail:	diellza.shllaku@bit-kosova.com
Telefoni:	038-221-202
Numrat dhe data e aprovimit:	Nr. 60/20 Datë: 18.02.2020 (program i aprovuar për një vit)
Kohëzgjatja e programit(orë)	3 ditë / 24 orë
Përfituesit:	• Mësimdhënësit e të gjitha lëndëve mësimore
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	20 kandidatë
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Çdo mësimdhënës i cili e përfundon me sukses këtë trajnim duhet të jetë në gjendje t'i kryej këto aktivitete/detyra: ○ Krijimi i përmbajtjes mësimore ○ Administrimi prej krijimit e deri tek eksportimi i përmbajtjes ○ Insertimi i faqes; ○ Insertimi i tekstit;

	○ Insertimi i fotografisë; ○ Insertimi i audios; ○ Insertimi i videos; ○ Vendosja e videos nga YouTube; ○ Insertimi i animacioneve; ○ Insertimi i flash animacioneve; ○ Krijimin e kuzit apo testit; ○ Aktivizimi i përmbajtjes mësimore.
Përmbajtja:	Përmbajtja e programit WBT plus: • Platforma WBTplus ○ Linku i platformës; ○ Faqja startuese; ○ Administrimi i përmbajtjes mësimore; ○ Kërkimi i përmbajtjeve; ○ Krijimi i përmbajtjes mësimore; ○ Administrimi prej krijimit e deri tek eksportimi i përmbajtjes. • Funksionet e përgjithshme të tastit ndihmës • Insertimi i objektit; • Kuizi dhe Testi.
Metodat e realizimit të programit	Metodologjia për realizimin e suksesshëm të programit përfshin: ○ Shembuj praktik përmes detyrave gjatë trajnimit; ○ Mësimdhënësi në qendër; ○ Aftësitë e trajnerit; ○ Disponueshmëria e kandidatëve; ○ Kombinim i materialeve tekst dhe video.
Certifikimi	Certifikimi bëhet pasi që përdoruesi të përfundojë me sukses detyrën e dhënë pas trajnimit.
Trajner	10 trajnerë
Data	Shkurt 2020

Titulli i Programit	School Update
Titulli i organizatës	Bit Kosova sh.a
Tipi i programit:	Program trajnues plotësues
Ofertuesi i programit:	Bit Kosova sh.a
Adresa:	rr. "Xheladin Hana"
E-mail:	diellza.shllaku@bit-kosova.com
Telefoni:	038-221-202
Numrat dhe data e aprovimit:	Nr. 60/20 Datë: 18.02.2020 (program i aprovuar për një vit)
Kohëzgjatja e programit(orë)	1 ditë / 8 orë
Përfituesit:	• Mësimdhënësit e të gjitha lëndëve mësimore; • Punonjësit e administratës së shkollës; • Menaxhmenti (drejtori) e shkollës.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	20-25 kandidatë
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Çdo përdorues i cili e përfundon me sukses këtë trajnim duhet të jetë në gjendje t'i kryej këto aktivitete/detyra: ○ Dërgimin e mesazheve të prindërit, ○ Vendosjen dhe arsyetimin e mungesave për nxënësit, ○ Vendosjen e detyrave të shtëpisë, ○ Caktimin e takimeve me prindër; ○ Vendosjen e materialeve mësimore; ○ Krijimin e anketimeve.
Përmbajtja:	Përmbajtja e programit SchoolUpdate: • Funksionet e përgjithshme ○ Mesazh njoftues ○ Mungesë ○ Kalendari ○ Detyrë shtëpie ○ Rekomandim për mësim ○ Anketim
Metodat e realizimit të programit	Metodologjia për realizimin e suksesshëm të programit përfshin: ○ Shembuj praktik përmes detyrave gjatë trajnimit; ○ Mësimdhënësi në qendër; ○ Aftësitë e trajnerit.

	○ Disponueshmëria e kandidatëve ○ Kombinim i materialeve tekst dhe video
Certifikimi	Në mbarim të trajnimit, pjesëmarrësit do t'i testojnë të gjitha funksionet dhe puna e tyre do të shërbejë si kriter për vlerësim.
Trajner	5 trajnerë
Data	Shkurt 2020

Titulli i Programit: Identifikimi i nxënësve me vështërsi në të nxënë	
Titulli i organizatës	EDUMEN-K
Tipi i programit:	Edukativë
Ofertuesi i programit:	EDUMEN-K
Adresa:	Zona Industriale, rruga "Lidhja e Pejës" Prishtinë
E-mail:	edumen.rks@gmail.com
Telefoni:	048751752
Numrat dhe data e aprovimit:	Nr 32/2020 03.02.2020 (program i aprovuar për një vit)
Kohëzgjatja e programit(orë)	6 ose 8 ditë Nr. i orëve 48
Përfituesit:	Të gjithë personat që kanë një diplomë universitare dhe kanë synim zhvillimin e njohurive të gjëra në identifikimin e nxënësve me vështërsi në të nxënë.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	Numri i kandidateve është i limituar jo më shumë se 25 kandidatë.
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Shpjegojnë konceptet themelore, që kanë të bëjnë me çështjet e përgjithshme të gjithëpërfshirjes; - Analizojnë dëmtimet dhe nivelet e kategorive të personave - fëmijëve me nevoja të veçanta; - Përvetësimi i njohurive elementare dhe i shkathësive të nevojshme për të inkuadruar personat me nevoja të veçanta në aktivitete. - Prezantojnë këndvështrimet e reja shkencore në hapësirën e vlerësimit dhe edukimit të fëmijëve me nevoja të veçanta; - Argumentojnë përdorimin e strategjive të mësimdhënies për fëmijët me nevoja të veçanta, veçanërisht fëmijëve me vështirësi në të nxënë, duke ua përshtatur mësimin shkallës së dëmtimeve të personave, duke zbatuar planin individual të edukimit (PIE); - Interpretojnë përparësitë e strategjive të mësimdhënies; - Të vizitojnë Qendra Burimore, Klasa të Bashkangjitura, Klasa inkluzive me qëllim të njohjes nga afër të vështirësive të fëmijëve - Të argumentojnë mundësinë e sendërtimit të edukimit inkluziv në institucionet shkollore në Kosovë.
Përmbajtja:	Me program janë paraparë IV module. Fondi orientues i orëve sipas moduleve paraqitet në vazhdim: 1. Identifikimi i fëmijëve me vështirësitë në të lexuar /

	disleksia- (6 orë teori dhe 6 orë praktikë) 2. Identifikimi i fëmijëve me vështirësitë në të shkruar/disgrafia (6 orë teori dhe 6 orë praktikë) 3. Identifikimi i fëmijëve me vështirësitë në shkathhtësite motorike/dispraksia (6 orë teori dhe 6 orë praktikë) 4. Identifikimi i fëmijëve me vështirësitë në matematikë/ diskalkulia (6 orë teori dhe 6 orë praktikë)
Metodat e realizimit të programit	Trajnimit realizohet përmes ligjeratave me pjesëmarrje fizike dhe online. Trajnimi realizohet përmes detyrave të ndryshme nga trajneret ku kandidatet janë të obliguar që në fund të trajnimit të i përcjellin për vlerësim.
Certifikimi	Kandidatet të cilët ndjekin me rregull çdo ligjeratë dhe përgadisnin protofoline certifikohen në fund të trajnimit
Trajner	2
Data e aplikimit	20. 01. 2020

Titulli i Programit	Qasja dhe mësimdhënia e diferencuar për fëmijet me nevoja të veçanta
Titulli i organizatës	EDUMEN-K
Tipi i programit:	Edukativ
Ofertuesi i programit:	EDUMEN-K
Adresa:	Rruga “Lidhja e Pejes” nr 206, Prishtine
E-mail:	edumen.rks@gmail.com
Telefoni:	048751752
Numrat dhe data e aprovimit:	Nr 32/2020 03.02.2020 (program i aprovuar për një vit)
Kohëzgjatja e programit(orë)	8 ose 10 ditë Nr. i orëve 60
Përfituesit:	Të gjithë personat që kanë një diplom universitare dhe kanë synim zhvillimin e njohurive të gjerave në qasje dhe mësimdhënia e diferencuar për fëmijet me nevoja të veçanta

Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	Numri i kandidateve është i limituar jo më shumë se 25 kandidatë
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Zhvillojnë një të kuptuar më të thellë për parimet e mësimdhënies së diferencuar; Planifikojnë qasje të ndryshme në mësimdhënie për arritjen e rezultateve të dëshiruara për nxënësit e ndryshëm; Demonstrojnë modifikimin e materialeve dhe detyrave mësimore si dhe përshtatjen e aktiviteteve mësimore, nevojave grupore dhe individuale të nxënësve; Argumentojnë përdorimin e programeve të individualizuara për nxënësit me vështirësi specifike në të nxënë apo për xënësit e talentuar dhe me dhunti. Zhvillojnë një të kuptuar të ndjeshëm ndaj karaktersitikave të nxënësve dhe një qëndrim të shëndoshë ndaj punës së vet dhe ndaj nxënësve, të cilëve iu shërbejnë, pavarësisht se sa sfidues ose të zgjuar mund të jenë ata.
Përmbajtja:	Me program janë paraparë IV module. Fondi orientues i orëve sipas moduleve paraqitet në vazhdim: 5. Mësimdhënia e diferencuar: Kuptimi, diversiteti në klasë dhe nevoja për zbatimin 6. e saj - (7 orë teori dhe 8 orë praktikë) 7. Mësimdhënia e diferencuar bazuar në profilet e nxënësve (7 orë teori dhe 8 orë praktikë) 8. Programi i individualizuar i edukimit/arsimit: Qëllimi dhe përmbajtja e dokumentit të PIA-së (5 orë teori dhe 10 orë praktikë) 9. Zbatimi i Planit Individual të Arsimit në klasat me mësimdhënie të difrencuara (5 orëteoridhe 10 orë praktikë)

Metodat e realizimit të programit	Trajnimi realizohet përmes ligjeratave me pjesëmarrje fizike dhe online. Trajnimi realizohet përmes detyrave të ndryshme nga trajneret, ku kandidatet janë të obliguar që në fund të trajnimit të i përcjellin për vlerësim. Për sigurimin e cilësisë së programit praktikohet kjo metodologji e punës: • Skedat e daljes • Fletëvleresimet e pjesëmarrësve • Testimet e vazhdueshme në fund të çdo moduli • Vlerësimi
Certifikimi	Kandidatet të cilet ndjekin me rregull çdo ligjeratë dhe pergadisin protofoline certifikohen ne fund te trajnimit
Trajner	2
Data	20.01.2020

Titulli i Programit	Arsimi Gjithëpërfshirës: Vizioni dhe konceptet e arsimit gjithëpërfshirës, puna e përbashkët dhe mjediset që ndihmojnë të nxënut e individualizuar
Titulli i organizatës	KAPIE – Kosovo Association for Promotion of Inclusive Educaton
Tipi i programit:	Program trajnues themelor
Ofertuesi i programit:	KAPIE
Adresa:	Rruga “Tringë Smajli”, Llam. 1, Nr. 6-1, 10000- Prishtinë.
E-mail:	kapie.inclusion@gmail.com
Telefoni:	+38344373491
Numrat dhe data e aprovimit:	Nr. 54/2020, datë 03/02/2020 (program i aprovuar për një vit)
Kohëzgjatja e programit(orë)	72 orë / 3 module
Përfituesit:	Drejtorët, mësimdhënësit e shkollave të rregullta, edukatorët, psikologët dhe stafi tjetër i shkollës
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	20 – 30 pjesëmarrës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Arsimtarët dhe edukatorët pas trajnimit marrin njohuritë themelore për konceptet bazë të arsimit gjithëpërfshirës, për rëndësinë, që ka zhvillimi profesional në arsimin

gjithëpërfshirës, me përcaktimin e kompetencave për mësimdhënësin gjithëpërfshirës, njohja me paragjykimet që ndikojnë në veprimet e tyre dhe pjesëmarrësit zhvillojnë vizionin për mësimdhënësin gjithëpërfshirës.

Pjesëmarrësit poashtu marrin njohuri për rëndësinë e komunikimit në marrëdhënie midis njerëzve, marrëdhëniet profesionale, fokusimin në bashkëpunim, kufizimet në pjesëmarrje dhe strategjitë për identifikimin e kufizimeve të pjesëmarrjes.

Pjesëmarrësi njihen edhe me KNF-në (Klasifikimi ndërkombëtar i funksionimit) dhe strategjive të ndryshme për zgjidhjen e problemeve duke vendosur pjesëmarrjen e individit në qendër dhe duke e analizuar atë sipas perspektivës zhvillimore, të shëndetit, të marrëdhënieve dhe të kurrikulit. KNF në këtë trajnim ofrohet në aspektin pedagogjik dhe nuk ka për qëllim të fokusohet në aspektin mjekësor të aftësisë së kufizuar të individit.

Pjesëmarrësit do të njihen edhe me mjediset, që ndihmojnë të nxënit e individualizuar, me mënyrat e hartimit të objektivave afatshkurta, afatmesme dhe afatgjata, si të ndërthuren objektivat me situatat e të nxënit, mënyrat si të përmirësohet pjesëmarrja në klasë dhe si të hartohen plane individuale në të nxënë.

Gjatë trajnimit, i cili është mjaft ndërveprues, jepen edhe instrumente, të cilat më pas pjesëmarrësit e trajnimit mund t'i shfrytëzojnë në punën e tyre për ta bërë mësimdhënien e tyre më ndërveprues dhe më të individualizuar për të plotësuar nevojat individuale të ndryshme të nxënësve.

Përmbajtja:

Moduli i parë: Vizioni, Teoria dhe Konceptet

Hyrje në arsimin gjithëpërfshirës

Krijimi i një bashkësie të nxënit gjithëpërfshirës në kuadër të grupit të trajnimit.

Analiza e përbashkët e gjendjes së arsimit gjithëpërfshirës

Shpjegimi i të kuptuarit dhe përkufizimi i fillestar i arsimit gjithëpërfshirës.

Roli i mësimdhënësit si promotor i ndryshimit

Të kuptuarit e rëndësisë që ka zhvillimi profesional për arsimin gjithëpërfshirës.

Përcaktimi i kompetencave për arsimin gjithëpërfshirës.

Ndërgjegjësimi rreth paragjyimeve, që ndikojnë në veprimet tona në lidhje me diversitetin;

Njohja e disa prej dallimeve ndërmjet mësimdhënësve

filleshtarë, mësimdhënësve me përvojë dhe mësimdhënësve profesionistë;
Zhvillimi i vizionit personal për mësimdhënësin gjithëpërfshirës;
Të kuptuarit e paragjykimeve, brenda grupit, jashtë grupit (favorizimi brenda në grup) dhe si lidhet kjo me etiketimin;
Njohja e përmasave më të rëndësishme të larmisë;
Të kuptuarit e ciklit të cenimit të të drejtave dhe cikli personal i fuqizimit;
Të menduarit si njohuritë për etiketimet, paragjykimet, cenimin e të drejtave dhe fuqizimin mund të jenë të dobishme për shkollën tuaj.

Përkrahja e të gjithë nxënësve;
Pikënisja nga mënyrat vetjake të reflektimit rreth të nxënit dhe arritjes;
Njohja me modelin që mund të ndihmoj të kuptuarit e situatave të nxënit;
Të nxënit si rezultat i pjesëmarrjes e jo vetëm arritje
Të kuptuarit dhe organizimi i kushteve të ndryshme dhe zbatimi në praktikë;
Puna me të tjerët, me komunitetin për një shkollë gjithëpërfshirëse;
Krijimi i vizionit për arsim gjithëpërfshirës për planifikim të veprimeve së bashku me kolegët, nxënësit dhe me komunitetin;
Reflektimi i gjithë modulit të parë dhe identifikimi i nevojave për informata dhe shpjegime shtesë.

Moduli i dytë: Puna së bashku për krijimin e shkollave gjithëpërfshirëse

Të menduarit për rëndësinë e komunikimit në marrëdhëniet mes njerëzve;
Përpilimi i skicës së marrëdhënieve profesionale personale;
Të kuptuarit e komunikimit si një veprimtari e përbashkët;
Fokusimi në bashkëpunimin që nxitë pjesëmarrjen;
Të kuptuarit e kufizimeve të pjesëmarrjes;
Përdorimi i perspektivave të ndryshme për analizimin e kufizimeve të pjesëmarrjes;
Zhvillimi i strategjive, që mund të përdorën për hulumtimin e kufizimeve të pjesëmarrjes.

Njohja e KNF – Klasifikimit ndërkombëtar të funksionimit (ICF) si një kornizë e zakonshme e bashkëpunimit (Konteksti i shëndetit dhe mirëqenies).
Zhvillimi i strategjive të bashkëpunimit krahas ciklit për

zgjidhjen e problemeve.
Njohja dhe krijimi i mjeteve që ndihmojnë jetësimin e këtyre strategjive.
Krijimi i ekipeve dhe komuniteteve të gjithëpërfshirjes.
Arritja e të kuptuarit të qëllimeve dhe aktiviteteve të ekipit gjithëpërfshirës;
Shqyrtimi i njohurive të mësuara deri më tani dhe si e ndihmon kjo formimin e ekipit gjithëpërfshirës;
Zhvillimi i strategjive për të ndërtuar komunitetet gjithëpërfshirëse të nxënit;
Shqyrtimi dhe reflektimi për njohuritë e marra në modulin e dytë dhe njohuritë tjera që pjesëmarrësit janë të interesuar t'i marrin.

Moduli i tretë: Mjediset që ndihmojnë të nxënit e individualizuar.

Zbatimi i njohurive të marra deri më tani për analizën e situatave të nxënit;
Të mësohet analiza e situatës nga perspektiva e mësimdhënësit dhe nga ajo e nxënësve;
Praktika e fokusimit në situata në vend se të fokusohemi në karakteristika e nxënësve;
Zhvillimi i objektivave kuptimplote të nxënit.
Zbatimi i qasjes ndaj ciklit të jetës gjatë hartimit të objektivave
Ndërtimi i kapaciteteve për hartimin e objektivave kuptimplota afatshkurta, afatmesme dhe afatgjatë
Mësimi si të ndërthuren objektivat me situatat e të nxënit
Njohja e mënyrave si mund të përmirësohet pjesëmarrja në klasë

Zbatimi i asaj, që është mësuar deri më tani për të hartuar plane individuale në të nxënë.
Zhvillimi i strategjisë për bashkëpunim, që do të zbatohet në shkollën tuaj;
Krijimi i projekt instrumenteve e metodave, që mund t'i zbatoni në shkollën tuaj;
Zhvillimi i strategjive për arritjen e arsimit gjithëpërfshirës;
Reflektimi mbi njohuritë e marra në të gjitha modulet;
Secili kandidat, që ka ndjekur së paku 6 ditë trajnimi apo 42 orë trajnimi, mund të pajiset me certifikatë.

Metodat e realizimit të programit	Prezantime, diskutime, punë individuale, punë në çifte, punë në grupe, sesione plenare, luajtje rolesh
Certifikimi	Të gjithë pjesëmarrësit do të çertifikohen me certifikatë sipas vijueshmërisë së tyre
Trajner	6
Data e aplikimit	20/01/2020

Titulli i Programit	Bashkëpunimi me prindër dhe komunitet
Titulli i organizatës	KAPIE – Kosovo Association for Promotion of Inclusive Education
Tipi i programit:	Program trajnues themelor
Ofertuesi i programit:	KAPIE
Adresa:	Rruga “Tringë Smajli”, Llam. 1, Nr. 6-1, 10000 Prishtinë.
E-mail:	kapie.inclusion@gmail.com
Telefoni:	+38344373491
Numrat dhe data e aprovimit:	Nr. 53/2020, datë 03/02/2020 (program i aprovuar për një vit)
Kohëzgjatja e programit(orë)	24 orë
Përfituesit:	Mësimdhënësit e rregullt të shkollave të rregullta, mësimdhënësit e qendrave burimore, edukatorët, psikologët, mësimdhënësit mbështetës, asistentët për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	20 – 30 pjesëmarrës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Pjesëmarrësit në trajnim do të pajisen me njohuri të reja rreth faktorëve që ndikojnë në rritjen e përfshirjes së familjes dhe komunitetit në proceset e shkollës duke filluar nga: - Pjesëmarrësit e trajnimit diskutojnë dhe analizojnë rëndësinë e përfshirjes së familjes në dinamikën e shkollës; - Përcaktojnë dhe arsyetojnë parimet e partneritetit mes shkollës dhe familjes; - Analizojnë dhe përcaktojnë pengesat apo vështirësitë në raport me bashkëpunimin dhe komunikimin me familjen; - Diskutojnë për përfitimet, që kanë fëmijët, prindërit, mësimdhënësit nga bashkëpunimi me familjen dhe komunitetin; - Reflektojnë dhe përcaktojnë metodat dhe format më efektive për të arritur partneritet të mirefilltë me prindër dhe komunitet; - Shqyrtojnë profesionet, profilet dhe interesat e familjes për të përfshirë në aktivitete të shkollës; - Zhvillojnë plan veprimi për partneritetin mes shkollës, familjes dhe komunitetit.
Përmbajtja:	Dita e parë e trajnimit - Rëndësia e përfshirjes së familjes në dinamikën e shkollës; - Parimet e partneritetit mes shkollës dhe familjes;

	- Përfitimet/ dobitë nga bashkëpunimi me familjen dhe komunitetin. Dita e dytë: - Metodatat dhe format e partneritetit mes shkollës dhe familjes; - Pengesat apo vështirësitë në raport me bashkëpunimin dhe komunikimin me familjen. Dita e tretë - Shqyrtimi i interesave të familjes dhe komunitetit; - Identifikimi i profileve, hobive, profesioneve të prindërve dhe anëtarëve të komunitetit; - Hartimi i planit të partneritetit mes shkollës, familjes dhe komunitetit.
Metodat e realizimit të programit	Prezantime, diskutime, reflektime personale, punë individuale, punë në çifte, punë në grupe, sesione plenare, luajtje rolesh;
Certifikimi	Të gjithë pjesëmarrësit do të çertifikohen me çertifikatë sipas vijueshmërisë së tyre.
Trajner	4
Data	19/08/2020

Titulli i Programit	Hartimi i Planit Individual të Arsimit – PIA
Titulli i organizatës	KAPIE – Kosovo Association for Promotion of Inclusive Education
Tipi i programit:	Program trajnues themelor
Ofertuesi i programit:	KAPIE
Adresa:	Rruga “Tringë Smajli”, Llam. 1, Nr. 6-1, 10000, Prishtinë.
E-mail:	kapie.inclusion@gmail.com
Telefoni:	+38344373491
Numrat dhe data e aprovimit:	Nr. 53/2020, datë 03/02/2020 (program i aprovuar për një vit)
Kohëzgjatja e programit(orë)	24 orë / 3 ditë trajnimi
Përfituesit:	Mësimdhënësit e rregullt të shkollave të rregullta, mësimdhënësit e qendrave burimore, edukatorët, psikologët, mësimdhënësit mbështetës, asistentët për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	20 – 30 pjesëmarrës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Pjesëmarrësit në trajnim do të pajisen me njohuri të reja rreth përdorimit të PIA-së në procesin e rregulltë mësimor si dhe mënyrën e aplikimit të tij si mbështetje e

domosdoshme për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore: Pjesëmarrësit përmes trajnimit kanë mundësi të marrin informata tbazë rreth tërë procesit të hartimit të PIA-së duke filluar nga rëndësia e përdorimit të PIA-së; ndërlidhjen e PIA-së me kurrikulën, kush e bënë vlerësimin dhe merr vendimin për përdorim të PIA-së, kush duhet të ketë një PIA, kush janë përgjegjësit për inicimin e hartimit të PIA-së, kush organizon takimet, kush merr pjesë në takime, sa shpesh duhet rishikuar PIA-në, etj.

Po ashtu gjatë sesioneve të trajnimit shpjegohet çdo pjesë e kornizës së PIA-së se si plotësohet, si përcaktohen qëllimet vjetore, rezultatet e pritura, metodat dhe format e punës, format e vlerësimit, mbështetjet, që duhet përcaktuar për fëmijën, personat që do të mbështesin fëmijën për të arritur performancë të mirë, etj.

Gjatë trajnimit pjesëmarrësit arrijnë të përdorin një shtojcë të vlerësimit pedagogjik të fëmijës e cila jep një pasqyrë të përgjithshme të funksionimit të fëmijës që shërben tutje në përcaktimin e qëllimit dhe rezultateve mësimore.

Në fund të trajnimit secili mësimmhënës harton një PIA për një nxënës duke pasur rast të planifikojnë në ekip dhe me pjesëmarrje të prindërve.

Përmbajtja:

Dita e parë:

- Rëndësia dhe përmbajtja e Planit Individual të arsimit (PIA)
- Elementet, që e përcaktojnë PIA si proces dhe si produkt?
- Si ndërlidhet PIA me Kurrikulën?
- Vlerësimi dhe vendimi mbi arsimin me nevoja të veçanta arsimore?
- Arsytet për vendimin për arsim me nevoja të veçanta arsimore?
- Kush duhet të ketë një PIA?
- Kush është përgjegjës për incimin e hartimit të PIA-së?
- Kush i organizon takimet për hartimin e PIA-së?
- Kush merr pjesë në takimet për hartimin e PIA?
- Sa shpesh duhet rishikuar një PIA?
- Kush duhet ta plotësojë PIA?

Dita e dytë:

- Prezantim- Korniza e Planit Individual të Arsimit.
- Pjesa administrative,
II. Pjesa pedagogjike;
III. Pjesa e rehabilitimit (në rastet kur fëmija merr

	shërbime rehabilituese); IV. Pjesa e tranzicionit (faza kalimtare); • Qëllimet edukative, arsimore të fëmijës për periudhën që zgjat plani individual. • Rezultatet e të nxënit të fëmijës përmes të cilave realizohet qëllimi i vendosur. • Metodat, teknikat dhe format e punës të nevojshme për të realizuar rezultatet e të nxënit; • Burimet e nevojshme për shërbimet që duhet ofruar si dhe burimet ekzistuese; • Përmbajtjen e lëndëve mësimore të individualizuara ose fushave të aktiviteteve; • Format e vlerësimit të fëmijës; • Procesin e monitorimit dhe rishikimit të tij. Dita e tretë: • Analizë dhe reflektim të Udhëzuesit për përdorim të Planit Individual të Arsimit. • Shtojca për vlerësimin e fëmijëve sipas fushave zhvillimore. Hartimi i PIA për një fëmijë me nevoja të veçanta arsimore në grupe.
Metodat e realizimit të programit	Prezantime, diskutime, reflektime personale, punë individuale, punë në çifte, punë në grupe, sesione plenare. Gjatë trajnimit do të përdoren teknikat e punës, si: analizë e rasteve studimore, vlerësimi i fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore si dhe shkëmbim përvojash.
Certifikimi	Të gjithë pjesëmarrësit do të certifikohen me certifikatë sipas vijueshmërisë së tyre
Trajner	6
Data	20/01/2020

Titulli i Programit	Parandalimi i dhunës në shkollë
Titulli i organizatës	KAPIE – Kosovo Association for Promotion of Inclusive Education
Tipi i programit:	Program trajnues themelor dhe program plotësues
Ofertuesi i programit:	KAPIE
Adresa:	Rruga “Tringë Smajli”, Llam. 1, Nr. 6-1, 10000 Prishtinë.
E-mail:	kapie.inclusion@gmail.com
Telefoni:	+38344373491
Numrat dhe data e aprovimit:	Nr. 54/2020, datë 03/02/2020 (program i aprovuar për një vit)
Kohëzgjatja e programit(orë)	32 orë
Përfituesit:	Drejtorët, mësime dhënësit e shkollave të rregullt, edukatorët, psikologët dhe stafi tjetër i shkollës
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	20 – 30 pjesëmarrës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	- Pjesëmarrësit në trajnim do të pajisen me njohuri të reja rreth faktorëve që ndikojnë në shfaqjen e dhunës në shkollë; - Identifikimin e sjelljeve që çojnë në dhunë në shkollë; - Të zbatojnë disiplinën pozitive në shkollë dhe klasë; - Si menaxhohet klasa me qëllim të parandalimit të dhunës në klasë dhe shkollë - Njohja me konceptin e bullizmit, llojeve dhe pasojave të tij; - Njohja dhe përdorimi i masave për parandalimin e bullizmit në nivel klase dhe shkolle - Bashkëpunimi dhe mënyrat e pjesëmarrjes së prindërve e komunitetit të shkollës në parandalimin e dhunës - Mënyrat e vlerësimit të aktiviteteve për parandalimin e dhunës në shkollë
Përmbajtja:	Dita e parë e trajnimit: Shkolla si mjedis i sigurt dhe pa dhunë Faktorët që ndikojnë në sjelljen agresive të nxënësve dhe dhunën në shkollë. Qëndrimet e mësime dhënësit ndaj dhunës dhe shkathtësitë e tyre. Identifikimi i sjelljeve agresive dhe të dhunshme në klasë/shkollë. Dita e dytë Disiplina pozitive në klasë dhe në shkollë; Menaxhimi i klasës / parandalimi i sjelljes problemore; Parandalimi i dhunës me anë të aktiviteteve me bazë kurrikulare; Intervenimi në sjelljen problemore – Mësimdhënia e

	sjelljeve alternative; Dita e tretë Ngacmimi (bullizmi). Llojet e bullizmit dhe pasojat e tij. Masat për parandalimin e bullizmit. Hartimi i rregullave për parandalimin e bullizmit. Dita e katërt Përshtatja e mjediseve fizike në klasë dhe shkollë; Përfshirja e prindërve në aktivitetet për parandalimin e dhunës; Përfshirja e komunitetit në aktivitetet për parandalimin e dhunës; Vlerësimi i aktiviteteve për parandalimin e dhunës.
Metodat e realizimit të programit	Prezantime, diskutime, reflektime personale, punë individuale, punë në çifte, punë në grupe, sesione plenare, luajtje rolesh.
Certifikimi	Të gjithë pjesëmarrësit do të certifikohen me certifikatë sipas vijueshmërisë së tyre.
Trajner	4
Data	20/01/2020

Titulli i Programit	Parandalimi i përdormimit të gjuhës urrejtëse të nxënësve në mediet social'
Titulli i organizatës	OJQ 'Mbështetja'
Tipi i programit:	Plotësues
Ofertuesi i programit:	OJQ 'Mbështetja'
Adresa:	"Agim Ramadani" AI/68, Prishtinë
E-mail:	Ojqmbeshtetja@outlook.com blerona_94@hotmail.com
Telefoni:	+38345401711
Numrat dhe data e aprovimit:	Nr. 009/2020 Datë: 03.02.2020 (program i aprovuar për një vit)
Kohëzgjatja e programit (orë)	Ditët e trajnimit me pjesëmarrje : Realizimi i trajnimit përfshin 4 ditë e gjysmë trajnim me pjesëmarrje (prezencë në seancat e trajnimit) të ndara në dy pjesë, sipas shpërndarjes: Pjesa I: 2, 5 ditë = 15 orë trajnim. Pjesa II : 2 ditë trajnim = 12 orë trajnim. Gjithsej= 27 orë trajnim me pjesëmarrje. Detyrat praktike: pas secilës pjesë të trajnimit, pjesëmarrësit i jepen 5 orë për të përfunduar një detyrë apo projekt të caktuar. Pra, secili pjesëmarrës, gjatë programit të trajnimit realizon të paktën 10 orë punë praktike.

	Gjithsej janë 37 orë trajnim të bartura në certifikim.
Përfituesit:	Trajnimi është përgatitur për mësime dhënësit/et e të gjitha niveleve të arsimit parauniversitar, nxënësit e niveleve përkatëse dhe prindër. Ekipet e mësime dhënëseve, nxënësve dhe prindërve nga e njëjta shkollë pritet që të marrin pjesë dhe të bashkëpunojnë për realizimin e detyrave të marra pas çdo pjese të trajnimit. Pjesëmarrja e tyre duhet të jetë në pajtimin dhe me mbështetje nga drejtori i shkollës dhe këshilli i shkollës (Këshilli Drejtues i Shkollës).
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	20-25
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Objektivat e programit: • Të informojë mësime dhënësit, nxënësit dhe komunitetin e shkollës për prezencën e gjuhës urrjetëse në shkollë, të shprehur përmes mediave sociale 'online' dhe 'offline', • Të diskutojë me mësime dhënësit, nxënësit dhe komunitetin e shkollës për lirinë dhe të drejtën e shprehjes së mendimit të lirë dhe jo diskriminues në media, si dhe politikën ndërkombëtare dhe vendore, që garantojnë dhe sigurojnë respektimin e kësaj të drejte, • Të sensibilizojë akterët e shkollës për rreziqet dhe pasojat e përdorimit të një gjuhe urrjetëse në shkollë dhe shoqëri; • Të promovojë respektimin e lirisë së të shprehurit, qytetarisë demokratike, vlerave njerëzore, diversitetit, si dhe gjuhës së drejtë të komunikimit në mes të njerëzve, • Të zhvillojë përvoja pozitive të komunikimit të drejtë dhe bashkëpunues në mes të nxënësve, mësime dhënëseve, prindërve dhe akterëve të shkollës, si dhe të promovojë rolin pozitiv të mediave sociale në këtë mes.
Përmbajtja:	<u>Përmbajtja e trajnimit për PJESEN I</u> Hapja, prezantimet, objektivat, rregullat, pritshmëritë, programi, Gjuha urrjetëse 'online' dhe 'offline'. Pasojat nga përdorimi i gjuhës urrjetëse nga ana e nxënësve, Dallimi i gjuhës urrjetëse nga konceptet e përafërta. – Gjuha urrjetëse dhe diskriminimi nga nxënësit; – Gjuha urrjetëse, ofendimi dhe shpifja; – Gjuha urrjetëse e nxënësve në mediet sociale; – Mediet dhe gjuha urrjetëse;

	- Redaktorët e shkrimeve ose programeve televizive - përgjegjësit. - Qasja në parandalimin e përdorimit të gjuhës urrejtëse; - Studimet për ngacmimin dhe për mbrojtjen nga diskriminimi; - Ngacmimi dhe udhëzimi sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; - Ngacmimet kibernetike. - Rezultatet e studimit : “Gjuha urrejtëse e nxënësve në mediet social” MASHT/IPK- diskutimi i gjetjeve, - Ndarja e detyrve të shtëpisë: Rastet studimore në shkolla. <u>Përmbajtja e trajnimit për PJESËN II</u> Hapja e pjesës së dytë të trajnimit dhe diskutimi i detyrave të shtëpisë lidhur me rastet studimore dhe kategorizimi i tyre; - Trajtimi i temave të dala nga rastet studimore : - Ngacmimi seksual - Sajberdhuna (cyberbulling); - Rrjetet sociale; - Postimi i fotografive dhe videove në internet; - Telefoni celular; - Lojërat në internet; - Dhomat e diskutimit; - Ngacmimet kibernetike; - Informacione dhe këshilla praktike (të bazuara në literaturë dhe hulumtimin IPK/MASHT) për parandalimin dhe reagimin ndaj përdorimit të gjuhës urrejtëse në shkollë dhe shoqëri; - Shpërndarja e informatorëve dhe broshurave me temë përkatëse për parandalimin dhe reagimin ndaj gjuhës urrejtëse në shkollë dhe shoqëri. - Mbyllja e pjesës 2: Detyrat për më tutje dhe vlerësimi. - Mbyllja e trajnimit.
Metodat e realizimit të programit	Trajnimi është strukturuar në dy pjesë (seanca), që do të ofrohen gjatë fundjavave gjatë vitit akademik dhe përfundon me një vlerësim në fund të trajnimit. Pas çdo pjese, pjesëmarrësit marrin detyra specifike për t’i zbatuar në shkollat e tyre, në mënyrë individuale ose së bashku me

	pjesëmarrës të tjerë nga e njëjta shkollë. Detyrat janë hartuar në atë mënyrë, që mundësojnë dhe mbështesin arritjen e objektivave të trajnimit: informit, senzibilizit, identifikit dhe zbatimit të përvojave pozitive. Metodologjia që do të zbatohet në trajnim është një kombinim i : - Ligjerimeve dhe prezantimeve; - Ushtrimeve interaktive, të cilat, në pjesën më të madhe mund të përsëriten ose të përshtaten për përdorim me nxënësit; - Punës grupore; - Punës individuale. Në trajnim u ipet prioritet zbatimit të metodat interaktive dhe aktivitetet që stimulojnë reflektimin, bashkëpunimin dhe kreativitetin. Në seancat e fundit të trajnimit jepet hapësirë për t’ju përgjigjur nevojave shtesë specifike të pjesëmarrësve me qëllim të adresimit të temave të tjera të ndërlidhura ose thellimin e atyre temave që janë adresuar/ trajtuar tashmë në seancat e mëparshme.
Certifikimi	Certifikatë e lëshuar nga OJQ ‘ Mbështetja’ dhe e vërtetuar, nënshkruar dhe vulosur nga departamenti përkatës në MASHT. Kriteret: - 95% pjesëmarrje në seancat e trajnimit - 100% realizim i detyrave praktike
Trajner	3
Data	27.01.2020

Titulli i Programit	Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie
Titulli i organizatës	Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK)
Tipi i programit:	Program trajnues themelor
Ofertuesi i programit:	SBASHK
Adresa:	Rr.” Agim Ramadani”, pa nr. - Qendra e Studentëve 10000 Prishtinë
E-mail:	Sbashk2004@yahoo.com , info@sbashk-rks.org
Telefoni:	+ 383(0) 38 226 940
Numrat dhe data e aprovimit:	Nr.38/2020 data 31.01.2020 Programi aprovohet për një vit nga ana e MASHT-it
Kohëzgjatja e programit(orë)	(orë): 103 (51+52)

Përfituesit:	Ky program i dedikohet përfaqësuesve të MASHT, të DKA, drejtorëve të shkollave, udhëheqësve sindikal si dhe mësime dhënëse të niveleve të ndryshme. Po ashtu, programi mund të jetë i dobishëm edhe për studentët e fakulteteve, që përgatisin mësime dhënëse të ardhshme dhe të atyre, që ofrojnë kurse lidhur me teknologjinë e informacionit.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	25 - 32
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Me përvetësimin e këtij Programi pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje: Të njohin bazat themelore të teknologjisë së informacionit; Të njohin sistemet operative; Të fitojnë shkathtësi për zbatimin e MS Outlook 2013; Të fitojnë shkathtësi për përdorimin e MS Word 2013; Të fitojnë shkathtësi për përdorimin e MS Excel 2013; Të fitojnë shkathtësi për përdorimin e MS PowerPoint 2013; Të fitojnë shkathtësi për përdorimin e MS Access 2013; Të fitojnë shkathtësi për përdorimin e Internetit.
Përmbajtja:	-Zhvillon aktivitete të mësime dhënëse, që përfshijnë strategji të diferencuara për t'i angazhuar të gjithë nxënësit si dhe për t'i përmbushur nevojat e veçanta të nxënësve me aftësi të ndryshme. (Fusha 2; Standardi 3;Pika 3.3). -Themelon dhe ruan një rutinë, që ka rregull dhe është funksionale për krijimin e një mjedisi, ku koha e nxënësit kalohet duke kryer detyra mësimore; Sjelljet sfiduese trajtohen duke përcaktuar pritje të qarta të nxënësit si dhe duke i trajtuar çështjet disiplinore me kujdes,drejt dhe me respekt të plotë (Fusha 2;Standardi 3;Pika 3.4). -Harton, përzgjedh dhe shfrytëzon strategji joformale,formale diagnostike dhe përmbledhëse për vlerësimin e mësimit të nxënësve/për verifikimin e nivelit të arritjes së nxënësve sa i përket njohurive,,sjelljeve dhe shkathtësive. Bën plan të thjeshtë për plotësimin e zbrastësirave të arriturat e nxënësve. (Fusha 3;Standardi 5;Pika 5.1). -Themelon dhe ruan marrëdhënie të respektueshme bashkëpunimi me prindër/kujdestarë sa i përket mësimit të mirëfilltë dhe mirëqenies së nxënësve dhe i ndihmon që të bëhen pjesëmarrës aktiv në arsimimin e fëmijëve: (Fusha 4;Standari 7; Pika 7.2). -Identifikon problematika të ndryshme në klasë të cilat mund të jenë fokus i hulumtimeve në veprim (Fusha 4;Standardi 7; Pika 7.4).

Metodat e realizimit të programit	Programi organizohet në formë të trajnimit.
Certifikimi	Certifikatë
Trajnerë	38
Data e aplikimit	20.01.2020

Titulli i Programit	Edukimi medial dhe roli i tij në zhvillimin shoqëror dhe demokratik
Titulli i organizatës	Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK)
Tipi i programit:	Program trajnues themelorë
Ofertuesi i programit:	SBASHK
Adresa:	Rr." Agim Ramadani", p.n. - Qendra e Studentëve 10000 Prishtinë
E-mail:	Sbashk2004@yahoo.com , info@sbashk-rks.org
Telefoni:	+ 383(0) 38 226 940
Numrat dhe data e aprovimit:	Nr.38/ 2020 data 31.01.2020 Programi aprovohet për një vit nga ana e MASHT-it
Kohëzgjatja e programit (orë)	(orë): 32
Përfituesit:	Ky program u dedikohet mësimeve të shkencave sociale (Edukatë qytetare dhe shoqërore, Sociologji, etj.) në shkollat të mesme dhe fillore, me qëllim të përgatitjes së tyre për këtë fushë të rëndësishme e tërësisht të re. Po ashtu, ky trajnim mund t'iu shërbejë edhe udhëheqësve të shkollave, në funksion të raportit të tyre me media, si dhe udhëheqësve sindikal si një formë qasjeje ndaj medieve. Programi i lëndës "Edukim për media" në shkollat të mesme është futur në pilotim nga MASHT disa vite më herët ndërkohë që Bashkimi Evropian ka rekomanduar vendet e veta anëtare, që kjo lëndë të përfshihet në kuadër të planeve mësimore në shkollimin para universitar. Grupi i mësimeve, që synohet nga ky trajnim, konsiderohet si mësime më të përafërt me fushën e mediave, prandaj, potencialisht janë edhe njerëzit, që do të merrnin njohuritë e duhura për këtë fushë të re e të rëndësishme e pastaj do të ishin edhe bartës të kësaj lënde në arsimin para-universitar.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	25 - 32
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Me përvetësimin e këtij Programi pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje: Qëllimet e këtij programi është që të nxisë të menduarit kritik tek pjesëmarrësit në këtë program, të jenë në gjendje

	të kuptojnë se si mediat masive ndikojnë në jetën dhe në pikëpamjet e pjesëmarrjeve në trajnim. Të fitojnë shkathtësi relevante për zbatimin e formave të ndryshme të konstruktiveve mediatike. Pjesëmarrësit në këtë program do të aftësohen që të kuptojnë rolin dhe strategjitë e mediave masive në konstruktimin e proceseve shoqërore, kulturore dhe politike. Përfaqësuesit e ndryshëm pjesëmarrës në këtë program do të aftësohen që t'i analizojnë lloje të ndryshme të medias përfshirë imazhe, video, lojëra dhe internet. Ata do të krijojnë aftësi të edukimit që do t'u mundësojnë vetëdijësim gjatë të nxënësve gjatë gjithë jetës. Gjithashtu grupi bërtham pjesëmarrës në këto trajnime do të jenë të aftë që të kuptojnë dhe përdorin koncepte dhe terminologji të edukimit medial, analizojnë paragjykime, stereotipe, të dhëna dhe informacione në mediat masive, të jenë të vetëdijshëm për llojllojshmërinë e mesazheve në media dhe mënyrën e prezantimit të njerëzve, ngjarjeve dhe ideve në raport me prodhuesit e mesazheve, analizojnë strukturën, përmbajtjen dhe qëllimet e medias si dhe efektin e tyre në shoqëri, kulturë, ekonomi, dhe politikë, shfrytëzojnë shkathtësitë e tyre të edukimit mediatik për të qenë kritik ndaj aktiviteteve vetanake në media dhe ndikimin e tyre në shoqëri.
Përmbajtja:	Zhvillon aktivitete të mësimdhënies, që përfshijnë strategji të diferencuara për t'i angazhuar të gjithë nxënësit si dhe për t'i përmbushur nevojat e veçanta të nxënësve me aftësi të ndryshme (<i>Fusha 2; Standardi 3;Pika 3.3</i>). -Themelon dhe ruan një rutinë që ka rregull dhe është funksionale për krijimin e një mjedisi, ku koha e nxënësit kalohet duke kryer detyra mësimore; sjelljet sfiduese trajtohen duke përcaktuar pritje të qarta të nxënësit si dhe duke i trajtuar çështjet disiplinore me kujdes,drejt dhe me respekt të plotë (<i>Fusha 2;Standardi 3;Pika 3.4</i>). -Harton, përzgjedh dhe shfrytëzon strategji joformale,formale diagnostike dhe përmbledhëse për vlerësimin e mësimin të nxënësve/për verifikimin e nivelit të arritjes së nxënësve sa i përket njohurive,sjelljeve dhe shkathtësive. Bën plan të thjeshtë për plotësimin e zbraztësirave të arriturat e nxënësve (<i>Fusha 3;Standardi 5;Pika 5.1</i>). -Themelon dhe ruan marrëdhënie të respektueshme

	bashkëpunimi me prindër/kujdestarë sa i përket mësimin të mirëfilltë dhe mirëqenies së nxënësve dhe i ndihmon që të bëhen pjesëmarrës aktiv në arsimimin e fëmijëve (Fusha 4. Standardi 7; Pika 7.2).
	-Identifikon problematika të ndryshme në klasë, të cilat mund të jenë fokus i hulumtimeve në veprim. (Fusha 4;Standardi 7; Pika 7.4).
Metodat e realizimit të programit	Programi organizohet në formë të një seminari 4 - ditore
Certifikimi	Certifikatë
Trajnerë	34
Data e aplikimit	20.01.2020

Titulli i Programit	Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social
Titulli i organizatës	Sindikata e Bashkuar e Arsimit,Shkencës dhe Kulturës (SBASHK)
Tipi i programit:	Program trajnues themelorë
Ofertuesi i programit:	SBASHK
Adresa:	Rr. " Agim Ramadani", p.n. - Qendra e Studentëve 10000 Prishtinë
E-mail:	Sbashk2004@yahoo.com , info@sbashk-rks.org
Telefoni:	+ 383(0) 38 226 940
Numrat dhe data e aprovimit:	Nr.39/2020 data 31.01.2020 Programi aprovohet për një vit nga ana e MASHT-it
Kohëzgjatja e programit(orë)	(orë): 32
Përfituesit:	Ky program i dedikohet përfaqësuesve të MASHT, të DKA, drejtorëve të shkollave,udhëheqësve sindikal si dhe mësimeve të niveleve të ndryshme. Po ashtu, programi mund të jetë i dobishëm edhe për studentët e fakulteteve që përgatisin mësimeve të ardhshëm dhe të atyre që ofrojnë kurse lidhur me dialogun social.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	25 - 32
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Me përvetësimin e këtij Programi pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje: Të njohin procesin e ndryshimit dhe zhvillimit të organizatave Të fitojnë shkathtësi relevante për zbatimin e formave të ndryshme të dialogut social: Të praktikojnë dhe të përgatisin një metodologji për të

	udhëhequr një proces të dialogut përmes negocimit, konsultimit etj. Të shkëmbejnë informacione në mes të përfaqësuesve të qeverisë, punëdhënësve dhe punëtorëve, për çështjet me interes të përbashkët, që kanë të bëjnë me politikën ekonomike dhe sociale Të jenë në gjendje të praktikojnë dialogun informal apo të institucionalizuar si dhe të bëjnë kombinimin e të dyjave.
Përmbajtja:	Çfarë është dialogu social – Përkufizimi, Zhvillimi i Dialogut, Sfidat dhe kujdesi në dialog; -Dialogu social Kombëtar – partnerët e dialogut dhe interesat e partnerëve të dialogut; -Ushtrim mbi interesat e punëtorëve, punëdhënësve dhe interesat e përbashkëta; -Dialogu Social-Këshilli i punëtorëve të Evropës – Funksionet; -Dialogu Social dhe puna në Kosovë- Këshilli Ekonomik Social i Kosovës (KES), Funksionet e KES-it në Kosovë, Organet e KES-it; -Dialogu Social Evropian- Përkufizimi, Funksionimi; -Dialogu Social në Kosovë-vizioni dhe misioni, objektivat strategjike dhe specifike -Dialogu Social dhe Puna -Ushtrim në grup lidhur me kycjen e sindikatave dhe punëtorëve në Këshillin Evropian të punëtorëve dhe sfidat, që hasin - Konflikti dhe zgjidhja e tij- Përkufizimi, Strategjitë për zgjidhjen e konfliktit; -Ushtrim praktik në grupe nga 6 persona për zgjidhje të një konflikti dypalësh (Vlerësim).
Metodat e realizimit të programit	Programi organizohet në formë të një seminari 4 - ditorë
Certifikimi	Certifikatë
Trajnerë	39
Data	20.01.2020

Titulli i Programit	Mësimdhënia e gjuhës dhe letërsisë shqipe për ciklin fillor dhe të mesëm
Titulli i organizatës	Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK)
Tipi i programit:	Program trajnues themelorë
Ofertuesi i programit:	SBASHK
Adresa:	Rr. "Agim Ramadani", p.n. - Qendra e Studentëve 10000 Prishtinë
E-mail:	Sbashk2004@yahoo.com , info@sbashk-rks.org
Telefoni:	+ 383(0) 38 226 940
Numrat dhe data e aprovimit:	Nr.38/2020 data 31.01.2020 Programi aprovohet për një vit nga ana e MASHT-it
Kohëzgjatja e programit(orë)	(orë): 32
Përfituesit:	Programi i trajnimit u dedikohet mësimdhënësve të gjuhës dhe letërsisë shqipe të të gjitha niveleve të shkollimit parauniversitar. Arsyeja e përzgjedhjes është aftësimi me qëllim të përshtatjes së metodave të mësimdhënies për t'iu përshtatur ndryshimeve të fundit në kurrikula.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	25 – 32
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Pjesëmarrësit e trajnimit do të jenë në gjendje: Të zbatojnë praktikën e mirë të mësimdhënies në pajtim me kurrikulën e re. Të dinë ta përmbushin planprogramin e ri, sipas teksteve të reja, që duhet të hartohen në pajtim me kurrikulën e re. Të përgatisin dhe zbatojnë metodat për përmbushjen e kurrikulës së re në pajtim me nivelet e nxënies. Të zbatojnë teknika për organizimin e orës së mësimi në pajtim me pritshmëritë e parashikuara në kurrikulën e re për lëndën e gjuhës dhe letërsisë shqipe. Të organizojnë mbajtjen e mësimi duke aplikuar terminologji të standardizuar të mbajtjes së mësimi. Të aplikojnë teknologjitë e reja (telefonat, tabletet, lap-topin dhe internetin) me rastin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit.
Përmbajtja:	Zhvillon aktivitete të mësimdhënies, që përfshijnë strategji të diferencuara për t'i angazhuar të gjithë nxënësit si dhe për t'i përmbushur nevojat e veçanta të nxënësve me aftësi të ndryshme. - Themelon dhe ruan një rutinë, që ka rregull dhe është funksionale për krijimin e një mjedisi, ku koha e nxënësit kalohet duke kryer detyra mësimore; sjelljet sfiduese

	trajtohen duke përcaktuar pritje të qarta të nxënësit si dhe duke i trajtuar çështjet disiplinore me kujdes, drejt dhe me respekt të plotë. - Harton, përzgjedh dhe shfrytëzon strategji joformale, formale, diagnostike dhe përmbledhëse për vlerësimin e mësimit të nxënësve/ për verifikimin e nivelit të arritjes së nxënësve sa i përket njohurive, sjelljeve dhe shkathtësive. Bën plan të thjeshtë për plotësimin e zbrastësirave të arriturat e nxënësve. -Themelon dhe ruan marrëdhënie të respektueshme bashkëpunimi me prindër/ kujdestarë sa i përket mësimit të mirëfilltë dhe mirëqenies së nxënësve dhe u ndihmon, që të bëhen pjesëmarrës aktivë në arsimimin e fëmijëve; - Nxit nxënësit që të menaxhojnë kohën e paraparë për mësim në proporcion me nevojat, në mënyrë që mësimi të përjetohet edhe si kënaqësi dhe jo vetëm si obligim. - Identifikon problematika të ndryshme në klasë, të cilat mund të jenë fokus i hulumtimeve në veprim.
Metodat e realizimit të programit	Programi organizohet në formë të një seminari 4 - ditorë
Certifikimi	Certifikatë
Trajner	21
Data	20.01.2020

Titulli i Programit	Planifikimi dhe Udhëheqja Strategjike në Arsimin Parauniversitar
Titulli i organizatës	Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK)
Tipi i programit:	Program trajnues themelorë
Ofertuesi i programit:	SBASHK
Adresa:	Rr. "Agim Ramadani", p.n. - Qendra e Studentëve 10000 Prishtinë
E-mail:	Sbashk2004@yahoo.com , info@sbashk-rks.org
Telefoni:	+ 383(0) 38 226 940
Numrat dhe data e aprovimit:	Nr.39/2020 data 31.01.2020 Programi aprovohet për një vit nga ana e MASHT-it
Kohëzgjatja e programit(orë)	(orë): 32
Përfituesit:	Ky program i dedikohet përfaqësuesve të MASHT, të DKA, drejtorëve të shkollave, udhëheqësve sindikal si dhe mësimeve të niveleve të ndryshme. Po ashtu, programi mund të jetë i dobishëm edhe për studentët e fakulteteve që përgatisin mësimeve të ardhshme dhe të atyre që ofrojnë kurse lidhur me udhëheqjen dhe

	planifikimin strategjik.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	25 - 32
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Me përvetësimin e këtij Programi pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje: Të njohin procesin e hartimit dhe zhvillimit të politikave arsimore, në mënyrë që arsimi të shndërrohet në zhvillues të shoqërisë; Të fitojnë shkathtësi relevante për zbatimin e formave të ndryshme të hartimit të politikave udhëheqëse, planifikimit vjetor, mujor, javor, ditor; Të kuptojnë konceptet kyçe strategjike, që dinamizojnë hartimin e politikave zhvillimore arsimore; Të shkëmbejnë informacione në mes të nivelit qendror, rajonal, komunal dhe institucional, për çështjet me interes të përbashkët që kanë të bëjnë me udhëheqjen dhe planifikimin strategjik Të jenë në gjendje të praktikojnë udhëheqjen dhe planifikimin strategjik.
Përmbajtja:	Hyrje-qëllimi i punëtorisë, Profili i udhëheqësve, Bazat e menaxhimit dhe udhëheqjes-Konceptet themelore, Menaxhimi, funksionet, rolet, morali, aftësitë e menaxherit; udhëheqja, nivelet e udhëheqjes; llojet e udhëheqjes, tipet e udhëheqjes sipas shkallës së zhvillimit të institucionit; karakteristikat e udhëheqjes efikase dhe efektive; udhëheqja në funksion të planifikimit strategjik; SWOT analiza lidhur me situatën në organizatë; konceptet themelore të planifikimit strategjik; përcaktimi i prioriteteve për të fuqizuar organizatën.
Metodat e realizimit të programit	Programi organizohet në formë të një seminari 4 - ditorë
Certifikimi	Certifikatë
Trajnerë	39
Data	20.01.2020

Titulli i Programit	Gjithpërfshirja në punën me fëmijët në klasat parafillore dhe parashkollore
Titulli i organizatës	Qendra për Demokratizimin e Shoqërisë Civile “Koralet”
Tipi i programit:	Program Plotësues
Ofertuesi i programit:	<i>Organizata Qendra për Demokratizimin e Shoqërisë Civile “Koralet”, financuar nga UNICEF-I, në kuadër të projektit “Qendrat me bazë në komunitet në vendet Rurale” (Mitrovicë dhe Vushtrri)</i>
Adresa:	Rr.”Ramadan Kelmendi”, Mitrovicë, p.n
E-mail:	Qdshc.mitrovica@gmail.com
Telefoni:	+383 (0) 49 641 499
Numrat dhe data e aprovimit:	56/2020 03.02.2020 (program i aprovuar për një vit)
Kohëzgjatja e programit(orë)	50 orë
Përfituesit:	• Edukatorët/mësimdhënësit • Nxënësit • Familjet e nxënësve • Komuniteti
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	20-25
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	• Rritja e vetëdijes dhe kapaciteteve për edukimin gjithëpërfshirës. • Zhvillimi i shkathtësive për planifikim të punës duke përfshirë fëmijë me nevoja te veçanta. • Identifikimi dhe demonstrimi i strategjive pedagogjike për gjithëpërfshirje. • Zhvillimi i shkathtësive bazike shëndetësore për punë në klasën gjithëpërfshirëse
Përmbajtja:	Ky program trajnimi ofron aftësim për edukatorët duke analizuar edhe tema që ndërlidhen në Kornizën e Kurikut të Kosovës dhe planifikimin e punës, përkatësisht të aktiviteteve cilësore të cilat ndihmojnë në gjithëpërfshirjen e të gjithë fëmijëve pa dallim ombi,gjinie,gjuhe,feje,apo diversiteteve tjera, që ndërlidhen me dëmtimet e natyrës fizike, psikike, emocionale dhe sociale. Ky program trajnimi ka dy komponenta kryesore; 1. Komponentën pedagogjike dhe holistike të gjithëpërfshirjes dhe 2. Komponentën shëndetësore me njohje bazike .

1. Përmes komponentës pedagogjike dhe holistike programi ofrohen njohuri e shkalltësi përkitazi me edukimin gjithëpërfshirës në thelb të vacantë në institucionet parashkollore dhe parafilllore. Në këtë program, trajtohen tema, që kanë të bëjnë me të mësuarit e fëmijëve, në edukimin gjithëpërfshirës, prespektivën mbështetëse dhe kushteve për edukimin gjithëpërfshirës. Më tej, do të trajtohen tema, që kanë të bëjnë me strategjit e përfshirjes në aktivitete të fëmijëve me prapambetje mendore, sindromën Daun, Autizimin , pastaj përfshirjen e fëmijëve me dëmtime në të parë, në të dëgjuar, vështërsi në komunikim.

Komponenta e dytë, që e ndërton këtë program trajnimi është aspekti shëndetësor i klasëve gjithpërfshirëse. Synimi për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në klasa të rregullta krijon nevojën e përgatitjes së edukatoreve me shkathtësit bazike shëndetësore për ndihmën e fëmijëve mbrenda klasës në kërkesat e tyre në aspektin shëndetësor. Gjithashtu edukatorët do të zhvillojnë dhe aftësohen për ndihmë në raste specifike për fëmijët me prapambetje mendore, me Sindromin Duaun, Autizëm .

Metodat e realizimit të programit

- Diskutim hyrës për programin e trajnimit.
- Prezantim me PPT.
- Interaktivitet/ diskutim, pyetje, përgjigje dhe reflektim i përbashkët.
- Punë individuale dhe në grupe.
- Pasqyrim i mendimeve.
- Rishikim i çdo veprimtarie dhe informatat kthyesë për paqartësi.

Certifikimi

Certifikimi behet pas perfundimit të ciklit të trajnimit dhe mentorimit.

Trajner

2

Data e aplikimit

Janar 2020

Titulli i Programit	Puna e kujdestarit të klasës – Kujdestari i mirë
Titulli i organizatës	Qendra Kosovare për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QKBN)/ Kosovo Center for International Cooperation (KCIC)
Tipi i programit:	Bazik (themelor)
Ofertuesi i programit:	Qendra Kosovare për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QKBN)/ Kosovo Center for International Cooperation (KCIC)
Adresa:	Rr. "Rexhep Dajkovci", nr. 48, 60000, Gjilan
E-mail:	ngo.kcic@gmail.com
Telefoni:	+38344177320 apo +38349880447
Numrat dhe data e aprovimit:	30/2020 3 shkurt 2020 Një (1) vit
Kohëzgjatja e programit(orë)	6 dite
Përfituesit:	Mësimdhënësit e nivelit 1-5, 6-9 dhe 10-12
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	25 pjesëmarrës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Përmes këtij programi trajnues synohet të ofrohen informacione të përmbledhura për mësimdhënësit e nivelit 1-12 në Republikën e Kosovës, lidhur me rëndësinë e veçantë dhe efektet pozitive, që ka kryerja e detyrave të kujdestarit të klasës në ngritjen e cilësisë në arsim. Mësimdhënësit do të njihen me rolin e kujdestarit të klasës respektivisht me detyrat dhe obligimet kundruall akterëve në arsim: nxënësve, prindërve, stafit të shkollës dhe dokumentacionit shkollor. Programi i trajnimit është i ndarë në tre module: Moduli 1. Udhëheqja e klasës – zgjatë dy ditë. Moduli 2. Dhuna në shkolla – zgjatë dy ditë. Moduli 3. Menaxhimi i stresit të mësimdhënësit – zgjatë dy ditë. Pra në total, ky program trajnues do të përmbajë gjithsej 6 ditë të plota dhe rrjedhimisht 48 orë trajnimi. Kështu, kandidati, që e përfundon me sukses këtë program trajnues, do të pajiset me certifikatë, e cila përmban specifikat e trajnimit dhe numrin total të orëve të

trajnim, që në këtë rast janë 48 orë trajnimi.

Duke pas parasysh se ky program përbehet nga tri module, më poshtë janë paraqitur rezultatet e pritura sipas moduleve:

Moduli 1.

- Zgjerimi i njohurive lidhur me detyrat dhe obligimet e kujdestarit të klasës ndaj nxënësve;
- Rritja e bashkëpunimit të kujdestarit në komunikime me prindër dhe mënyra e udhëheqjes së takimeve;
- Hartimi i planit të veprimit të kujdestarit me stafin e shkollës për mbarëvajtjen e punës në paralele;
- Identifikimi i sfidave dhe gjetja e zgjidhjeve të përshtatshme për gjithpërfshirje të nxënësve;
- Përpilimi dhe zbatimi i planifikimeve në punët me nxënësit;
- Definimi i formave të përshtatshme dhe strategjive për rritjen e njohurive dhe ngritjen e cilësisë në punën me nxënës;
- Praktikimi i tolerancës, mirëkuptimit, bashkëpunimit dhe harmonizimit të qëndrimeve të nxënësve për punë të përbashkët në interes të paraleles;
- Aplikimi i formave të plotësimit, mirëmbajtjes dhe ruajtjes së dokumentacionit pedagogjik.

Moduli 2.

- Kujdestari i klasës do të jetë në gjendje të planifikojë ditën dhe detyrat, në çdo mbarim të ditës së punës, që raportohet nga ana e nxënësve, duke bashkëpunuar me nxënësit lidhur me problemet aktuale në klasë.
- Përmes kujdestarit të klasës dhe bashkëpunimit të mirë do të raportohen rastet e dukurive negative të nxënësve, të trajtohen nga ana e psikologut të shkollës;
- Kujdestari i klasës do të arrijë të formojë grupin apo mekanizmin koordinues në klasë për luftimin e dukurive negative në klasë dhe shkollë.

Moduli 3.

- Stresi personal nuk do t'i shkaktojë mësimdhënësit ndjenjën e mungesës së kontrollit

dhe aftësisë për të funksionuar në nivel të arsyeshëm. Ata do të jenë në gjendje të menaxhojnë jetën e tyre, nuk do të këtë më pagjumësi të vazhdueshme, kokë-dhembja dhe simptoma të tjera me prejardhje të panjohur, ndryshimet në mënyrat e të ushqyerit, do të zvogëlohet konsumimi i duhanit, etj.

- Mësimdhënësit kujdestarë do të dinë të përmirësojnë balancimin e brendshëm, do të jenë në gjendje të kontrollojnë ngjarjet ndaj ndodhive në punë në mënyrë të balancuar e adekuate dhe aftësitë kyçe në luftimin e stresit,
- Mësimdhënësit kujdestarë do të jenë në gjendje për të ndryshuar stilin e sjelljeve, që është i futur thellë në ndërgjegjen e tyre, dh që shpesh del në sipërfaqe stresi në punë. Përmes trajnimit stresi nuk do të afekton moralin e përgjithshëm të punës, duke rezultuar në problemet personale dhe financiare. Do të zvogëlohet lodhja në punë, do të zvogëlohet ankesa shëndetësore në lidhje me punën.
- Drejtoret e shkollave nuk do të gjenden në pozita vetizoluese. Situata stresuese në përpjekje për të kënaqur nevojat e stafit të vet, vendimet lidhur me të ardhmen e stafit të vet, etj. Do të jetë në gjendje të dijë të menaxhojë shumë kërkesa dhe shumë përgjegjësi. Stresin do ta menaxhojnë me relaksim. Menaxhimi i kohës do të jetë çështja kryesore për të menaxhuar stresin në vendin e punës do të jetë në gjendje të ketë kohë të mjaftueshme gjatë orarit për të bërë gjithë ato punë, që duhet të bëhen përmes organizimit më të mirë të kohës dhe atë përmes implementimit të disa sistemeve të thjeshta.

Përmbajtja:

Programi: Puna e kujdestarit të klasës është kusht për disiplinë të lartë dhe rezultate më të mira në mësim. Kujdestari i mirë, synon të kontribuojë në menaxhimin dhe udhëheqjen efikase të klasës dhe përmirësimin e sjelljeve të nxënësve në procesin edukativ – arsimor. Në këtë kontekst, synohet vetëdijësimi i nxënësve për

reflektim pozitiv, ngritje të cilësisë dhe promovimin e vlerave pozitive në dobi të eliminimit të të gjitha llojeve të dukurive që shpien në sjellje të papranueshme.

Nëpërmjet tri moduleve të përfshira në këtë program, synohet të rritet përgjegjësia dhe afiniteti i nxënësve të të gjitha niveleve për përkushtim në kryerjen e aktiviteteve të përditshme shkollore, në dobi të promovimit të vlerave qytetëruese. Realizimi i këtij programi synon të orientojë kujdestarët e klasave, që nga nivelet fillestare deri te ato më të larta të arsimit parauniversitar, të ngrisin aftësitë, shkathtësitë dhe vlerat e nxënësve për sjellje korrekte dhe përvetësim të vlerave të mirëfillta qytetëruese. Edukimi nga kujdestarët për vlerat shoqërore: respektin, tolerancën, dinjitetin, sjelljet qytetëruese, bashkëpunimin, të menduarit, etj, janë garancë e arritjes së qëllimeve në arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës.

Programi synon të përcaktojë detyrimet ndaj nxënësve e prindërve, të qartësojë rolet dhe procedurat e institucioneve shkollore, të organizoj dhe krijoj një strukturë të komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet grupeve të ndryshme të akterëve të shkollës për rritjen e efikasitetit në edukim dhe arsimim cilësor.

Metodat e realizimit të programit

Metodologjia, që do të përdoret në ofrimin e këtij programi trajnues, ndërlihet me qasjen si vijon:

- **Ligjërata dhe komente të shkurta gjatë diskutimeve** – për të nxitur pjesëmarrësit.
- **Informata kthyesë ose reagimet e pjesëmarrësve** – duke u përgjigjur ose duke ofruar sugjerime apo komente sipas nevojës.
- **DVD-te, video sekuenca** – Pjesë të shkurta dhe të zgjedhura mirë nga DVD ose video mund ti ilustrojnë qeshjet për diskutim të mëtejshme apo prezantime lidhur me studime të rastit për punën e mëtutjeshme të grupit.
- **Loja e roleve në grupe** – iu mundëson pjesëmarrësve që ti praktikojnë aftësi dhe ti përjetojnë aktivitetet, duke ofruar përvoja të mira të situatave jetësore reale dhe ti mësojnë konceptet.

	• Puna grupore, ne çifte, grupe te vogla ose te mëdha – Ilustron çështjen duke iu mundësuar pjesëmarrësve qe ti shërbejnë idetë përvojat dhe pikëpamjet si dhe ta thellojnë kuptimin e tyre të detyrës dhe temës së grupit punues • Seanca plenare – këtu shkëmbehen informatat dhe qëndrimet në një grup të tërë, pjesëmarrësit mund të inkurajohen që të kontribuojnë duke parashtruar komentet, reagime ose pyetje.
Certifikimi	Programi trajnues përmban gjithsej 6 ditë të plota dhe rrjedhimisht 48 orë trajnimi. Kështu, kandidati që e përfundon me sukses këtë program trajnues do të pajiset me certifikatë e cila përmban specifikat e trajnimit dhe numrin total të orëve të trajnimit që në këtë rast janë 48 orë trajnimi. Vlerësimi i pjesëmarrësve bazohet në vijueshmërinë, angazhimin në trajnime si dhe portfolio (dosja) e bazuar në detyrat që iu jepen nga ana e trajnerit.
Trajner	Organizata, përmes Trajnimit të Trajnerëve, ka rekrutuar një numër të konsiderueshëm të trajnerëve të cilët janë sprovuar tanimë me angazhime konkrete në teren. Janë realizuar trajnime me mbi 30 grupe të pjesëmarrësve. Lista e trajnerëve numëron 40 trajnerë, të cilët për nga profesioni janë dy llojesh - punëtorë arsimorë (30) dhe psikologë (10). Trajnerët që janë punëtorë arsimorë, realizojnë dy modulet e para të Programit Trajnues kurse trajnerët psikologë, realizojnë Modulin 3 të Programit Trajnues (Menaxhimi i stresit te punëtorët arsimorë).
Data e aplikimit	Janar 2020

Titulli i Programit		Qasja metodologjike ne mesimdhenien e gjuhes angleze permes hulumtimit ne veprim
Titulli i organizatës	Instituti Pedagogjik i Kosoves	
Tipi i programit:	plotësues	
Ofertuesi i programit:	IPK	
Adresa:	“Musine Kokollar” pn., Prishtine	
E-mail:	luljetashala1@hotmail.com	
Telefoni:		
Numrat dhe data e aprovimit:	Nr.44/2020 datë: 03.02.2020 Një (1) vit	
Kohëzgjatja e programit(orë)	48 orë trajnimi në 6 ditë i shtrirë (tri ditë- follow up -zbatim) =24 orë punë praktike. Një ditë prezantim i punës praktike 8 orë Gjithsej 80 orë të bartura në certifikatë	
Përfituesit:	Mësimdhënësit e gjuhës angleze, dhe mesimdhënesit e gjuheve te tjera te nivelit 1-9.	
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	20-25 pjesemarres	
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	• Ngritja e kapaciteteve te mesimdhënesve per qasjen metodologjike ne mesimdhenie permes hulumtimit ne veprim • Nderlidhja e pjeses teorike me praktiken -eksperimentimi ne klase	
Përmbajtja:	Programi i trajnimit ka një strukturë të ndërlidhur të përmbajtjeve, që fillon me hyrje të programit, ku jepen informacionet për qëllimin, objektivat dhe modulën e programit. Secila temë është në funksion të realizimit të objektivave të programit te trajnimit, dhe ka per qellim permiresimin e praktikave profesionale te mesimdhënes, po ashtu ka te specifikuara edhe aktivitetet, kohën e realizimit, procedurat, metodat, mjetet e punës dhe materialet mbështetëse përkatëse. Realizimi i temave të programit përfshin aspektet teorike mbi bazën e informacionit profesional të integruar në përmbajtje të programit, si dhe aspekte të praktikës dhe punës së pavarur të pjesëmarrësve në funksion të zbatimit praktik të njohurive dhe shkathtësive të fituara. Programi permбан tri module: 1. Qasja metodologjike e mësimdhënies së gjuhës angleze përmes hulumtimit ne veprim; 2. Metoda interaktive në të mësuar të gjuhës angleze në shkollë fillore- Teknika mësimore bazuar në lojë; 3. Inteligjencat e shumefishta & gjuha e huaj në shkollë fillore.	

Metodat e realizimit të programit	Aspekte të pedagogjisë dhe metodologjisë në mësimdhënie-nxënie Mësuesi përmes teknikave, që do përdoren do të jetë i aftë të: • njohë tipet e nxënësve; • aktivizojë të gjithë nxënësit në procesin mësimor; • përshtatë programin dhe të ndërtojë punën në bazë të kapaciteteve që ka në klasë në përputhje me objektivat e arritjes së nxënësve; • bëjë vlerësim të drejtë në përputhje me standardet e arritjes së nxënësve; • njohë psikologjinë e nxënësve; • organizojë punë me grupe; • përdorë metoda, mënyra dhe teknika të larmishme të mësimdhënies; • motivojë nxënësit në klasë e jashtë saj; • zhvillojë aftësitë gjuhësore (të lexuarit, të folurit, të dëgjimit dhe të shkruarit); • zhvillojë aftësitë edukative në klasë e jashtë saj; • zhvillojë ndërveprimin gjatë orës së mësimi; • jetë organizator, ndihmës, orientues dhe shpjegues gjatë gjithë procesit të mësimi të gjuhës angleze; • në qendër të mësimdhënies të jetë nxënësi dhe detyra e tij në ndërveprim me të tjerët.
Certifikimi	(modeli i bashkangjitur aplikimit)
Trajner	6
Data e aplikimit	27.01.2020

Titulli i Programit	Trajtimi i stereotipeve dhe diskriminimit, kultivimi i pranimit dhe gjithëpërfshirjes.
Titulli i organizatës	PLAY International
Tipi i programit:	Themelor
Ofertuesi i programit:	PLAY International
Adresa:	47 "Xhelal Mitrovica", Prishtinë.
E-mail:	Andrew.Piner@play-international.org
Telefoni:	044-946-091
Numrat dhe data e aprovimit:	51/2020 03.02.2020 Një (1) vit
Kohëzgjatja e programit(orë)	28 orë (18 orë Trajnimi ballë për ballë, dhe 10 orë Zbatimi në terren).
Përfituesit:	Mësimdhënësit e shkollave të mesme të ciklit të ulët (nga

	klasa 6 deri 9).
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	20-25 pjesëmarrës.
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	• Mësimdhënësit begatojnë njohuritë e tyre mbi Gjithëpërfshirjen e Komunitetit dhe Dialogun Ndëretnik; • Mësimdhënësit përvetësojnë njohuri dhe aftësi për kryerjen e sesioneve socio-sportive; • Mësimdhënësit zbulojnë, apo begatojnë përdorimin e sportit si një mjet edukativ; • Mësimdhënësit forcojnë kapacitetet e tyre bashkëpunuese midis profesionistëve; • Fëmijët dhe adoleshentët e rinj marrin pjesë në sesionet e rregullta socio-sportive dhe përvetësojnë njohuri rreth të drejtave të njeriut, dialogut ndëretnik dhe shkathësive jetësore.
Përmbajtja:	Trajnimi ballë për ballë: Gjatë trajnimit mësimdhënësit do të sfidohen sa i përket njohurive dhe perceptimeve të tyre mbi diversitetin në Kosovë dhe do të aftësohen në udhëheqjen e sesioneve socio-sportive, përfshirë aftësitë bazike të animacionit të sportit, menaxhimin e grupit, metodologjinë Playdagogy dhe kryesimin e debatit. Trajnimet poashtu do të jenë një mundësi, që mësimdhënësit të krijojnë një rrjet bashkëmoshatarësh të angazhuar për ndryshim social përmes arsimit. Ata do të kenë mundësi të takohen me mësimdhënës të prejardhjeve të shumëllojshme dhe shkollave të ndryshme për të shkëmbyer përvojën e tyre mësimore dhe përdorimin e sportit si një mjet edukativ. Zbatimi i aktiviteteve sportive në terren: Gjatë zbatimit të sesioneve sociale sportive me fëmijët e shkollave të tyre, mësimdhënësit do t'i testojnë dhe përmirësojnë shkathtësitë e tyre në situata reale. Duke marrë pjesë në aktivitetet e Playdagogy zbatuar nga mësimdhënësit, fëmijët dhe të rinjtë do të përmirësojnë njohuritë e tyre rreth temave që ndërlidhen me përfshirjen e komunitetit duke u përqëndruar në paragjykimet, që lidhen me etninë, diskriminimet përkatëse dhe përjashtimin potencial, që prek minoritetet.
Metodat e realizimit të programit:	PLAY International beson, që aktivitetet e bazuara në sport dhe lojëra janë një metodë e fuqishme dhe atraktive e të nxënësve. Të gjitha trajnimet e saj janë të bazuara në metodologji aktive të përqëndruara në pjesëmarrës dhe që favorizojnë të nxënësve midis bashkëmoshatarëve. Një kombinim i metodologjive janë përdorur, në këtë program

	trajnimi : • Prezantimet interaktive (Sllajde në Power Point, pyetje-përgjigje, anketa...); • Vetreflektimi dhe ushtrimet grupore(debate, luajtje rolesh, aktivitete simulimi, lojëratematike...); • Ushtrimet e terrenit; • Zbatimi në terren; • Vetëvlerësimi dhe evaluimi (nga trajnerët kursistët shqyhen të reflektojnë mbi eksperiencën dhe performancën e tyre).
Certifikimi	Certifikata e dhënë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe PLAY International.
Trajner/et:	3
Data e aplikimit	Janar 2020

Titulli i Programit	Edukimi Financiar
Titulli i organizatës	Qendra për Demokratizimin e Shoqërisë Civile “Koralet”
Tipi i programit:	Plotësues
Ofertuesi i programit:	<i>Organizata Qendra për Demokratizimin e Shoqërisë Civile “Koralet”,</i>
Adresa:	Rr.”Ramadan Kelmendi” Mitrovicë, p.n
E-mail:	Qdshc.mitrovica@gmail.com
Telefoni:	+383 (0) 49 641 499
Numrat dhe data e aprovimit:	56/2020 03.02.2020 Një (1) vit
Kohëzgjatja e programit(orë)	50 orë
Përfituesit:	• Edukatorët/mësimdhënësit; • Nxënësit; • Familjet e nxënësve; • Komuniteti.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	20-25
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	• Ngritja e vetëdijësimit e edukatorëve/mësimdhënësve për edukimin financiar; • Promovimi i të kuptuarit të koncepteve bazë financiare; • Familjarizimi me lloje të ndryshme të iniciativave financiare;

- Aplikimi I njohurive teorike në praktikë lidhur me çështjet financiare ;
Të kuptuarit të rolit të mësimeve në edukimin financiar të fëmijëve.

Përmbajtja:

Shkathtësia financiare për fëmijët është një mjet i rëndësishëm për të përmirësuar aftësinë financiare të të rinjve dhe komuniteteve tona. Kjo do të ndihmojë në uljen e ndikimit ekonomik të recesionit afatgjatë, që kapë shumë komunitete në të gjithë vendin. Kur fëmijët janë të rinj, shumë situata ofrojnë mundësi për të formuar sjellje pozitive për trajtimin e parave. Këtu mund të fillojë arsimi financiar për fëmijët.

- Së pari, çdo fëmijë lind në një situatë unike. Statusi socio-ekonomik i familjes bën një ndryshim përsa i përket sfidave me të cilat përballen fëmijët. Ata me SES të ulët ka të ngjarë të takojnë më shumë pasiguri financiare. Ata të SES më të lartë ndoshta do të kenë lëvizshmëri më të lartë. Në çdo rast ekziston shpresa për fëmijët, që të ndërtojnë zakone pozitive financiare.
- Së dyti, sjelljet e zhvilluara në fëmijëri janë treguesit kryesorë të sigurisë së ardhshme financiare të një personi. Sjellja formohet nga prindërit, reklamat, bashkëmoshatarët dhe faktorët mjedisorë (si zona e vendbanimit, urbane përkundrejt rurale, burime të disponueshme, etj.). Zakonet e parave fillojnë të formohen në thelb që nga lindja. Fëmijët thithin informacione si sfungjerët dhe disa nga sjelljet që ata adoptojnë kur janë të rinj mund të zgjasin në moshën madhore.
- Së treti, fëmijët krijojnë lidhje emocionale me para që mund të tregojnë gjendjen e tyre financiare dhe nëse ata janë të gatshëm të punojnë drejt një sigurie më të madhe financiare. Ndjenjat dhe qëndrimet e një personi kanë ndikim të fuqishëm në besimin dhe kompetencën e tyre rreth trajtimit të vendimeve për para.

Më në fund, arsimi financiar për fëmijët mungon shumë në shkollat tona publike. Shumica e fëmijëve kurrë nuk do të marrin ndonjë trajnim zyrtar se si të trajtojnë paratë. Ata mësojnë shumicën e zakoneve të tyre nga prindërit dhe bashkëmoshatarët, shumë prej tyre janë negative.

Për këtë qëllim organizata jonë ka vendosur një bashkëpunim me organizatën ndërkombëtare GIVE foundation, organizatë e dedikuar edukimit financiar, ku fokusi do të jetë tek fëmijët e nivelit parashkollor dhe fillor. Bashkëpunimi në aplikacion ju lutem gjeni memorandumin e bashkëpunimit me z. Arnaud Saint Paul themelues i Give Foundation.

Metodat e realizimit të programit	• Diskutim hyrës për programin e trajnimit; • Prezantim me PPT; • Interaktivitet/ diskutim ,pyetje ,përgjigje dhe reflektim i përbashkët; • Punë individuale dhe në grupe; • Pasqyrim i mendimeve; • Rishikim i çdo veprimtarie dhe informatat kthyesë për paqartësi.
Certifikimi	Certifikimi behet pas perfundimit të ciklit të trajnimit dhe mentorimit.
Trajner	2
Data Janar 2020	

Titulli i Programit	Trajnimi i mësimeve të shkollave të mesme profesionale për punë me të rritur
Titulli i organizatës	Instituti Pedagogjik i Kosovës
Tipi i programit:	Themelor-Bazik
Ofertuesi i programit:	Instituti Pedagogjik i Kosovës
Adresa:	Rr. "Musine Kokollari", 83, Prishtinë
E-mail:	Bashkim.A. Azemirks.gov.net
Telefoni:	044431736- 038213832
Numrat dhe data e aprovimit:	Nr.41/ 2020 03.02.2020 Aprovohet një (1) vit
Kohëzgjatja e programit(orë)	15 ditë/90 orë trajnimi 6 ditë /30orë punë te pavarur
Përfituesit:	Përfituesit e drejtpërdrejtë: Profesoret e shkollave të mesme të arsimit profesional dhe instruktoret. Përfituesit sekondar : Profesoret dhe trajneret e shkollave të mesme private të arsimit profesional që aftësojnë të rriturit.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	20-25

**Rezultatet e pritura
ose objektivat e
programit:**

Të fitojnë dije dhe shkathtësi për të punuar në seanca të ndryshme programesh me vijuesit e rritur.

Të fitojnë dije dhe shkathtësi për të zbatuar në seanca trajnimi parimet e andragogjisë.

Të dizajnojnë programe të të rriturve me të gjithë komponentët e tyre përkatës.

Të fitojnë dije dhe shkathtësi në vlerësimin e të rriturve në programe të ndryshme.

Të fitojnë njohuri për përdorimin e teknologjisë në programe të ndryshme të arsimimit të të rriturve.

Rezultatet kryesore të të nxënësve: Nëpërfundim të trajnimit pjesëmarrësit do të jenë në gjendje:

- Të kuptojnë parimet bazë të andragogjisë.
- Të shpjegojnë karakteristikat kryesore të të nxënësve të rriturit
- Të interpretojnë parimet bazë të të nxënësve ndërveprues të rriturit:
- Të identifikojnë stilet e të nxënësve të rriturit;
- Të praktikojnë të nxënësve nga përvoja;
- Të marrin pjesë në veprimtari trajnimi në vendin e punës;
- Të pajisen me shkathtësi të mësimdhënësve në punën me të rriturit;
- Të kontribuojnë në rritjen e cilësisë së reflektimit të

vijuesve;

- Të zbatojnë detyra hulumtuese;
- Të pajisen me shkathtësi organizative në mësim gjatë të nxëniet ndërveprues;
- Të përdorin modele të ndryshme trajnimi në punën me të rriturit;
- Të zhvillojnë trajnime me të rriturit mbështetur në kompetencat themelore të trajnerëve;
- Të zhvillojnë materiale trajnimi për vijuesit e rritur;
- Të përzgjedhin metoda të suksesshme për punën me të rriturit;
- Të përdorin rezultatet specifike të të nxëniet në planifikimin e mësimet me të rritur.
- Të kuptojnë konceptet themelore të kurrikulës;
- Të përdorin modelet kurrikularë në planifikimin e punës me të rriturit;
- Të zbatojnë në renditjen hierarkike konceptet: objektiva, rezultatet dhe standarde;
- Të pajisen me shkathtësi për projektimi e programeve mbi të nxëniet ndërveprues;
- Të vlerësojnë një program trajnimi në punën me të rriturit;
- Të fitojnë dije për konceptet themelore të matjes dhe kontrollit;
- Të përdorin lloje të ndryshme të vlerësimit, formues dhe përmbledhës;
- Të zbatojnë vlerësime të dy llojeve, objektive dhe subjektive;
- Të përdorin forma të ndryshme të vlerësimit përmes dosjeve;

- Të vlerësojnë nivelin e performancës në programe të ndryshme me të rriturit;
- Të fitojnë njohuri për teorinë dhe praktikat e të nxënit elektronik;
- Të kuptojnë mekanizmat e funksionimit të mësimimit në distancë;
- Të përdorin kompjuterat në programet e të rriturve
- Të zbatojnë konceptet e edukimit mediatik në botën digjitale;
- Të përdorin të nxënë të elektronik si mjet për motivimin e vijuesve në program.

Përmbajtja:

Përmbajtja e programit përfshin tematikat si:

Shkathtësitë që duhet t'i ketë një mësimsdhënës;

Metoda të përshtatshme për punën me të rriturit;

Modele të trajnimit në programet e arsimimit të të rriturve

Parimet e andragogjisë;

Si mësojnë të rriturit;

Origjina e teorive të të nxënit te të rriturit,

Të nxënë të aktiv dhe ndërveprues midis të rriturve.

Stilet e të nxënit te të rriturit, ,

Identifikimi i stileve të të nxënit,

Metodat e trajnimit për stilet e të nxënit,

Trajnimit në vendin e punës,

Kurrikula dhe modelet e planifikimit të punës me të rriturit,

Përdorimi i modeleve të kurrikulës si instrumente

planifikimi, Zbatimi i kurrikulës,

	Objektivat, rezultatet dhe standardet e të nxënit, Llojet e objektivave, Të nxënë të veprues përgjatë kurrikulës, Përmbajtja lëndore dhe planifikimi i saj në njësi, Përmbajtja lëndore dhe planifikimi i saj në njësi, Vlerësimi i plan-programit, Matja dhe vlerësimi, Aspekte të ndryshme të vlerësimit, Vlerësimi në shprehje të nxënit, Teoria e të nxënit elektronik (eLearning), Edukimi mediatik/digjital, Mësimdhënia në internet.
Metodat e realizimit të programit	Trajnerët e programit të trajnimit planifikojnë metoda dhe teknika të punës, që përdoren në arsimimin e të rriturve, në mënyrë që të sigurohet një azhurnim i aftësive dhe shkathtësive të mësimdhënësve për ngritje profesionale përmes shpjegimit të : • Karakteristikat kryesore të të nxënit të të rriturit dhe të cilësisë së reflektimit të vijuesve; • Duke zbatuar detyra hulumtuese me modele të ndryshme për vijuesit e rritur; • Duke përzgjedhur metoda të suksesshme për punën me të rriturit si dhe lloje të ndryshme të vlerësimit formues e përmbledhës dhe përmes dosjeve si dhe praktikave të vlerësimit elektronik. Detyrat praktike: -Pas trajnimit secili nga mësimdhënësit duhet të përgadis një dosje me detyrat pas çdo moduli.
Certifikimi	Kriteret për certifikim të pjesëmarrësve: -Pjesëmarrja në trajnim së paku në 14 ditë nga 15 ditë sa ka

	programi; Prezantimi i dosjes me detyra ; Certifikata per perfundim te trajnimit me 120 ore trajnimi.
Trajner	3
Data	27.01.2020

Titulli i Programit	Aktivat Profesionale – Roli dhe funksioni i tyre në shkollat e Kosovës
Titulli i organizatës -	Deutsche Gesellschaft für Internationale GmbH - GIZ
Tipi i programit:-	Plotësues
Ofertuesi i programit:	Deutsche Gesellschaft für Internationale GmbH - GIZ
Adresa:	Rr. “Anton Çetta” 1, 10000 Prishtinë.
E-mail:	boris.scharlowski@giz.de
Telefoni:	+383 38 233 002
Numrat dhe data e aprovimit:	03.02.2020 – 35/2020 Aprovohet një (1) vit
Kohëzgjatja e programit(orë) -	42 orë - Trajnim dhe prezantim i detyrave të shtëpisë (kontakt i drejtpërdrejtë) - 24 orë. - Detyrat e shtëpisë - 18 orë.
Përfituesit:	Kryesuesit e aktivave profesionale.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	25
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Rezultatet e pritura ose objektivat e programit Aktivat Profesionale: Në përfundim të programit të trajnimit për Aktivet Profesionale, pjesëmarrësit do të jenë të aftë të: ▪ interpretojnë dhe të zbatojnë udhëzimin administrativ 22/2016 Aktivet/Departamentet Profesionale në shkollë;

- organizojnë aktivet profesionale në nivel shkolle;
 - planifikojnë punën e aktiveve profesionale në nivel shkolle;
 - integrojnë në planet e punës së aktiveve profesionale detyrat dhe përgjegjësitë e aktiveve profesionale;
 - marrin pjesë në mënyrë aktive në aktivat profesionale në shkollë;
 - mbështesin punën e aktiveve profesionale në parimet e kurrikulës;
 - udhëheqin procesin e planifikimit mësimor në kuadër të aktiveve profesionale;
 - hartojnë instrumente të vlerësimit të nxënësve sipas kërkesave të kurrikulës së re;
 - planifikojnë zhvillimin profesional të mësimeve të bazuar në nevojat e mësimeve;
 - organizojnë shkëmbimin e përvojave të mësimeve, mentorim kolegjial, në kuadër të aktiveve profesionale dhe në nivel shkolle;
 - bëjnë përzgjedhjen dhe krijimin e materialit didaktik të nevojshëm për punën e aktiveve profesionale;
 - demonstrojnë shkathtësitë e udhëheqjes së aktiveve profesionale;
- përgatisin dokumentacionin për punën e aktiveve profesionale.

Përmbajtja:

Përmbajtja e programit të trajnimit përfshinë tema në vijim:

1. **Roli, detyrat dhe përgjegjësitë e Aktiveve profesionale** - sipas kuadrit ligjor për Aktivat/Departamentet

Profesionale në Shkollë.

2. **Kurrikula e re dhe roli i Aktiveve Profesionale** – Kurrikula e re dhe reflektimi në punën e Aktiveve Profesionale dhe reflektimi i parimeve të kurrikulës në punën e AP-ve.
3. **Roli i Aktiveve Profesionale në planifikimin e punës së shkollës dhe në sigurimin e cilësisë** – Detyrat dhe përgjegjësitë e AP - të përcaktuara në kornizën ligjore dhe në dokumente të tjera strategjike; Organizimi i AP-ve në nivele të arsimit dhe fusha kurrikulare – specifikat e shkollave; Kriteret e përcaktuara për kryesuesin e AP; Procedurat për emërimin e kryesuesit të AP; Pritshmëritë për Koordinatorin e Cilësisë në shkollë dhe AP në zbatimin e metodologjive kryesore, të cilat promovojnë mësimdhënie cilësore dhe arritje të rezultateve; [Plani i punës së AP, lidhja me PZSHH, planin vjetor dhe përfshirja e AP në procesin e sigurimit të cilësisë në nivel shkolle.](#)
4. **Roli i Aktiveve Profesionale në vlerësimin e nxënësve dhe zhvillimin profesional me bazë në shkollë** – hartimi i instrumenteve për vlerësimin e nxënësve në VP1 dhe VP2, Analiza e rezultateve të vlerësimit, shfrytëzimi i të dhënave të vlerësimit për përmirësim të suksesit dhe rritje të rezultateve të të nxënit. Zhvillimi profesional me bazë në shkollë (format e zhvillimit profesional me bazë në shkollë, si

planifikohet, si përkrahen mësimdhënësit, si ndahen përvojat, etj.);

- 5. Roli i aktivitetit profesional në përzgjedhjen dhe krijimin e materialit didaktik dhe bashkëpunimi i Aktiveve Profesionale** - detyrat e tyre në përzgjedhjen dhe krijimin e materialeve dhe mjeteve mësimore; Bashkëpunimi i Aktiveve Profesionale (qëllimi dhe format e bashkëpunimit, fushat e bashkëpunimit, rëndësia e bashkëpunimit të AP-ve në nivel shkolle, komune, me komunitetet e të mësuarit së bashku etj.); Roli i AP-ve në planifikimin dhe udhëheqjen e takimeve.

Metodat e realizimit të programit

Programi organizohet në formë të 2 moduleve 2-ditore, të cilat zhvillohen gjatë një periudhe 1 mujore. Koha në mes të mbajtjes së moduleve duhet të jetë së paku dy javë. Një pjesë e trajnimit (1 dite) do të fokusohet në shkëmbimin e praktikave në implementimin e njohurive të marra nga trajnimi.

Metodologjia e trajnimit mbështetet në metodologjitë, parimet dhe kërkesat tjera të kurrikulës së re, duke pasur parasysh përfshirjen aktive të pjesëmarrësve, qasjen e integruar, bashkëpunimin, iniciativën dhe rezultatet e të nxënësve me fokus kompetencat.

Seancat e trajnimit janë kombinuar me prezantime, shpjegime të ilustruara me shembuj praktik, punë në grupe, ndërveprim, demonstrim, aktivitete dhe lojëra atraktive, duke realizuar edhe detyra konkrete nga pjesëmarrësit e trajnimit.

Trajnerët e programit të trajnimit: *Aktivet*

	<i>Profesionale në shkollat e Kosovës - roli dhe funksioni i tyre, janë trajnuar që të përzgjedhin dhe të përdorin forma dhe metoda interaktive të punës me kolegë mësimdhënës, që nxitin maksimalisht të nxënësit aktiv të pjesëmarrësve dhe të çojnë në zhvillimin e kompetencave të tyre në këtë fushë, në arritjen e rezultateve të programit të trajnimit. Elementi kryesor i metodologjisë së punës së pjesëmarrësve në këtë program të trajnimit, është lidhja e teorisë e kuadrit ligjor me punën praktike të aktiveve profesionale. Pra, trajnerët e programit janë aftësuar që të përdorin forma dhe metoda të trajnimit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike dhe shprehjet praktike të pjesëmarrësve, por edhe qëndrimet e tyre si mësimdhënës pjesë e aktiveve profesionale.</i>
Certifikimi	Certifikimi i pjesëmarrësve do të bëhet duke respektuar kriteret në vijim: Pjesëmarrja në trajnim min. 80% dhe Cilësia e portfolios së pjesëmarrësve mbi 70%..
Trajner	23
Data	Janar 2020

Titulli i Programit	
Edukimi për të drejtat e fëmijëve “Të drejtat tona”	
Titulli i organizatës	Instituti për Promovimin e Edukimit (IPEDU)
Tipi i programit:	Program trajnues themelor dhe program trajnues plotësues
Ofertuesi i programit:	Instituti për Promovimin e Edukimit
Adresa:	Rr. “Janina” 252, Veternik, Prishtinë
E-mail:	fidan_hetemi@hotmail.com
Telefoni:	+383 (0) 44 984 207
Numrat dhe data e aprovimit:	45-2020 03 Shkurt 2020 Aprovohet një (1) vit
Kohëzgjatja e programit(orë)	Trajnimi i trajnerëve është dyditor me 12 orë , të cilët do t’i trajnojnë mësuesit. Në Trajnimin e trajnerëve duhet të jëtë së paku një ekspert internacional. Trajtimi i mësimeve është dyditor me 12 orë punë efektive trajnuese. Monitorimi bëhet përmes kontakteve me mësuesit dhe në orë mësimore. Për një mësues nga 1 - 2 orë mësimore .
Përfituesit:	Këshilltarët shkollorë (pedagogë, psikologë dhe drejtorë) Mësimeve Nxënës
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	• 60 trajnerë që do t’i trajnojnë mësuesit; • 800 mësues që do të marrin pjesë në trajnime për të drejtat e fëmijëve; • 32000 fëmijë që do të përfitojnë nga zbatimi i projektit dhe materialet e shpërndara.
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	- Njohja e mësimeve për të drejtat universale të njeriut dhe të drejtat e fëmijëve dhe informimi i nxënësve në shkollë. - Njohja me konventat e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës; - Të mësuarit për të drejtat e njeriut si një qasje në përgatitjen e të rinjve për t'u bërë qytetarë të informuar,aktivë dhe përgjegjës; - Edukimin e të rinjve për qytetari aktive dhe pjesëmarrje aktive në respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të fëmijëve; - Njohja dhe zbatimi me sukses i metodës së albumeve “Të drejtat tona” me nxënës.
Përmbajtja:	Qasja përmbajtësore e këtij programi është edukimi i fëmijëve për të drejtat e tyre dhe përgatitja e fëmijëve për qytetari aktive, përgjegjës për tolerancë dhe bashkëjetesë. Rol të rëndësishëm këtu është edhe zbatimi me sukses i kurrikulës shkollore, duke pasur parasysh përmbajtjen e

	planprogramit të Edukatës qytetare, por duke u bazuar edhe në zhvillimet tjera për arritjen e rezultateve të të nxënësve përmes të shkathësive dhe arritjen e kompetencave. Metoda me albumet “Të drejtat tona” plotëson synimin e arsimit kosovar në edukimin e fëmijëve për të drejtat e tyre.
Metodat e realizimit të programit	Përgatitja e mësimeve, këshilltarëve shkollorë dhe profesionistëve për të drejtat e fëmijëve si trajnerë të ardhshëm për të drejtat e fëmijëve. Trajnimi i mësimeve për edukimin e fëmijëve për të drejtat e tyre dhe për zbatimin e metodës së albumeve “Të drejtat tona”. Monitorimi i zbatimit me nxënës të metodës me albumet “Të drejtat tona”. Vlerësimi i rezultateve të punës me nxënës përmes pyetsorëve.
Certifikimi	Në fund të çdo trajnimi do të certifikohen trajnerët dhe mësimeve
Trajner	Trajnerët e trajnimit të këshilltarëve shkollorë dhe mësimeve janë ekspertë ndërkombëtar dhe vendorë të profilit profesional për të drejtat universale të njeriut.
Data e aplikimit	Janar 2020

Titulli i Programit	Përgatitja e Edukatorëve Parafillor për Përkrahjen dhe Zhvillimin e Potencialit të Fëmijëve përmes Lojës dhe Kreativitetit
Titulli i organizatës	Instituti Pedagogjik i Kosovës dhe Caritasi Zviceran në Kosovë
Tipi i programit:	Themelor
Ofertuesi i programit:	Instituti Pedagogjik i Kosovës dhe Caritasi Zviceran në Kosovë
Adresa:	Rr. “Musine Kokollari”, Prishtine , Kosovë
E-mail:	
Telefoni:	038 213 830 & 038 200 20 169
Numrat dhe data e aprovimit:	Nr. 62/2020 Data: 22.05.2020 Aprovohet një (1) vit
Kohëzgjatja e programit(orë)	58 orë certifikimi
Përfutuesit:	Grupi i synuar janë edukatorët që punojnë me fëmijët parafillor,

	grup mosha 5-6 vjeç.											
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	20 – 25 pjesëmarrës në grup											
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Trajnimi ka për qëllim zhvillimin e kapaciteteve të edukatorëve për punë cilësore dhe kreative me fëmijë parafillor, bazuar në teori dhe praktika të avancuara për zhvillimin e potencialit të fëmijëve parafillor përmes lojës dhe kreativitetit. Rezultatet që pritën nga programi i trajnimit. Në përfundim të programit të trajnimit edukatorët pjesëmarrës në trajnim do të jenë në gjendje të: ▪ shpjegojnë konstruktin shumëdimensional të lojës për zhvillimin e potencialit të fëmijëve; ▪ zhvillojnë plane mësimore që përfshijnë lojërat për t'i ndihmuar fëmijët që të jenë të suksesshëm në rutina; ▪ praktikojnë mësimin përmes lojës, kreativitetit dhe didaktikës; ▪ identifikojnë komponentët e mjedisit mësimor që i ndihmon fëmijët të ndihen të sigurt, të rehatshëm, të mirëpritur dhe të gatshëm për të mësuar dhe eksploruar; ▪ demonstrojnë strategji të ndryshme për krijimin e një mjedisi pozitiv; ▪ përgatitin dhe përdorin materiale dhe mjetet didaktike kreative dhe praktike në punën me fëmijë parafillor; ▪ përdorin instrumente të ndryshme konceptuale për ta menaxhuar grupin e fëmijëve me të cilët punojnë; ▪ përdorin takimet në grup me të gjithë fëmijët si mundësi thelbësore për t'i zgjidhur konfliktet ose vështirësitë brenda grupit; ▪ krijojnë instrumente vëzhgimi për vlerësim për të nxënë/vlerësim formativ; ▪ përdorin rezultatet e vëzhgimeve në funksion të rezultateve të nxënies dhe përzgjedhjes së aktiviteteve për zhvillimin e potencialit të fëmijëve; etj.											
Përmbajtja:	Përmbajtja e programit të trajnimit përfshin 4 module dhe tema në vijim: <table><tr><th>Programi i trajnimit</th><th>Temat kryesore</th><th>Kohëzgjatja</th></tr><tr><td>Moduli 1</td><td>Mësimi përmes lojës, kreativitetit dhe didaktikës.</td><td>12 orë</td></tr><tr><td>Moduli 2</td><td>Mjedisi mësimor, materialet dhe</td><td>12 orë</td></tr></table>			Programi i trajnimit	Temat kryesore	Kohëzgjatja	Moduli 1	Mësimi përmes lojës, kreativitetit dhe didaktikës.	12 orë	Moduli 2	Mjedisi mësimor, materialet dhe	12 orë
Programi i trajnimit	Temat kryesore	Kohëzgjatja										
Moduli 1	Mësimi përmes lojës, kreativitetit dhe didaktikës.	12 orë										
Moduli 2	Mjedisi mësimor, materialet dhe	12 orë										

	mjetet didaktike	
Moduli 3	Menaxhimi i kohës, menaxhimi i grupit, marrëdhëniet	12 orë
Moduli 4	Vëzhgimi dhe vlerësimi për të nxënë	12 orë
	Monitorim dhe mentorim	2 orë
	Përgatitja e Portfolios	8 orë
	Gjithsej	58 orë
Metodat e realizimit të programit	Metodologjia që do të përdoret në ofrimin e programit trajnues: Metodologjia e trajnimit mbështetet në metodologjitë, parimet dhe kërkesat, që lidhen me sigurimin e cilësisë së shërbimeve profesionale për punë me fëmijët parafillor, duke pasur parasysh përfshirjen aktive të edukatorëve që punojnë me fëmijë. Sesionet e trajnimit për secilin modul, janë kombinuar me prezantime, shpjegime të ilustruara me shembuj praktik, lojë me role, mësim përmes lojës, punë në grupe, ndërveprim, video prezantimeve, demonstrim dhe aktivitete atraktive, duke realizuar edhe detyra konkrete në kuadër të programit të trajnimit. Elementi kryesor i metodologjisë së punës së edukatorëve parafillor në këtë program të trajnimit, është lidhja e teorisë me praktikën edukative, me fokus të veçantë në aktivitete praktike. Trajnerët e programit janë përgatitur që të përdorin forma dhe metoda të trajnimit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë e vijuesve, por edhe shkathtësitë praktike dhe qëndrimet e tyre për proceset që lidhen me zhvillimin e potencialit të fëmijëve parafillor përmes lojës dhe kreativitetit. Pjesë e metodologjisë për ofrimin e programit të trajnimit, janë: aktivitetet praktike, prezantime në PowerPoint për secilin modul, ligjërata, punë në grupe, prezantime, video prezantime, diskutime, reflektim, detyra praktike për përgatitje dhe realizim në vendin e punës.	
Certifikimi	Modeli i bashkangjitur në aplikim	
Trajner	10	
Data e aplikimit	Maj 2020	

Titulli i Programit	Metodologjitë e Reja në Mësimdhënie
Titulli i organizatës:	Instituti për Kërkim, Edukim dhe Zhvillim Social (IREDS)
Tipi i programit:	Themelor
Ofertuesi i programit:	IREDS
Adresa:	Rr. "Rexhep Krasniqi", p.n. 10000 Prishtine
E-mail:	ireds.ks@gmail.com / www.ireds-ks.org
Telefoni:	+383 (0) 44661517
Numrat dhe data e aprovimit:	Nr. 43/2020 Datat: 03.02.2020 Aprovohet një (1) vit
Kohëzgjatja e programit(orë)	80 orë
Përfituesit:	Mësimdhënësit e arsimit parauniversitar
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	25
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	— Njohja e metodave të ndryshme të arsimit dhe ato didaktike; — Përshkrimi, adaptimi dhe zbatimi i metodave si dhe kompetencat për përpunimin dhe planifikimin e premisave të mësimdhënies; — Analizimi itemave mësimore, formulimi i objektivave mësimore në raport me taksonominë dhe shumëllojshmërinë e mjeteve konkretizuese; — Njohja e metodave të ndryshme për vlerësim të performances akademike të nxënësve; — Zhvillimi i mënyrave të vlerësimit dhe ekzaminimit të njohurive, shkathtësive dhe kompetencave në raport me rezultatet e të nxënit; — Njohja bazës së kurrikulit, planifikimit të kurrikulës, zhvillimi i planeve mësimore, dhe aplikimi i parimeve bazë gjatë përpilimit të kurrikulave dhe syllabuseve të programeve dhe lëndëve mësimore.
Përmbajtja:	Modulet: 1. Kurrikula bazë dhe zhvillimi i plan-programeve mësimore; 2. Metodologjitë bashkohore të mësimdhënies: Mësimdhënia e bazuar në Projekte, Mësimdhënia e bazuar në Hulumtime, dhe Mësimdhënia e bazuar në Probleme; 3. Metodat e testimit dhe vlerësimit (vlerësimi formativ dhe sumativ dhe parametrat matëse të vlerësimit);
Metodat e realizimit të programit	— Ligjerata interaktive / të mësuar reflektiv — Punë individuale / grupore;

	— Prezentime; — Raste studimi; — Analizë sistemore; — Shembuj ilustrativ nga praktikat në shkolla; — Praktikum të instrumenteve vlerësuese.
Certifikimi	Certifikatë
Trajner	http://ireds-ks.org/2020/05/27/trajnim-per-mesimdhenes-metodologji-te-reja-ne-mesimdhenie-dhe-vleresim/
Data e aplikimit	Janar 2020

Titulli i Programit	Kujdestari i klases dhe disiplinat
Titulli i organizatës	Qendra për Edukim, Trajnime dhe Hulumtime "KONICA"
Tipi i programit:	Plotësues
Ofertuesi i programit:	Qendra për Edukim, Trajnime dhe Hulumtime "KONICA"
Adresa:	rr. "Muharrem Fejza", Mati 1, p.n. Prishtinë
E-mail:	qeht.konica@gmail.com
Telefoni:	+383 49 328 528
Numrat dhe data e aprovimit:	Nr. 31/2020, dt. 03.02.2020 Nr. 34/2020, dt. 03.02.2020 Aprovohet një (1) vit
Kohëzgjatja e programit(orë)	16 orë
Përfituesit:	Mësimdhënësit e të gjitha lëndëve mësimore (niveli i klasave 1-12)
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	30
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Çdo mësimdhënës, i cili e përfundon me sukses këtë trajnim, duhet të jetë në gjendje t'i kryejë këto aktivitete/detyra: ○ Të jetë në gjendje të ndërtojë besimin, ndjenjat e respektit të ndërsjellë dhe marrëdhënieve midis nxënësve; ○ Të aplikojë me sukses fazat e formimit të grupit; ○ Të drejtojë alternimet midisi të gjitha veprimtarive, duke e çuar mësimin drejt një përfundimi të suksesshëm; ○ Të motivojë nxënësit në qëndrimin e tyre aktiv ndaj të nxënit; ○ Të zhvillojë rregullat në përputhjes me kushtet e klasës dhe arsyetimin e nxënësve;

	○ Të njohë kushtet thelbësore në zhvillimin e mësimit për mendimin kritik; ○ T'i motivojë nxënësit në krijimin pozitiv të klasës; ○ Të sigurojë disiplinën në klasë që çon drejt të nxënësve të efektshëm; ○ Të trajtojë dhe të kontrolloj sjelljet e padëshirueshme të nxënësve; ○ Të fitojë autoritetin e mësimeve
Përmbajtja: <i>Përmbajtja e programit:</i>	○ Menaxhimi i klasës dhe disiplina; ○ Grupi dhe fazat e formimit të tij; ○ Ekologjia e klasave; - Karakteristikat e klasave ○ Fillimi dhe përfundimi i mësimit. Alternimi i veprimtarive në të - Fillimi me përpikëri; - Mobilizimi mendor; - Kalimet e qeta; - Përfundimi i mësimit; - Klima e klasës. ○ Disiplina dhe rregulli në klasë ○ Shqyrtimi i shkaqeve dhe këshillimi - Këshillimi i suksesshëm ; - Përdorimi me sukses i qortimit; - Natyra dhe qëllimi i ndëshkimit; - Të metat e ndëshkimit; Llojet e ndëshkimit.
Metodat e realizimit të programit	Programi realizohet përmes trajnimit, që zhvillohet në klasë. Metodologjia e përdorur është e bazuar në ligjërime dhe punë praktike gjatë gjithë trajnimit. Trajnimi zgjatë 2 ditë dhe në këtë trajnim shpjegohen përmes shembujve praktikë të gjitha pjesët e programit. Praktikat e trajnimeve tona bazohen në: ○ Shembuj praktik përmes detyrave gjatë trajnimit; ○ Mësimdhënësi në qendër; ○ Aftësitë e trajnerit; ○ Disponueshmëri e kandidatëve dhe ○ Kombinim i materialeve tekst dhe video.
Certifikimi:	Kandidatet certifikohen për dy ditë të trajnimit (16 orë trajnimi) dhe u jepet certifikata sipas formës së bashkëngjitur në aplikacion.
Trajner:	2
Data: e aplikimit	Janar 2020

Titulli i programit	Identifikimi, parandalimi dhe trajtimi i llojeve të dhunës në shkollë
Titulli i organizatës	Organizatë joqeveritare “Syri i Vizionit”
Tipi i programit:	Plotësues
Ofertuesi i programit:	Syri i Vizionit
Adresa:	Rruga “Isa Demaj” Nr. 14, 30000 Pejë, Kosovë
E-mail:	info@syriivizionit.org
Telefoni:	039 423 240/ 044 111 408
Numrat dhe data e aprovimit:	Nr. 48/2020 dhe 49/2020 Datë: 03.02.2020 Aprovohet një (1) vit
Kohëzgjatja e programit(orë)	Një vit: Trajnimi për mësimdhënës do të jenë njëditorë, respektivisht numri i orëve të programit trajnues do të jetë shtatë (7) orë (09:00 -16:00).
Përfituesit:	Mësimdhënësit e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	30 pjesëmarrës (tani në situatën aktuale të pandemisë COVID-19 dhe duke u mbështetur në rregullat e reja nga IKSHP-ja 15 pjesëmarrës)
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	- Në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta të përfshira në trajnime ka rënë numri i dhunës ndaj nxënësve; - Mësimdhënësit në shkollat e përfshira në trajnime kanë njohuri për identifikim, parandalim, trajtim apo referim të dhunës ndaj nxënësve; - Rritet siguria në shkollë dhe është krijuar një mjedis miqësor për nxënësit; - Mësimdhënësit janë në gjendje të: • Ofrojnë një përkufizim për dhunën; • Tregojnë së paku katër shembuj të llojeve të dhunës në shkollë; • Radhisin shkaktarët potencialë të dhunës në shkollë; • Shpjegojnë pasojat e llojeve të dhunës tek nxënësit; • Ofrojnë të paktën nga dy strategji për parandalim, identifikim, trajtim apo referim të

	rasteve të dhunës.
Përmbajtja:	Ky modul/program do t'u shërbej mësimeve të përpunuara të kuptuarin e tyre në identifikimin dhe intervenimin e hershëm mbi dhunën në shkollë dhe synon t'i ngritë njohuritë dhe aftësitë e mësimeve të krijuar, mirëmbajtjen dhe sigurimin e një mjedisi shkolle pa dhunë, të sigurt dhe miqësor për nxënësit. Në këtë program trajnues përfshihen çështjet kyçe: ○ Çfarë është dhuna? ○ Disa përkufizime të saj. ○ Dhuna në shkollë – specifikat. ○ Cilat janë llojet e dhunës? ○ Çfarë e shkakton dhunën në shkollë – faktorët. ○ Kërkohet dhuna në shkollë? ○ Cilat janë pasojat e dhunës në shkollë? ○ Si mund ta parandalojmë dhunën në klasë/shkollë? ○ Sa ka rëndësi marrja parasysh e pikëpamjeve të fëmijëve për të identifikuar format e parandalimit të dhunës mbështetur në Konventën e të Drejtave të Fëmijëve?
Metodat e realizimit të programit	Metodologjia e përdorur është e përzier: - Përmblan ofrimin e informacioneve të qarta dhe të sakta rreth përmbajtjes së koncepteve kyçe të temës qendrore të udhëzuesit në formë të fletushkave informative [one-page handouts]; - Ofron video prezantuese të rasteve specifike të dhunës në shkollë; - Ofron lojë në role për t'i vendosur mësimeve në 'lëkurën' e individit që ushtron ose përjeton dhunë; - Ofron strategji të cilat mësimeve do t'i 'lidhin' me rastet e veçanta në trajnim; - Përmblan diskutime të lehtësuara me qëllimin kryesor të kuptuarit e përbashkët, ndarjen e rasteve por njëkohësisht edhe të ideve për identifikim apo trajnim të rasteve të veçanta të ofruara; - Përmblan dy forma të vlerësimit të punëtorisë, me qëllim të sigurimit të informacionit për planifikimin dhe organizimin dhe njëkohësisht për efektivitetin e përmbajtjes së trajnimit.
Certifikimi	Të gjithë pjesëmarrësit do të certifikohen. Certifikata është e aprovuar së bashku me modulin e programit.
Trajnues	2
Data e aplikimit	Janar 2020

Titulli i Programit		Vlerësimi përmblledhës dhe hartimi i testeve për klasat 1-9
Titulli i organizatës -	Deutsche Gesellschaft für Internationale GmbH - GIZ	
Tipi i programit	Themelor	
Ofertuesi i programit:	Deutsche Gesellschaft für Internationale GmbH - GIZ	
Adresa:	Rr. "Anton Çetta" 1, 10000 Prishtinë	
E-mail:	boris.scharlowski@giz.de	
Telefoni:	+383 38 233 002	
Numrat dhe data e aprovimit:	35/2020, 03.02.202 Aprovohet një (1) vit	
Kohëzgjatja e programit(orë) -	30 orë	
Përfituesit:	mësimdhënësit e klasave 1-9	
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	25	
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Qëllimi i përgjithshëm i trajnimit është që të ofrojë efikasitet dhe efektshmëri në udhëheqje dhe menaxhimin shkollave në mënyrë që të përmirësohet cilësia e arsimit në përgjithësi.
Përmbajtja:	Trajnimi përbëhet nga 7 (shtatë) module dhe të gjitha modulet ndjekin të njëjtën strukturë: hyrjen, qëllimin e modulit si dhe përfundimin e pritur të modulit si pjesë e parë, i cili ndiqet nga teksti kryesor ku prezantohen dhe shpjegohen konceptet, qasjet dhe instrumentet, duke përfshirë detyrat praktike për pjesëmarrësit. Pjesa përfundimtare e secilit modul përfshinë referencat,

fjalorthin si dhe shtojcat.

Moduli 1: E Drejta për arsim- arsimi cilësor:

Ky modul prezanton konceptin e cilësisë së arsimit në kontekstin ndërkombëtar dhe kombëtar; nënvizon marrëdhënien në mes të cilësisë së arsimit dhe rritjes ekonomike. Moduli i Parë trajton komponentët vijuese të Standardeve; Udhëheqja dhe Motivimi, Cilësia e Mësimdhënies dhe Mësimnxënies; Legjislacioni dhe Shoqëria; Etika Profesionale.

Moduli 2: Shkolla e mirë – mësimdhënia dhe mësimnxënia: Shpjegohen fushat cilësore për zhvillimin e shkollave sipas PSAK (2017-2021), duke u fokusuar në kulturën e të mësuarit, kulturën e shkollës dhe nevojën për një strategji dhe vizion të zhvillimit të cilësisë në aspektin afatmesëm dhe afatgjatë bazuar në dokumentet e hartuara në periudhën 2012 - 2017.

Moduli 3: Gjithëpërfshirja në arsim: Ky modul synon të zhvillojë praktika gjithëpërfshirëse në shkolla në mënyrë që të mbështesë përfshirjen e gamës së ndryshme të preferencave dhe nevojave të mësimin që gjenden në klasat e sotme. Ai gjithashtu synon t'i ekspozojë pjesëmarrësit me të dhëna dhe situata të ndryshme duke diskutuar aspektet e përfshirjes së arsimit në Kosovë.

Moduli 4: Plan i zhvillimit të shkollës dhe menaxhimi i projektit:

Ky modul ofron një qasje të strukturuar për të shtjelluar planin për zhvillim të shkollave. Format i udhëzuesi i PZHSH i rishikuar në bazë të vlerësimeve dhe sugjerimeve të përdoruesve. PZHSH është kombinuar me modulin e Menaxhimit të projektit që paraqet një lidhje logjike në mes tyre.

Moduli 5: Komunikimi dhe Bashkëpunimi:

Komunikimi në një shkollë përshkruhet në detaje: me dhe në mes të arsimtarëve, nxënësve dhe prindërve, si dhe

komunikimi i shkollave përmes rrjetëzimit (Komuniteti i të mësuarit së bashku). Janë prezantuar baza ligjore, përbërja dhe roli i organizmave të ndryshëm të shkollës siç janë Këshilli Drejtues i Shkollës dhe Këshilli i Nxënësve.

Moduli 6: Udhëheqësia dhe Administrimi i Personelit:

Prezantohen disa lloje të udhëheqësisë; tema e delegimit shpjegohet në detaje. Nevojat për zhvillim sistematik të stafit, bazuar në vlerësim individual, zhvillimi profesional i mësimeve në bazë të mentorimit si dhe stafit jo-mësues.

Moduli 7: Administrimi efektiv i shkollës dhe Udhëheqja e takimeve: Moduli mbi administratën në shkollë fokusohet në menaxhimin e suksesshëm të kohës dhe administrimin e dokumenteve, duke përfshirë arkivimin dhe dosjimin e dokumenteve elektronike dhe fizike; planifikimin, organizimin dhe kryesimin e takimeve në mënyrë produktive.

Metodat e realizimit të programit

Secili modul do të ketë nga tri ditë trajnimi (d.m.th 21 orë). Dy ditët e para janë të njëpasnjëshme; dhe trajnimi organizohet në fundjavë. Dita e tretë do të mbahet pas një intervali kohor dhe gjatë këtij intervali pjesëmarrësit do të kryejnë një projekt transferimi, d.m.th. ata do të kryejnë një aktivitet i cili transferon praktikisht nëpër shkolla ato njohuri dhe ide që janë fituar gjatë kohës së trajnimit. Fokusi i ditës së tretë është shkëmbimi i rezultateve dhe përvojave të projektit të transferimit, sqarimet në lidhje me pyetjet dhe në fund do të bëhet një test në lidhje me modulin.

Tre muaj pas trajnimit, pjesëmarrësit do të ftohen që të takohen sërish për të diskutuar përvojat e tyre në zbatimin e trajnimit.

Dita 1.
Prezantim i
modulit

Dita 2.
Prezantim i
modulit

Dita 3.
Reflektim i
përvojave dhe

Monitorimi dhe vlerësimi i trajnimit

Trajnimi do të zbatohet nga ofruesit vendor të shërbimit, të cilët mund të mobilizojnë dhe të përfshijnë trajnerët me përvojë. Të gjithë janë përfshirë në trajnime të ngjashme më parë; të gjithë kanë marrë pjesë në Trajnimin e Trajnerëve (ToT), i dizajnuar ekskluzivisht për këtë program.

Monitorimi i trajnimit do të bëhet në dy mënyra:

- Nga vetë trajnerët (vijueshmëria, reagimet ndaj pjesëmarrësve, raporti me ofruesin e shërbimit, vlerësim i shkurtër në fund të secilës ditë, etj.).
- Me anë të një agjencie të jashtme të monitorimit (vizita vrojtuese, diskutime në grupe).

Certifikimi

Mjeti kryesor për vlerësimin e trajnimit është testi, i cili do të zhvillohet pas dy moduleve. Testi do të përmbaj pyetje nga dy modulet paraprake. Vetëm ata pjesëmarrës që kalojnë të shtatë modulet, do të rekomandohen për certifikim zyrtar nga MASHT-i.

Trajner

20

Data

Nentor 2020

Titulli i Programit	Mbrojtja e shëndetit mendor të fëmijëve përmes programeve psiko-pedagogjike në vendet e prekura nga varfëria
Titulli i organizatës	Instituti për Promovimin e Edukimit (IPEDU)
Tipi i programit:	Plotësues
Ofertuesi i programit:	Instituti për Promovimin e Edukimit (IPEDU)
Adresa:	Rr. "Janina" 252, Veternik Prishtinë
E-mail:	fidan_hetemi@hotmail.com
Telefoni:	+383 (0) 44 984 207
Numrat dhe data e aprovimit:	45-2020 03 Shkurt 2020. Aprovohet për një vit
Kohëzgjatja e programit (orë)	Trajnimi i një grupi prej 8 profesionistëve – trajnerë pedagogjike special, psikologëve, profesionistëve nga lëmia e shëndetit mental, të cilët do të punojnë me mësuesit në trajnimin e tyre. Gjithsej 8 orë pune trajnuese Organizohet trajnimin i 40 mësuesve nga 10 shkolla. Trajnimi do të zgjatë tri ditë me nga 6 orë në ditë me gjithsej 18 orë pune.
Përfituesit:	Kësilltarët në shkolla (psikologët, pedagogët social, punëtorët social, mësuesit mbështetës) Përfituesit tjerë: • Nxënësit që marrin pjesë në aktivitetet psiko-pedagogjike • Nxënësit që përfshihen në aktivitete vullnetare • Nxënësit që ndihmohen nëpërmjet këshillimit të moshatarëve • Prindërit dhe komuniteti i shkollës
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	• 8 profesionistë që do të zhvillohen dhe marrin përvoja nga model i ri punës • 40 mësime dhënë nga 10 shkolla të përfshira • 800 nxënës.
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	• Programi do të zvogëlojë ndikimin e varfërisë tek fëmijët nëpërmjet ndihmës nga shkolla dhe bashkëmoshatarët. • Mobilizimi i burimeve njerëzore në shkolla që mund të aktivizohen për këtë qëllim dhe janë burim i rëndësishëm i mbështetjes së fëmijëve. • Zhvillimi i bashkëpunimit mes shkollës dhe prindërve dhe rritja e pjesëmarrjes së prindërve në aktivitetet psiko-pedagogjike që zhvillohen në shkolla. • Zhvillimi i këshillimit moshatar si një metodë e re e ndihmës për fëmijët me vështirësi. Nxënësit e interesuar nga klasat e larta do të

	trajnohen për t'i ndihmuar nxënësit më të vegjël. • Puna vullnetare me bazë në shkollë.
Përmbajtja:	1. Vizitat përgatitore nga koordinatori i projektit IPEDU përfshinin shkolla në rajonin e Kacanikut, Hanit të Elezit, Shtërpcës dhe autoriteteve rajonale 2. Një trajnim njëditor për 8 trajnerët profesionalë nën mbikëqyerjen e një trajneriintermacional. 3. Një trajnim tre-ditor i një grupi multidisiplinar prej 40 palësh të interesuara (autoritetet lokale të shkollës, drejtorët e shkollave, koordinatorët e shkollave, psikologët dhe mësuesit e shkollës). Do të përgatitet dhe drejtohet në bashkëpunim me ekspertin ndërkombëtar nga Sllovenia. 4. Një takim vlerësimi do të organizohet me ekspertë, koordinatorë të shkollës, autoritete shkollore dhe përfaqësues të shërbimeve rajonale shëndetësore. 5. Pjesë e aktiviteteve do të jenë edhe trajnimi i fëmijëve për këshillim të moshatarëve dhe zbatimi i metodave të tilla në disa shkolla, puna e mësimitdhënësve dhe punëtorëve tjerë shkollor që do të përmbajnë punëtori për fëmijë, prindër dhe puna vullnetare. 6. Shpërndarja e ndihmës financiare për fëmijët nga familjet e varfëra që janë të interesuar për riedukim profesional ose për fillimin e disa aktiviteteve prodhuese. Do të aranzhojë mundësi të arsimit falas dhe pjesërisht të mbështesë kostot e udhëtimit dhe shpenzimet e tjera të lidhura me të dhe të kontribuojë në shpenzimet për sigurimin e mjeteve të nevojshme për aktivitetet e drejtimit në shtëpi.
Metodat e realizimit të programit	Fillimisht do të bëhet një trajnim me trajnerët që do të mbikëqyret nga një trajnues ndërkombëtar. Seminare me mësimitdhënës do të organizohet përmes ligjëratave interactive. Do të ketë punë në grupe, diskutime dhe debat lidhur me temat që do të zhvillohen. Do të ekspozohen nga mësimitdhënësit dhe profesionaistët disa nga praktikatat e mira që zhvillohen në shkolla dhe do të debatohen ato.
Certifikim i	Në fund të çdo trajnimi do të certifikohen trajnerët dhe mësimitdhënësit
Trajner	Trajnerët e trajnimit të këshilltarëve shkollorë dhe mësimitdhënësve janë ekspertë ndërkombëtar dhe vendorë të profilit profesional psikosocial dhe pedagogjik.
Data	Janar 2020

Titulli i Programit	Ndihmë fëmijëve me vështirësi specifike në mësim dhe fëmijëve me nevoja të veçanta
Titulli i organizatës	Instituti për Promovimin e Edukimit (IPEDU)
Tipi i programit:	Themelore
Ofertuesi i programit:	Instituti për Promovimin e Edukimit (IPEDU).
Adresa:	Rr. Janina 252, Veternik Prishtinë.
E-mail:	fidan_hetemi@hotmail.com.
Telefoni:	+383 (0) 44 984 207.
Numrat dhe data e aprovimit:	46-2020 03 Shkurt 2020. Aprovohet për një vit
Kohëzgjatja e programit(orë)	18 orë Trajnimi i profesionistëve - trajnerëve + 24 orë (3 grupe mësimdhënës x 8 orë).
Përfituesit:	Kësilltarët në shkolla (psikologët, pedagogët social, punëtorët social, mësuesit mbështetës). Pedagogët special, mësuesit asistentë, fëmijët me nevoja të veçanta (me aftësi të kufizuara) si dhe fëmijët me vështirësi në mësim.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	20 trajnerë profesionist të programit me pedagogët special, mësuesit asistentë dhe me psikolog. 100 mësuesve, të cilët punojnë me fëmijë me vështirësi në mësim dhe fëmijë me nevoja të veçanta.
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	- Përmirësimi i situatës së fëmijëve me nevoja të veçanta (10% - 15% e të gjithë fëmijëve të shkollave fillore) në shkollimin fillor. - Janë aftësuar përmes trajnimit një grup prej 20 ekspertësh (pedagogë specialë, psikologë, mësimdhënës asistentë dhe këshilltarë shkollorë), - Mësuesit e trajnuar janë aftësuar për të punuar me fëmijët me nevoja të veçanta brenda sistemit shkollor dhe për të përhapur njohuritë themelore për fëmijët me nevoja të veçanta në mesin. - Zbatimi i njohurive të fituara në ndihmën e specialistëve me fëmijë me nevoja të veçanta dhe në edukimin e mësuesve të shkollave fillore për nevojat dhe qasjet e fëmijëve me nevoja të veçanta. - Monitorimi i punës së mësuesve në shkolla për punën me fëmijët me nevoja të veçanta. - Është bërë edhe vlerësimi i efekteve të projektit.
Përmbajtja:	Fëmijët me aftësi të kufizuara dhe me vështirësi në mësim janë një nga grupet më të marginalizuar në shoqërinë

	kosovare. Një nga pengesat kryesore për adresimin e nevojave të tyre është mungesa e njohurive se sa fëmijë me nevoja të veçanta janë në Kosovë, ku ata jetojnë dhe cilat janë nevojat e tyre. Në fakt, nuk ka ndonjë përcaktim zyrtar të aftësisë së kufizuar që mund të përdoret për të llogaritur këtë numër. Aktivitetet kryesore të projektit janë: • Trajnimi i ekspertëve lokal (edukatorëve dhe psikologëve) për edukimin e mësimeve • Trajnimi i mësimeve që punojnë me fëmijë me aftësi të kufizuara dhe fëmijët me vështirësi në mësim në klasat e tyre • Zbatimi i shkathtësive të fituara në shkollë • Përgatitje e manualeve dhe materialeve të tjera në fushën e vështirësive specifike në mësim Komponentët substanciale të projektit janë: identifikimi i fëmijëve me vështirësi specifike në mësim, mbështetja psikosociale, motivimi i fëmijëve dhe përmirësimi i vetëbesimit të tyre, dhe puna me prindërit (informimi, këshillimi). Prandaj është vendosur që ky program të ketë qasje informimi të mësuesve për problemet me këta fëmijë dhe si duhet të punohet me këta fëmijë. Natyrisht më e rëndësishmja është që mësuesit do të marrin njohuri dhe përvoja të mira nga vendet tjera e sidomos nga Sllovenia.
Metodat e realizimit të programit	Programi zhvillohet me metodën e ligjërimit në formë të ndërveprimit, përcillet me komente dhe këmbim të përvojave të mira të mësuesve. Punohet në grupe të mësuesve me metodën e rasteve të fëmijëve të tillë dhe si janë ndihmuar. Debatohet për rastet specifike me fëmijët e tillë në seanca plenare ku edhe tregohen përvoja të mira për zgjidhjen se si duhet ndihmuar këta fëmijë.
Certifikimi	Në fund të çdo trajnimi do të certifikohen trajnerët dhe mësimeve.
Trajner	Trajnerët e trajnimit të këshilltarëve shkollorë dhe mësimeve janë ekspertë ndërkombëtar dhe vendorë të profilit profesional të profilit psikosocial dhe pedagogjik.
Data	Janar 2020

Titulli i Programit	Aplikimi i programeve online në sigurimin e cilësisë në mësimdhënie	
Titulli i organizatës	Eko - Protection	
Tipi i programit:	Themelor	
Ofertuesi i programit:	Eko - Protection	
Adresa:	Rr. "Bislim Bajgora" - Mitrovicë	
E-mail:	samifazliu@gmail.com	
Telefoni:	044-294-075 048-906-331	
Numrat dhe data e aprovimit:	12/2020 03.02.2020	Akreditohet për një vit
Kohëzgjatja e programit(orë)	72 orë	
Përfituesit:	Përfituesit e drejtpërdrejtë: Drejtorët e shkollave, zëvendës drejtorët, pedagogët, psikologët, mësimdhënësit klasorë, mësimdhënësit lëndorë, mësimdhënësit mbështetës.	
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	15 - 25	
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	- Mësimdhënësit do të pajisen me njohuri të reja për aplikimin e programeve online në procesin e mësimdhënies; - Mësimdhënësit do të pajisen me njohuri të reja për përgatitjen e materialeve mësimore dhe shpërndarjen e tyre duke përdorur programet online; - Mësimdhënësit të jenë në gjendje të ndajnë (share) punën e tyre me kolegë dhe nxënës; - Mësimdhënësit të jenë në gjendje të bashkëpunojnë online në zgjidhjen e detyrave dhe problemeve mësimore me nxënës e kolegë; - Mësimdhënësit të jenë në gjendje të shfrytëzojnë mundësinë e qasjes në materiale nga kudo në çdo kohë dhe nga kudo qoftë. - Mësimdhënësit do të pajisen me njohuri të reja për aplikimin e programeve online për komunikim të drejtpërdrejtë me nxënës apo kolegë.	
Përmbajtja:	• Informatat themelore për programet online; • Google account - Shërbime të njohura të Google, Krijimi i një llogarie Google; • Gmail - Ndërfaqja e Gmail-it; Krijimi i një llogarie Gmail, Dërgimi i email-ve dhe menaxhimi i emailit; • Google Drive - Qasja në Google Drive; Krijimi, ngarkimi dhe menaxhimi i skedarëve në Google Drive, Ndarja e	

	dokumente dhe bashkëpunimi; Konvertimi dhe printimi i dokumenteve ne Google Drive; • Google Forms - Krijimi i Formave, Përdorimi i shablloneve, Rregullimi i cilësimeve të formave, Përdorimi dhe dërgimi i formave, Analizimi i përgjigjeve, Krijimi i një Kuizi; • Google Classroom - Qasja në Google Classroom; Navigimi; Krijimi i detyrave dhe materialeve; Vlerësimi dhe lënia e reagimeve; Komunikimi me nxënës dhe prindër. • Google Docs- Ndërfaqja, Manipulimi me tekst. Header-ët Footer-ët dhe thyerjet e faqeve; Puna me tabela; Vendosja e imazheve. Tekst box-et; Përdorimi i Google Docs offline; • Google Sheets- Ndërfaqja e Google Sheets, Bazat e qelizave; Puna me shumë fletë; krijimi i formularve; Përdorimi i funksioneve; Sortimi dhe filtrimi i të dhënave • Google Slides- Bazat e sllajdeve; Bazat e punës me Tekst; Vendosja e imazheve dhe formave; Shtimi i tranzicioneve dh animacioneve; Shfaqja e prezantimeve (Slide Show); Editimi i layout-eve dhe master sllajdeve. • Metodologjia e punës që realizohet përmes këtij programi trajnues është kryesisht përmes teknikave të mësimit aktiv, ligjëratave interaktive, demonstrimit praktik dhe punës në grupe. • Programi i trajnimit përfshin 8 ditë trajnimi nga 8 orë: që do të thotë se, çdo pjesëmarrës ka 64 orë trajnim direkt dhe 8 orë punë praktike - çdo pjesëmarrës deri në fund të programit të trajnimit merr 72 orë trajnim.
Metodat e realizimit të programit	Të ndryshme.
Certifikimi	Të gjithë mësimeve do të certifikohen sipas vijueshmërisë.
Trajner	10
Data	Janar 2020

Titulli i Programit	Edukimi për të drejtat e fëmijëve “Të drejtat tona”
Titulli i organizatës	Instituti për Promovimin e Edukimit (IPEDU)
Tipi i programit:	Plotësues
Ofertuesi i programit:	Instituti për Promovimin e Edukimit
Adresa:	Rr. “Janina” 252, Veternik Prishtinë
E-mail:	fidan_hetemi@hotmail.com
Telefoni:	+383 (0) 44 984 207
Numrat dhe data e aprovimit:	45-2020 03 Shkurt 2020. Aprovohet për një vit
Kohëzgjatja e programit(orë)	Trajnimi i trajnerëve është dy ditë me 12 orë , të cilët do t’i trajnojnë mësuesit. Në Trajnimin e trajnerëve duhet të jetë së paku një ekspert internacional. Trajnimi i mësimeve është dyditë me 12 orë punë efektive trajnuese. Monitorimi bëhet përmes kontakteve me mësuesit dhe në orë mësimore. Për një mësues nga 1 - 2 orë mësimore .
Përfituesit:	Këshilltarët shkollorë (pedagogë, psikologë dhe drejtore) Mësimeve, Nxënëse.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	• 60 trajnerë që do t’i trajnojnë mësuesit • 800 mësues që do të marrin pjesë në trajnime për të drejtat e fëmijëve • 32000 fëmijë që do të përfitojnë nga zbatimi i projektit dhe materialet e shpërndara
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	- Njohja e mësimeve për të drejtat universale të njeriut dhe të drejtat e fëmijëve dhe informimi i nxënëseve në shkollë. - Njohja me konventat e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës - Të mësuarit për të drejtat e njeriut si një qasje në përgatitjen e të rinjve për t’u bërë qytetarë të informuar,aktivë dhe përgjegjës. - Edukimin e të rinjve për qytetari aktive dhe pjesëmarrje aktive në respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të fëmijëve - Njohja dhe zbatimi me sukses i metodës së albumeve “Të drejtat tona” me nxënëse.
Përmbajtja:	Qasja përmbajtësore e këtij programi është edukimi i fëmijëve për të drejtat e tyre dhe përgatitje e fëmijëve për qytetari aktive, përgjegjës për tolerancë dhe bashkëjetesë.

	Rol të rëndësishëm këtu është edhe zbatimi me sukses i kurrikulës shkollore, duke pasur parasyshë përmbajtjen e planprogramit të Edukatës qytetare, por duke u bazuar edhe në zhvillimet tjera për arritjen e rezultateve të të nxënësve përmes të shkathësive dhe arritjen e kompetencave. Metoda me albumet “Të drejtat tona” plotëson synimin e arsimit kosovar në edukimin e fëmijëve për të drejtat e tyre.
Metodat e realizimit të programit	Përgatitja e mësimeve, këshilltarëve shkollorë dhe profesionistëve për të drejtat e fëmijëve si trajnerë të ardhshëm për të drejtat e fëmijëve. Trajnimi i mësimeve për edukimin e fëmijëve për të drejtat e tyre dhe për zbatimin e metodës së albumeve “Të drejtat tona”. Monitorimi i zbatimit me nxënës të metodës me albumet “Të drejtat tona”. Vlerësimi i rezultateve të punës me nxënës përmes pyetësorëve.
Certifikimi	Në fund të çdo trajnimit do të certifikohen trajnerët dhe mësimeve
Trajner	Trajnerët e trajnimit të këshilltarëve shkollorë dhe mësimeve janë ekspertë ndërkombëtar dhe vendorë të profilit profesional për të drejtat universale të njeriut.
Data	Janar 2020

Titulli i Programit	Mbrojtja e fëmijëve në internet
Titulli i organizatës	MASH
Tipi i programit:	Bazik (ngaqë lidhet me metodologjinë e mësimdhënies dhe orët mësimore)
Ofertuesi i programit:	Mash, divizioni për ZHPM në kordinim zyren e të drejtatve të njeriut
Adresa:	Rr. “Agim Ramadani”, P.n. Prishtinë
E-mail:	Merita.Jonuzi@rks-gov.net
Telefoni:	038/213-004 038/212-004
Numrat dhe data e aprovimit:	Programi është për kohë të pacaktuar.
Kohëzgjatja e programit(orë)	24 Orë.
Përfituesit:	Mësimdhënësitë klasave 3-9, Koordinatorët e cilësisë
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	20-25 për një grup.
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Rezultatet e pritura ose objektivat e programit: Trajnimi i mësimdhënësve mbi përdorimin e udhëzuesve u shërben atyre që të jenë mbrenda sistemit të mbrojtjes së fëmijëve, duke parandaluar keqpërdorimin e internetit, nëpërmjet procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies cilësore. Materialet e punuara përmbajnë informata që u nevojiten mësimdhënësve për realizimin e aktiviteteve brenda orëve mësimore, me qëllim që t’i aftësojnë nxënësit se si të jenë të sigurt në internet, si ta përdorin atë në mënyrë të dobishme e të përgjegjshme dhe si të zhvillojnë mendim kritik për besueshmërinë e informatave, që marrin gjatë përdorimit të internetit. Rezultatet e pritura ose objektivat e programit: • Mësimdhënësit e trajnuar për përdorimin e udhëzuesve • Shkollat e përdorin materialin me qasje ndërkurrikulare, por edhe për mësim me zgjedhje • Fillon shtrirja e konceptit të mbrojtjes në internet, duke pretenduar përdorimin e internetit në mënyrë të sigurtë, të dobishme e të përgjegjshme nga nxënësit dhe mësimdhënësit tanë.

Përmbajtja:	Përmbajtja: Programi i trajnimit: Hyrje: Të drejtat e njeriut./Mbrojtja e fëmijëve në kontekst të shkollës Kapitulli I 1.0. Mbrojtja e fëmijëve në internet (Informacione të përgjithshme). 1.1. Rreziqet në internet. 1.2. Roli i shkollës në parandalim të keqpërdorimit të TIK 1.3. Pse udhëtojmë dhe si: 1.3.1. Mësimi, 1.3.2. Kërkimi i informacionit, 1.3.3. Loja e argëtimit, 1.3.4. Argëtimi (duke qenëtëmbrojtur), 1.3.5. Të ecim me kujdes dhe 1.3.6. Arritja. Kapitulli II 2.0. Mbrojtja e fëmijëve në internet nëpërmjet mësimdhënies dhe aktiviteteve tjera. 2.1. Qasjakurrikulare, ndërkurrikulare dhe jashtëkurrikulare. 2.2. Alternativat e përdorimit të udhëzuesit sipas temave/ aktiviteteve/ këshillave të udhëzuesve për fëmijëve. 2.2.1. Udhëzuesi për Mbrojtjen e Fëmijëve në Internet(3-5). 2.2.2. Udhëzuesi për Mbrojtjen e Fëmijëve në Internet(6-9). 2.2.3. Udhëzuesi për mësimdhënës. Kapitulli III 3.0. Mundësitë e trajtimit të temave, që ndërlidhen me mbrojtjen e fëmijëve në internet nëpërmjet mësimi me zgjedhje. 3.1. (Planifikimet, modelet e orëvëmësimore, rezultatet). 3.2. Përfundim.
Metodat e realizimit të programit	Të ndryshme, ligjërime, punë në grupe, demonstrim i modeleve të orës mësimore, sipas fushave të ndryshme kurrikulare.
Certifikimi	Po, sipas rregullave të përcaktuara të certifikimit.
Trajner	3-4.
Data e aplikimit	Janar 2020

Titulli i Programit	
Mësimdhënia inovative me përdorimin e mjeteve dixhitale	
Titulli i organizatës	ISEPS
Tipi i programit:	Themelor
Ofertuesi i programit:	Instituti ISEPS (Instituti për Studime Socio-Ekonomike dhe Politike)
Adresa:	Ulpiana, p.n. Prishtinë, Kosovë
E-mail:	instituti.iseps@gmail.com
Telefoni:	+38328555315
Numrat dhe data e aprovimit:	58/2020, 03.02.2020 Aprovohet për një vit
Kohëzgjatja e programit(orë)	8 orë
Përfituesit:	Mësimdhënës/e të Shkollave Filllore dhe Mësimdhënës/e të Shkollave të Mesme
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	20 persona në grup
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Objektivat e trajnimit: • Platformat digjitale për realizimin e mësimi online • Krijimi i klasëve online dhe ndarja e materialeve me nxënës • Metodologjia e mësimdhënies online • Metodologjia e vlerësimit online
Përmbajtja:	Mësimdhënia inovative me përdorimin e mjeteve dixhitale, ku rëndësi dhe qëllim kryesor është realizimi i mësimdhënies dhe vlerësimit online.
Metodat e realizimit të programit	Online dhe ne Klase.
Certifikimi	Certifikatë për modulin e përfunduar.
Trajner	2
Data e aplikimit	Janar 2020

Titulli i Programit	Gjithëpërfshirja dhe individualizimi i mësimit për nxënës me nevoja të veçanta arsim ore (pia)
Titulli i organizatës	Eko - Protection
Tipi i programit:	Program trajnues themelor
Ofertuesi i programit:	Eko - Protection
Adresa:	Rr. Bislim Bajgora - Mitrovicë
E-mail:	arbenzabeli@gmail.com
Telefoni:	044-415-558 049-541-053
Numrat dhe data e aprovimit:	12/20 Akreditohet për një vit 03.02.2020
Kohëzgjatja e programit(orë)	56 orë
Përfituesit:	Përfituesit e drejtpërdrejtë: Drejtorët e shkollave, zëvendës drejtorët, pedagogët, psikologët, mësimdhënësit klasorë, mësimdhënësit lëndorë, mësimdhënësit mbështetës, mësimdhënësit e klasave të bashkangjitura si dhe asistentë për nxënës me nevoja të veçanta.
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	25 - 30
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	- Pjesëmarrësit do informohen për terminologjinë dhe konceptet e arsimit gjithëpërfshirës, për largimin e paragjytimeve për nxënës apo personat me nevoja të veçanta arsimore; - Të mos i paragjykojmë nxënësit në bazë të vështirësisë që kanë por përparësive të tyre, të fokusohemi në atë që mund të bëjnë e jo në atë që nuk mund të bëjnë; - Pjesëmarrësit do të pajisen me njohuri të reja për organizimin dhe planifikimin e punës me nxënës me nevoja të veçanta arsimore respektimi i individualitetit të secilit nxënës; - Për përgatitjen e materialeve alternative mësimore duke u bazuar në nevojat individuale të nxënësve; - Si bëhet menaxhimi i klasës ku ka nxënës me nevoja të veçanta arsimore, krijimi i klimës së përshtatshme brenda klase, respektimi i nevojës së veçantë dhe përfshirja në aktivitete të shkollës të secilit pavarësisht vështirësisë së tij/saj. - Njohja e vështirësive në të nxënë (vështirësi këto që janë pedagogjike e jo mjekësore). - Përdorimi i metodave dhe teknikave të përshtatshme varësisht nga vështirësia në të nxënë që ka nxënësi në klasë - Informata të nevojshme për Planin Individual të Arsimit (PIA), - Të mësojnë si hartohet PIA dhe si ta zbatojnë atë në punë me nxënës me nevoja të veçanta arsimore në klasë;

	- Pjesëmarrësit që kanë vijuar trajnimin mësojnë të vlerësojnë nxënësit sipas UA, dhe vlerësimit në ditarë shkollorë sipas PIA.
Përmbajtja:	• Programi i trajnimit është i ndarë në 2 module: • Moduli I – Gjithëpërfshirja, mësimdhënia dhe mësimnxënia (24 orë) • Moduli II - Plani Individual i Arsimit (PIA) - (24 orë) • Dhe 8 orë punë praktike (Detyrë shtëpie) • Programi përfshinë Informatat themelore për arsimin gjithëpërfshirës - Terminologjisë; • Legjislacioni i arsimit special në Kosove dhe Botë; • Stilet dhe strategjitë e mësimdhënies; • ADHD (Çrregullimet e Vëmendjes dhe Hiperaktivitetit); • Bashkëpunimi prindër , nxënës dhe mësimdhënës; • Menaxhimi i klasës; • Vështirësitë në shkrim- lexim dhe matematikë; • Nxënësit hiperaktiv; • Bulizmi • Intelejencat e shumëfishta; • Dallueshmëritë ndërmjet nxënësve; • Njohja me planin individual të arsimit (PIA) dhe udhëzuesin për përdorimin e PIA-së; • Hartimi i PIA-së; • Aktivitete relaksuese me përmbajtje gjithëpërfshirëse; • Ekipi identifikues dhe vlerësues në nivel komunal; • Prodhimi i materialeve alternative mësimore të përshtatura sipas nevojave individuale. • Kurrikula e re e Kosovës në gjithëpërfshirje;
Metodat e realizimit të programit	Të ndryshme Metodologjia e punës që realizohet përmes këtij programi trajnues është kryesisht përmes teknikave të mësimit aktiv, ligjëratave interaktive, shkëmbimit të përvojave të programit të suksesshëm dhe punës në grupe.
Certifikimi	Të gjithë mësimdhënësit do të certifikohen sipas vijueshmërisë dhe sipas përfundimit të suksesshëm të detyrave.
Trajner	12
Data	19.08.2020

Titulli i Programit	U dhezues per zbatim te kurrikules
Titulli i organizatës	MASH
Tipi i programit:	Themelor
Ofertuesi i programit:	MASH
Adresa:	Rruga "Agim Ramadani" pn
E-mail:	
Telefoni:	038 213 005
Numrat dhe data e aprovimit:	Jane aprovuar nga Masht
Kohëzgjatja e programit(orë)	40 ore- 5 dite
Përfituesit:	Mësimdhënësit e klases përgatitore dhe arsimit fillor,të mesëm tëulet dhe arsimit të mesëm të lartë
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	25-30
Rendesia e udhëzuesit	UdhëzuesiT mbështeten ne zbatueshmerinë e KKsë,respektivisht KB-ve dhe programeve lendore në gjithë arsimin parauniversitar 1.GJUHE DHE KOMUNIKIM 2. ARTET 3. MATEMATIKA 4. SHKENCAT E NATYRES 5. SHOQERIA DHE MJEDISI 6.JETA DHE PUNA 7.EDUKATE FIZIKE,SPORTET DHE SHENDETI
Rezultatet e pritura ose objektivat	- Identifikon qasjet për të arritur qellimet e arsimit parauniversitar. - Identifikon qasjet për të respektuar parimet e KK-së - Realizon modele planifikimeve mësimore në të cilat përfshihen elementet e domosdoshme të KB-ve dhe programeve mësimore. - Realizon modele të strategjive të mesimdhënies dhe të të nxënit,duke u respektuar parimet e KK-së. - Realizon modele të përgatitjes dhe shfrytëzimit të materialeve mësimore. -Zbaton strategji,teknika dhe instrumente te vlersimit konform parimeve të kurikulës dhe specifikave të programeve mësimore. - Zbaton strategji, të bashkëpunimit kolegjial brenda dhe jashtë shkollës.

Përmbajtja:	Udhëzuesi perbehete prej shtatë kapitujve dhe shtojcave. Në secilin kapitull elaborohen çështje që ndihmojnë mesimdhënesve të kuptojnë ecurinë e zberthimit të KK-së, të KB-ve dhe programeve mësimore në sistemin parauniversitar në praktikën skolllore.
Metodat e realizimit të udhëzuesve	Udhëzuesi në fillim përdoret si material trajnues i mesimdhënesve për të zhvilluar me tej aftësitë të mesimdhënesve në zbatim të KK-së, respektivisht të KB dhe programeve lëndore në sistemin e arsimit parauniversitar. Me pastaj logaritët që ky udhëzues krahas udhëzuesve të tjerë tju shërbejnë mesimdhënesve gjatë punës së pavarur në realizimin e kurikulës së re. Në kapitullin e parë-Hyrja, trajtohet rëndësia e udhëzuesit, qëllimi i udhëzuesit, përdorimi dhe përdoruesit, rezultatet e pritura nga përdoruesit e udhëzuesit dhe organizimi i udhëzuesit. Në kapitullin e dytë-Korniza e Kurrikulës së Kosovës dhe Kurrikula Bërthamë-zbatimi praktikë, trajtohen çështje që ndihmojnë jetësimin e qëllimeve të arsimit parauniversitar, respektimin e parimeve të kurrikulës në procesin arsimor në shkollë, kuptimin e zberthyeshmërisë së rezultateve të nxënies, kompetencat kryesore të shkollës dhe për fusha kurrikulare e programe mësimore lëndore në planifikime mësimore. Në kapitullin e tretë-programe mësimore, trajtohet qëllimi i programeve mësimore, lidhja e programeve mësimore me konceptet e fushës dhe me rezultatet e nxënies të fushës, temat dhe rezultatet e nxënies, udhëzime metodologjike në programe mësimore. Në kapitullin e katërt-Aspektet metodologjike dhe praktike të planifikimit dhe zbatimit të kurrikulës së re, trajtohen çështje të planifikimeve mësimore duke integruar elemente të domosdoshme të KB-së dhe programeve mësimore, çështjet ndërkurrikulare dhe korrelacioni ndërmjet fushave kurrikulare e programeve mësimore dhe bashkëpunimi kolegjial në funksion të zbatimit të KB-së dhe programeve mësimore. Në kapitullin e pestë-kurrikula me zgjedhje, trajtohen aspektet që do të ndihmojnë shkollën në konceptimin e drejtë të kuptuarit të kurrikulës me zgjedhje si pjesë përbërëse e

	KKK-së, në dhënie të udhëzimeve për hartimin e tij, nënëkonkretizimin e procedurave dhe të kriterëve për miratimin e realizimit të tij dhe në paraqitjen e modeleve të caktuara të cilat do të shërbejnë për cilësi të të gjitha aspekteve që ndërlidhë me kurrikulën me zgjedhje. Në kapitullin e gjashtë-Metodologjia e mësimdhënies dhe materialet mësimore, trajtohen strategji të mësimdhënies dhe të nxënies, duke përfshirë metoda, teknika, të mësimdhënies dhe të nxënies të suksesshëm, përgatitje dhe shfrytëzim të materialeve mësimore. Në kapitullin e shtatë- Vlerësimi i nxënësve –qasjet praktike në vlerësimin e nxënësve, trajtohen metoda, teknika dhe instrumente të vlerësimit të arritjeve të nxënësve, respektivisht kompetencat, rezultatet e të nxënies dhe nivelet e njohje në funksion të të vlerësimit. Shtojcat-permban instrumete të planifikimeve dhe të vlerësimit të arritjeve të nxënësve, të përgatitura nga mësimdhënësit.
Certifikimi	I bazuar në rezultatet e treguara
Trajner	76
Data	10 nëntor 2020

Titulli i Programit	Mësimdhënia me teknologji informative
Titulli i organizatës	Si të bëhemi i suksesshëm
Tipi i programit:	Program themelor i trajnimit
Ofertuesi i programit:	Si të bëhemi i suksesshëm
Adresa:	Brigada 123, Suharekë
E-mail:	gezimsopa@yahoo.com
Telefoni:	+383 49 466766
Numrat dhe data e aprovimit:	Nr. 13/2020, dt. 03.02.2020 Aprovohet për një vit
Kohëzgjatja e programit(orë)	80 orë
Përfituesit:	Mësimdhënësit e të gjitha lëndëve mësimore
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	21
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Çdo mësimdhënësi i cili e përfundon me sukses këtë trajnim duhet të jetë në gjendje t'i kryej këto aktivitete/detyra:

	○ Të njohin pjesët ,paisjet kompjuterike,të dijnë ti kyqin (psh.videoprojektorin)dhe ti përdorin. ○ Të manipulojn me File ,Follder dhe sistem operativ. ○ Të përpilojnë teste dhe detyra tjera. ○ Të ndërtojnë tabela ,grafikone etj. ○ Të pregadisnin prezantime të ndryshme me foto animacione etj. ○ Të shfletojn internetin dhe të përdorin resurset e tij si dhe te dijnë të komunikojn. Predatitja e testeve dhe kuizeve online në formë të lojërave mësimore
Përmbajtja:	Moduli I - Konceptet e TI-së ,përdorimi i kompjuterit dhe menaxhimi i skedarëve 16 orë Moduli Moduli II - Microsoft Word (Përpunim i Tekstit) 16 orë Moduli III - Microsoft Excel(Puna me Tabela) 16 orë Moduli IV - Microsoft PowerPoint (Prezantimet) 16 orë Moduli V - Shfletimi në Internetit, Platformat online ,Përgatitja e Testeve Online dhe kuizeve online 16 orë
Metodat e realizimit të programit	Komplet trajnimi do të mbahet në laborator të teknologjisë informative kryesisht edhe me punë praktike duke përdorur kompjuter,internet dhe pajisje tjera që i duhen këti trajnimi.
Certifikimi	Kandidatet certifikohen për 10 ditë të trajnimit (80 orë trajnimi) dhe u jepet certifikata sipas formës së bashkëngjitur në aplikacion.
Trajner	3
Data	Janar 2020

Titulli i Programit	Origami – Mësojmë dhe krijojmë
Titulli i organizatës	Si të bëhemi i suksesshëm
Tipi i programit:	Program themelor i trajnimit
Ofertuesi i programit:	Si të bëhemi i suksesshëm
Adresa:	Brigada 123 ,Suharekë
E-mail:	gezimsopa@yahoo.com
Telefoni:	+383 49 466766
Numrat dhe data e aprovimit:	Nr. 13/2020, dt. 03.02.2020 Aprovohet pë një vit
Kohëzgjatja e programit(orë)	24 orë
Përfituesit:	Mësimdhënësit prej 0-6 dhe të lëndëve zgjedhore 6-9
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	21
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Çdo mësimdhënësi i cili e përfundon me sukses këtë trajnim duhet të jetë në gjendje t'i kryej këto aktivitete/detyra: - o të natyrës dhe në kuadër të lëndëve zgjedhore. - o Të integrojnë teknikën e origamit gjatë zbatimit të metodave dhe teknikave të ndryshme të mësimdhënies me qëllim të konkretizimit të përmbatjeve të ndryshme mësimore. - o Të aftësojnë nxënësit e tyre për përdorimin e teknikës së origamit, e cila ndihmon ata në koordinimin e duarve, të syve, në kuptimin më të mirë të aspekteve hapësinore, si dhe në zhvillimin e durimit dhe vëmendjes lidhur me zbatimin e hapave të ndryshme për të krijuar një tërësi. Të forcojnë aftësitë e nxënësve përmes integritetit të njohurive dhe shkathtësive të tyre, si dhe të zhvillojnë kreativitetin e tyre, aftësitë bashkëpunuese dhe ato për zgjidhjen e problemeve të ndryshme. Të përkrahin nxënësit talent në krijimin e objekteve të ndryshme që përdoren në fusha të ndryshme lëndore. Të jenë model për mësimdhënësit e tjerë.
Përmbajtja:	Gjatë programit të trajnimit do të prezantohet historiku i zhvillimit të teknikës së Origamit, përfitimet edukativo-arsimore të zbatimit të kësaj teknike me nxënësit, hapat kryesore të palosjes së letrës gjatë zbatimit të teknikës së origamit, simbolika e zbatuar në punimet e ndryshme të krijuara sipas origamit, realizimi i disa objekteve me anë të teknikës së origamit, si dhe mundësitë e integritetit të origamit në kurrikulën e disa fushave lëndore

Metodat e realizimit të programit	Ky program trajnimi zgjat 3 ditë, ku secila nga ditët e trajnimit përmban 4 sesione 90 minuteshe, të udhëhequra nga trajnerët profesional. Pas ditës së dytë të trajnimit pjesëmarërsit do të kenë një hapësirë 2-3 javore për të implementuar në klasat e tyre aspekte të ndryshme të teknikës së origamit. Pas 2-3 jave, pjesëmarërsit do të sjellin në ditën e 3-të të trajnimit një objekt të përgatitur me origami dhe do ta prezantojnë atë para grupit.
Certifikimi	Kandidatet certifikohen për 3 dite të trajnimit (24 ore trajnimi) dhe u jepet certifikata sipas formës së bashkëngjitur në aplikacion.
Trajner	7
Data	Janar 2020

Titulli i Programit	Kurrikula e ciklit fillor me qasje kompetencash
Titulli i organizatës	Instituti KAF – International Business Education Project
Tipi i programit:	Plotësues
Ofertuesi i programit:	Instituti KAF – International Business Education Project
Adresa:	Rr. “Bedri Pejani” nr. 1, Prishtinë
E-mail:	info@beint.org
Telefoni:	044/500-388
Numrat dhe data e aprovimit:	Vendimi nr. 008/2020; Data: 03.02.2020 (Aprovimi i programit)
Kohëzgjatja e programit(orë)	54 ore
Përfituesit:	- Mësues të ciklit fillor, sepse ata janë të lidhur drejtpërdrejt dhe të interesuar për këtë tematikë; - Drejtuesit e shkollave fillore, sepse ata janë të lidhur drejtpërdrejt dhe të interesuar për këtë tematikë; Specialistë të kurrikulës dhe të vlerësimit, të inspektimit të arsimit fillor, sepse ata janë të lidhur drejtpërdrejt dhe të interesuar për këtë tematikë;
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	25
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Moduli 1. “Koncepti i kompetencës, kompetenca kyç, kompetencat e fushës dhe rezultatet e të nxënit sipas kompetencave në ciklin fillor” Rezultate të pritshme: Pjesëmarrësit në trajnim: - shpjegojnë konceptin e kompetencës në përgjithësi dhe të kompetencave kyçe në veçanti; - shpjegojnë kompetencat e fushave kurrikulare të ciklit fillor; - analizojnë dhe vlerëson rezultatin e të nxënit si element i rëndësishëm për lidhjen mes kompetencave kyç, kompetencave të fushës dhe kompetencave të lëndës; - shqyrtojnë elementet dhe risitë e programit të fushave kurrikulare të ciklit fillor; - zbatojnë mënyrat e planifikimit në grup (grup

i mësuesve të fushave kurrikulare të ciklit fillor) sipas formateve të planifikimit vjetor dhe mujor.

Moduli 2. “Metodologjia e mësimeve bazuar në kompetenca dhe situatat e të nxënësve në ciklin fillor”

Rezultate të pritshme: Pjesëmarrësit në trajnim:

- shqyrtojnë parimet dhe veçoritë e të nxënësve dhe mësimeve kontekstuale;
- vendosin lidhje mes të nxënësve me bazë kompetencat dhe të nxënësve kontekstual;
- shpjegojnë kuptimin e situatës së të nxënësve dhe të matricës së situatës së të nxënësve;
- shpjegojnë dhe ndjek hapat proceduralë për hartimin dhe planifikimin e situatës së të nxënësve;
- bëjnë dallimin mes qasjeve të mësimeve të nxënësve tradicional dhe atyre me bazë situatat;
- zhvillojnë praktikisht një model situatë të nxënësve;

Moduli 3. “Vlerësimi i arritjeve të nxënësve në ciklin fillor”.

Rezultate të pritshme: Pjesëmarrësit në trajnim:

- dallojnë konceptet e vlerësimit për të nxënësve dhe vlerësimin e të nxënësve dhe përshkruan rëndësinë e secilit prej tyre;
- identifikojnë llojet e vlerësimit dhe karakteristikat e tyre;
- demonstrojnë përdorimin e evidencave për vëzhgimin dhe mbledhjen e informacionit në lidhje me vlerësimin;
- shpjegojnë përmes shembujve përdorimin e instrumenteve të ndryshëm të vlerësimit;
- demonstrojnë vlerësimin e kompetencave mbi bazën e niveleve të arritjeve;
- përshkruajnë kriteret dhe mënyrën e ndërtimit të dosjes së nxënësve si instrument vlerësimi dhe vetëvlerësimi.

Përmbajtja:

Programi ka tre module, ku Moduli i parë trajton thellësisht kompetencën si element të formimit të nxënësve të ciklit fillor.

Moduli i dytë u krijon mundësitë pjesëmarrësve të

	shpjegojnë lidhjen midis kompetencës dhe situatës së të nxënit. Ai trajton situatën e të nxënit dhe dimensionet e saj, planifikimin në funksion të zhvillimit të kompetencave, rolin e matricës së situatës në planifikimin efektiv të saj, rolin e nxënësit dhe të mësuesit në zhvillimin e situatës. Moduli ndihmon në zhvillimin e aftësive të planifikimit dhe menaxhimit të situatave të të nxënit, të problem-zgjidhjes dhe të punës në grup të pjesëmarrësve, të planit tremujor , vjetor dhe atë të orës mësimore. Moduli i tretë trajton dy llojet kryesore të vlerësimit në klasë, <i>vlerësimin për të nxënit - formues</i> dhe <i>vlerësimin e të nxënit - përmbledhës</i>. Ky lloj vlerësimi përdoret edhe për të gjykuar efektivitetin e mësimeve apo programit mësimor. Në modul theksohet rëndësia që merr në një kurrikul me bazë kompetencat vlerësimi për të nxënit, për të monitoruar dhe nxitur <i>progresin e nxënësve</i>, dhe për t'i aftësuar ata të demonstrojnë arritjet në mënyra të ndryshme. Moduli trajton dhe pyetjet, listë kontrolli, studimet e rastit, <i>portofolin/dosjen e nxënësit, evidencën e mësuesit dhe nivelet e arritjes.</i>
Metodat e realizimit të programit	- Stuhi mendimesh - Diskutime dhe Krahase - Raste studimi - Prezantime dhe Punë grupore
Certifikimi	Certifikatë Pjesëmarrje e Trajnimit me 54 Kredi (Orë) të Vlefshme për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional Ose Certifikatë Pjesëmarrje e Modulit me 18 Kredi (Orë) të Vlefshme për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional
Trajner	2
Data	Janar 2020

Titulli i Programit	
Identifikimi dhe përkrahja e nxënësve me inteligjencë të jashtëzakonshme, me dhunti e talente	
Titulli i organizatës	ATOMI – Instituti Ndërkombëtar për Inteligjencë të Jashtëzakonshme
Tipi i programit:	Program themelor (për mësimdhënës të karrierës)
Ofertuesi i programit:	Instituti ATOMI
Adresa:	Adresa: Rr. Tahir Zajmi, Nr. 65, Gjymnazi Matematik, Kati III, Kalabri, 10 000 Prishtinë, Kosovë
E-mail:	E-mail: info@atomi-ks.org
Telefoni:	Telefoni: +383 (0)45 460 320
Numrat dhe data e aprovimit:	Vendimi i KSHLM-së numër: 28/2020, datë: 03.02.2020 - Vendimi i KSHLM-së numër: 27/2020, datë: 03.02.2020 Aprovimi për një vit
Kohëzgjatja e programit(orë)	40 orë trajnim (gjatë intervalit 12 - 14 javë)
Përfituesit:	Mësimdhënësit e arsimit parauniversitar (kl. 1 - 12) me licencë "Mësimdhënës i Karrierës"
Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim:	15 - 20 mësimdhënës
Rezultatet e pritura ose objektivat e programit:	Pas trajnimit mësimdhënësit duhet të jenë në gjendje: të kenë njohuri për fëmijët/nxënësit me inteligjencë të jashtëzakonshme, me dhunti e talente; të njihen me karakteristikat e tyre dhe mënyrën e funksionimit; të përdorin vlerësime të ndryshme për të testuar hipotezat e tyre nëse një nxënës është i tillë apo jo; të jenë në gjendje të aplikojnë njohuritë për të referuar nxënësit e tillë për vlerësim; të kenë njohuri për format e përkrahjes së këtyre nxënësve; të përpilojnë plane individuale për punë me nxënësit e identifikuar; të përcjellin progresin e këtyre nxënësve, etj..
Përmbajtja:	Ky trajnim do të përfshijë kapitujt dhe temat e çështjet në vijim: I. Rëndësia e identifikimit dhe përkrahjes së nxënësve me

inteligjencë të jashtëzakonshme, me dhunti e talente

II. Identifikimi i nxënësve me inteligjencë të jashtëzakonshme, me dhunti e talente:

- Mitet dhe të vërtetat rreth këtyre nxënësve
- Dallimet individuale, personaliteti dhe motivacioni
- Inteligjenca, matja dhe kategorizimi i saj
- Dhuntia dhe talenti
- Karakteristikat e këtyre nxënësve
- Profilet e këtyre nxënësve
- Çështje zhvillimore me rëndësi rreth këtyre nxënësve

III. Përkrahja e nxënësve me inteligjencë të jashtëzakonshme, me dhunti e talente:

- Format e përkrahjes (programet pasuruese, përsheptimi, këshillimi psikologjik, orientimi profesional, etj.)
- Përkrahja nga institucionet dhe organizatat jashtë shkollës
- Format e përkrahjes në nivel shkolle
- Format e përkrahjes në nivel klase
- Mësimi i diferencuar në klasë
- Plan-programi individual (PPI)

Përmbajtja e këtij programi të trajnimit ndërlidhet drejtpërsëdrejti me arritjen e standardeve të kërkuara për mësimdhënësit e karrierës, të cilat specifikohen në Kornizën Strategjike për zhvillimin e mësimdhënësve në Kosovë. Aftësimi i mësimdhënësve për identifikimin dhe përkrahjen e këtyre fëmijëve shpie në aplikimin e kompetencave të domosdoshme për këtë grup mësimdhënësish siç janë:

1. përdorimi i strategjive të mësimdhënies dhe vlerësimit në bazë të njohjes së karakteristikave fizike, shoqërore dhe intelektuale;
2. krijimi i një mjedisi i cili maksimizon mësimin dhe shfrytëzimi i strategjive të ndryshme të mësimdhënies që u përshtatet nevojave individuale të nxënësve;
3. planifikimi dhe zbatimi i teknikave të cilat inkurajojnë të menduar të nivelit të lartë;
4. zhvillimi i aktiviteteve të mësimdhënies që përfshijnë strategji të diferencuara për t'i angazhuar të gjithë nxënësit dhe për t'i përmbytur nevojat e veçanta
5. përcaktimi i qëllimeve sfiduese dhe të arritshme të mësimin për të gjithë nxënësit;
6. shfrytëzimi i të dhënave të vlerësimit të nxënësve për analizimin dhe vlerësimin e të kuptuarit të nxënësit për lëndën/ përmbajtjen dhe identifikimi i intervenimeve dhe modifikimi i mësimdhënies.

